



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar auditimi financiar dhe përputhshmërie në
Bashkinë Kolonjë

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË
PËRPUTHSHMËRISË
NË
BASHKINË KOLONJË

Maj 2023

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	2-9
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
II.	HYRJA	
II.1.	Objekti i auditimit	10-15
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	14-111
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	14-15
III.2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	15-112
III.2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	15-17
III.2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	17-20
III.2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	20-43
III.2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2021	44-54
III.2.4	Mbi planifikimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik	54-93
III.2.5	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	93-98
III.2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)	98-105
III.2.7	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	105-111
III.2.8	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	111-111
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	111-128
V.	ANEKSE	129-140

Shkurtime

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
DRT	Drejtoria Rajonale Tatimore
DSHP	Drejtoria e Shërbimit Pyjor
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Aksionare
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
STTV	Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore
SPE	Sistemi i Prokurimeve Elektronike
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
TNI	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ZK	Zonë Kadastrale

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Kolonjë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, planifikimit, realizimit të prokurimeve dhe zbatimit të kontratave të lidhura për punë publike, planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, aktivitetin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 21.11.2022 deri në datën 23.01.2023 u krye auditimi, i cili kishte objekt: “Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë të Bashkisë Kolonjë” dhe mbuloi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, auditim financiar, si dhe auditim përputhshmërie për periudhën 01.07.2021-31.12.2021.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 13 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikim. Mbi aktet e mbajtura nga grupi i auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur.

-Për projekt raportin e auditimit nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim rezultoi se nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatua se në:

-3 raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e kriterëve për kualifikim. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjestim dhe të lidhur ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës.

-1 rast OE është shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit.

- 4 raste në auditimin e zbatimit të kontratave për punë publike të lidhura nga Bashkia Kolonjë, rezultoi se nga Bashkia Kolonjë janë kryer likujdime në vlerën **8,211** mijë lekë, për punime të pakryera, me efekt dëm ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Kolonjë.

- 4 raste nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës dhe atë sektorial, në miratimin e aplikimeve për deklarata paraprake për kryerje punimesh, si dhe të lejeve të ndërtimit.

Gjithashtu nga auditimi i:

-Veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme, kjo strukturë nuk e ka përmbushur qëllimin e saj, garantimin dhe mbrojtjen për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas kuadrin rregullator të fushës, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore përkatëse.

-Debitorëve të Bashkisë Fushë Arrëz, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh në vlerën 11,190,303 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kolonjë.

-Kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme me palët e treta, rezulton se më datën 31.12.2021 si rrjedhojë e mospagesës së detyrimeve kontraktuale janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, në vlerën 32,522,494 lekë.

-Raportimit të transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021, ka rezultuar kontabilizimi jo i saktë dhe i drejtë për:

-Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, është pasqyruar më pak për vlerën 20,423,001 lekë;

-Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është pasqyruar më shumë për vlerën 1,625,303 lekë;

-Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 183,672,132 lekë.

- Llogaria nr.231 “Investime në proces”, është pasqyruar më pak për vlerën 181,505,907 lekë;
- Llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore”, është pasqyruar më shumë për vlerën 173,710,393 lekë;
- Llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, është pasqyruar më pak për vlerën 8,487,049 lekë.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut”, me vlerë 274,456,182.47 lekë me TVSH, fituar nga BOE “A “& “4” Sh.P.K, rezultuan diferenca në volume dhe punime ndërtimi të pakryera, në vlerën 5,333,249 lekë pa TVSH, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlera 942,303.20 lekë, përfaqëson dëm ekonomik për punime ndërtimi të pakryera në vepër, për zërat “(2.373) Vetrato xhami i temperuar brenda godinës” dhe “(3.An/56) F. Montim shtyllë konike 9 ml, LED me dy krahë çdo 30 ml përfshirë të gjithë aksesoret e nevojshëm”. - Vlera 4,390,946.15 lekë, përfaqëson dëm ekonomik për diferenca në volume punime ndërtimi, për pajisje hidraulike dhe mosfunksionim të Scadës. 	54-93	I Lartë	<p>Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej 942,303.20 lekë pa TVSH nga shoqëria BOE “A “& “4” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 2104 Prot., datë 08.06.2020 me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” Bashkia Kolonjë .</p> <p>Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe grupin e kolaudit të punimeve si dhe Ndërmarrjen e Ujësjetës Kanalizime Sh.A Kolonjë në cilësinë e administrimit të investimit, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pa vendosura në objekt.</p> <p>Dalja e përgjegjësisive, realizimi i zërave të punimeve sipas PZ dhe ST në shumën 4,390,946.15 lekë, të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kolonjë, Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve Sh.A Kolonjë, Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Grupi i Kolaudit të punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë me datë 25.04.2024. Në rast të kundërt, mosvendosja e pajisjeve dhe vënies në funksion të scadës, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.</p>
2	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë”, me vlerë 75,131,311 lekë me TVSH, fituar nga BOE “K“ & “A” Sh.P.K, rezultuan diferenca në volume dhe punime ndërtimi, në vlerën 1,264,272 lekë pa TVSH.</p>	54-93	I Lartë	<p>Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, ku rezultuan punime të pakryera.</p> <p>Dalja e përgjegjësisive, mbi kryerjen e zërit “Gërmim dheu me krahë bankinë kanali” sipas PZ dhe ST në shumën 1,264,272 lekë, të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kolonjë, sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve si dhe kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë me datë 25.10.2023. Në rast të kundërt, diferenca në sasi dhe në vlerë do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.</p>
3	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës”, me vlerë 391,298,650 lekë me TVSH, fituar nga OE “A” SHPK, rezultuan diferenca në</p>	54-93	I Lartë	<p>Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej 1,323,023 lekë pa TVSH nga shoqëria OE “A” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 1022 Prot., datë 25.02.2021 me objekt “Rrjeti</p>

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	volume dhe punime ndërtimi të pakryera, në vlerën 1,323,023 lekë pa TVSH.			shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës” Bashkia Kolonjë.
4	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit” Bashkia Kolonjë, me vlerë 497,280,095 lekë me TVSH, fituar nga OE “A” Sh.P.K, rezultuan diferenca në volume dhe punime ndërtimi, në vlerën 290,800 lekë pa TVSH.	54-93	I Lartë	Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej 290,800 lekë pa TVSH nga shoqëria OE “A” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 5151 Prot., datë 29.10.2020 me objekt “Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit” Bashkia Kolonjë.
5	Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2021, u konstatua se në fillim të vitit 2021 kanë qenë debitor 28 subjekte të biznesit të madh në vlerën 4,622,879 lekë, 67 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 3,436,058 lekë dhe 1 institucion në vlerën 661,339 lekë. Në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive rezultojnë debitor, 31 subjekte të biznesit të madh në vlerën 5,935,411 lekë, 85 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 4,369,959 lekë, 1 institucion në vlerën 754,139 lekë dhe 1 subjekt (NIPT sekondar) për tarifave vendore sipas kohëzgjatjes së kantierit në vlerën 130,794 lekë, pra gjithësej 11,190,303 lekë për 118 subjekte, pra gjatë vitit 2021 janë krijuar 38 subjekte debitorë për vlerën 2,246,433 lekë, nga të cilët 21 subjekte rezultojnë debitor për herë të parë, ndërkohë që 17 subjekte të tjerë janë debitor edhe në vitet e mëparshme, veç debisë së krijuar në vitin 2021. Për debitorët të krijuar brenda vitit 2021 nuk është përlllogaritur rast pas rasti kamatvonesë për subjektet debitore. Gjithashtu për subjektet nuk janë marrë masa shtrenguese, bllokim të llogarisë bankare, kufizim të pasurisë së paluajtshme, aktivitetit etj	20-43	I Lartë	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 11,190,303 lekë për 118 subjekte (principal dhe kamatë vonesë).
6	Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga DATT Bashkia Kolonjë, regjistrin të taksave dhe tarifave vendore për subjektet që kanë ushtruar aktivitet në vitin 2021 në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, si dhe kryqëzimi i informacionit me databasën e DRT Korçë për subjektet me statusin “aktiv” për vitin 2021, u konstatuan mangësi në informacionin e administruar nga DATT Bashkia Kolonjë. Konkretisht mangësitë u konstatuan mosadministrimin e informacionit për 11 subjekte që kanë ushtruar aktivitet në Bashkinë Kolonjë, si dhe për disa subjekte të cilat janë biznes i madh, në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore administrohen si biznes i vogël . -Sa më sipër konstatohet se për vitin 2021, në 11 raste subjekte të kategorisë “biznes i madh” dhe “biznes i vogël” në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, nuk janë taksuar saktë/aspak, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 329,666 lekë.	20-43	I Lartë	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave të marrë masat e nevojshme, për saktësimin e informacionit për subjektet e mësipërme, në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore, me qëllim taksimin e drejtë dhe të plotë të tyre, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 329,666 lekë ndaj 11 subjekteve.
7	Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2021, u konstatua se në fund të vitit 2020 në mënyrë progresive janë 4396 familje debitorë për vlerën 26,424,512 lekë dhe në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive janë 3653 familje debitorë për vlerën 33,065,205 lekë, nga të cilat, në vitin 2021 është krijuar 6,640,693 lekë debi. Pra në	20-43	I Lartë	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 33,065,205 lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	krahasim me vitin 2020, në fund të vitit 2021 kemi rritje të vlerës debitore për taksat dhe tarifatat për kategorinë “familje”, ç’ka tregon për performancë të dobët të Bashkisë Kolonjë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme. Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nuk janë marrë masa (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitore.			
8	Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kolonjë me palët e treta, konkretisht të respektimit të detyrimit kontraktor për pagesën e qirasë (për vitin 2021), përlllogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se në vitin 2021, janë krijuar 14 subjekte debitorë për vlerën 3,297,780 lekë, si dhe progresivisht në fund të vitit 2021 janë 23 subjekte për vlerën 32,522,494 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e këtyre subjekteve, konstatohet se nuk janë njoftuar subjektet për zgjidhje të njëanshme të kontratës së qirasë, si dhe nuk është hapur proces gjyqësor, me qëllim mbledhjen e detyrimeve me forcë nëpërmjet shërbimit të përmbartimit.	20-43	I Lartë	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore 32,522,494 lekë (principal dhe kamatë vonesë).
9	Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Kolonjë (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Kolonjë) u konstatua se nga DATT, Bashkia Kolonjë, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e bashkisë. Nga përlllogaritjet e kryera rezulton se për vitin 2021 në 6 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit në vlerën 265,527 lekë gjithësej, si dhe 130,794 lekë 1 subjekt që nuk ka kryer likuidimin e tarifës së kantierit, gjithësej 396,321 lekë vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kolonjë	20-43	I Lartë	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore 396,321 lekë, ndaj 6 subjekteve.

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

Opinionimi mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Kolonjë për vitin ushtrimor 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200¹, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, **shprehim një**

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit. Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

opinion të modifikuar² për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Kolonjë, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të cilat janë të shprehura në bazën për opinionin e modifikuar.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Kolonjë, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISSAI 1700.7).

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 16,053 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin vlerën e tyre reale, si vijon:

- Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, është pasqyruar më pak për vlerën 20,423,001 lekë;
- Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është pasqyruar më shumë për vlerën 1,625,303 lekë;
- Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 183,672,132 lekë.
- Llogaria nr.231 “Investime në proces”, është pasqyruar më pak për vlerën 181,505,907 lekë;
- Llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore”, është pasqyruar më shumë për vlerën 173,710,393 lekë;
- Llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, është pasqyruar më pak për vlerën 8,487,049 lekë.

Opinion mbi përputhshmërinë për periudhën 01.07.2021 - 31.12.2021

Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur përsa i takon çështjeve të audituara është ose jo në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit³, mbështetur në standardet **ISSAI 4100 shprehim një opinion të kundërt⁴** për përputhshmërinë.

Në auditimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.07.2021 – 31.12.2021, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkinë Kolonjë, bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriteret të plotësuar, në miratimin e aplikimeve për deklarata paraprake për kryerje punimesh, lejeve të ndërtimit, si dhe inspektimeve për kontrollin e punimeve të ndërtimit, ku sipas rastit është konstatuar tejkallim i kompetencave ligjore dhe devijim nga kuadri rregullator i fushës, që janë baza për dhënien e një opinionit të kundërt.

Baza për dhënien e opinionit

Opinionin e dhënë mbi përputhshmërinë e mbështesim në konstatimet e mëposhtme:

- Në auditimin e zbatimit të kontratave për punë publike të lidhura nga Bashkia Kolonjë,

² Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

³ Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryej ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300).

⁴ ISAI 4100: Në një auditim përputhshmërie, audituesi duhet të shprehet se deri në çfarë shkalle fusha e audituar është në përputhje me kriteret e vendosura, si dhe duhet të shprehë një **opinion të kundërt** kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura në çështjen e audituar.

rezultoi se nga Bashkia Kolonjë janë kryer likujdime në vlerën **8,211** mijë lekë, për punime të pakryera, me efekt dëm ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Kolonjë.

- Në 3 procedura prokurimi të audituara me fond limit **6,249** mijë lekë, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriterëve jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP.

- Në 1 procedurë prokurimi të zhvilluar me vlerë kontrate **2,032** mijë lekë, OE i kualifikuar nuk plotëson kriteret e vendosura.

- Mosrespektimin e detyrimeve kontraktuale nga subjektet private për asete të marra me qira, në vlerën **22,794** mijë lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë.

- Bashkia Kolonjë në rolin e autoritetit vendor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në **4 raste** nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës dhe atë sektorial, në miratimin e aplikimeve për deklarata paraprake për kryerje punimesh, si dhe të lejeve të ndërtimit.

Sa më sipër, shkeljet dhe mangësitë e evidentuara përmbajnë gabime material dhe të përhapura (ISSAI 400 & ISSAI 4000). Për këto arsye kemi dhënë opinion të kundërt.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kolonjë

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Kolonjë, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrin rregullator të fushës.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Staf drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1025/3 datë 21.11.2022 prot., i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “Bashkia Kolonjë” nga data 21.11.2022 deri në datën 23.01.2023, u krye “*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*”, i cili mbuloi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021,

auditim financiar, si dhe auditim përputhshmërie për periudhën 01.07.2021-31.12.2021, nga grupi i auditimit me përbërje:

- 1.K.K, Auditues, Përgjegjës Grupi.
- 2.A.G, Auditues, Anëtar.
- 3.A.D, Auditues, Anëtar.
- 4.S.M, Auditues, Anëtar.
- 5.G.K, Auditues, Anëtar.

II.1. Objektivi i auditimit.

-Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

-Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve, planifikimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit.

II.2. Qëllimi i auditimit.

-Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

-Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara, miratimin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit, si dhe kontrollin e territorit për ndërtimin e objekteve pajisur me leje zhvillimi dhe ndërtimi, ose deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, për periudhën objekt auditimi.

-Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

II.3. Identifikimi i çështjes.

Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbyshjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kolonjë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm;
2. Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
3. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4. Raportimi financiar;
5. Planifikimi, realizimi i prokurimeve dhe zbatimi i kontratave të lidhura për investime në punë publike, për periudhën 01.07.2021-31.12.2021;
6. Aktiviteti i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, për periudhën 01.07.2021-31.12.2021;
7. Planifikimi dhe zhvillimi i teritorrit, për periudhën 01.07.2021-31.12.2021;
8. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Niveli drejtues i Bashkisë Kolonjë (Kryetari i bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtori i Drejtorisë së Financës, në rolin e

Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontrolleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Kolonjë, Drejtorët e drejtorive dhe Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Kolonjë kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

II.5.Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që në t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

II.6.Kriteret e vlerësimit.

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

Lloji i dokumentit: **Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore.**

Standardet e auditimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;

Ligje: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit

buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”;
Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”
Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;
Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
Ligji nr.9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar;
VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar;
VKM nr.736, datë 1.7.2009 për disa ndryshime në VKM nr.808, datë 4.12.2003 të këshillit të ministrave “Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”;
VKM nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar;
Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
Udhëzimi i MFE nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
Udhëzimi i MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJVQ-ve”;
Udhëzimi i MFE nr.10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj;
Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;
Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;
Rregullore mbi organizimin e funksionimit të Bashkisë, etj.

VKM:

Udhëzime:

Rregullore:

II.7.Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 100, 200, 400, Manualit të Auditimit të Financiar dhe të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

II.8.Metodat e auditimit.

1. Kontrolli aritmetik.
2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.
3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.
4. Kontrolli i vlerësimeve.
5. Konfirmimi nga të tretët.
6. Kontrolli sipas një treguesi.
7. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe MFK.

II.9.Dokumentimi i auditimit.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve 13 gjithësej dhe akt-verifikimeve 1 gjithësej, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë edhe materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III.PËSHKRIMI AUDITIMIT

III.1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Kolonjë”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës (*materiale por jo të përhapura*), si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve, lejeve të ndërtimit etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik.

Zona Gjeografike: Bashkia Kolonjë kufizohet në veri me Bashkitë Devoll dhe Korçë, në perëndim dhe jug me Bashkinë Përmet, ndërsa në lindje me Shtetin e Greqisë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Ersekës. Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Ersekë, Qendër Ersekë, Leksovik, Qendër Leksovik, Novoselë, Barmash, Mollas dhe Çlirim. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Kolonjës dhe qarkut të Korçës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Ersekë dhe Leskovik) dhe 76 fshatra.

Administrata e Bashkisë Kolonjë, përbëhet nga:

- Sekretari i Këshillit Bashkiak (1);
- Kryetari i Bashkisë (1), Punonjës Sekretarie (1), Zv. Kryetari (2), 11 Drejtori (5), 22 Sektorë (143), 2 Njësi me funksione të ndryshme, Njësia e auditimit të brendshëm dhe emergjencat civile (6), 4 Njësi Administrative (14), Policia Bashkiake (10), Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (2), Gjendja Civile (4), Qendra Kombëtare e Biznesit (2), Punonjës të shërbimit publik (68); Drejtorja e Çerdheve dhe Kopshteve (41); Sektori i Arsimit (7); Sektori i Konviktit (7); QKF (4); Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi (14); Drejtorja e Bujqësisë (14).

Njësitë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Kolonjë:

Drejtorja e Promovimit të Qytetit (16);
Sport Klub Gramozi (5).

Funksionet kryesore të Bashkisë Kolonjë kryhen në fushën e:

-Infrastrukturës dhe shërbimeve publike.
-Shërbimeve sociale.
-Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.
-Mbrojtjes së mjedisit.

- Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike.
- Zhvillimit ekonomik vendor.
- Sigurisë publike.

Financat.

Bashkia Kolonjë ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

- a) krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
- b) vendos taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) harton, miraton dhe zbaton buxhetin e tyre;
- ç) mban llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofron informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

-Për vitin 2021 nga Bashkia Kolonjë janë shpenzuar gjithësej 1,000,899 mijë lekë, nga të cilat:

- 613,643 mijë lekë për investime;
- 143,029 mijë lekë për paga;
- 98,491 mijë lekë për mallra të ndryshëm;
- 114,651 mijë lekë për transfera në ndihmë ekonomike për familje në nevoj, invalidë etj.

-Për vitin 2021 Bashkia Kolonjë nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithësej 65,129 mijë lekë.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

III.2.1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditin i Brendshëm.

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësori i Vetëvlerësimit.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Kolonjë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Titulli i gjetjes: Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit⁵.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, është pjesërisht efektiv, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i Kontrollit”

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë.
- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.
- Në Bashkinë Kolonjë nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.

“Menaxhimi i Riskut”

- Nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar).
- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuara.
- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Kolonjë.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Kolonjë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.
- Në Bashkinë Kolonjë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.
- Në Bashkinë Kolonjë, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

⁵ Trajtuar më hollësisht në Kapitullin “Aneke” – “Aneksi nr.1” të raportit përfundimtar të auditimit.

-Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, kjo evidentuar nga lista e projekteve në PBA 2021-2023, të cilët nuk i nënshtrohen një analize kosto-përfitim.

“Informimi dhe Komunikimi”

-Për vitin 2021 nga Bashkia Kolonjë (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajtshme me qira, buxhetin etj.), nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

“Monitorimi dhe Raportimi”

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore nuk lidhet me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Znj. S.R, ish Drejtores e Drejtorisë Ekonomike, Financës dhe Buxhetit dhe Z. F.F, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Risk i shtuar për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shkaku: Mungesa e zbatimit efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit, administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

-Kryejën e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Kolonjë.

III.2.1.1. Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kolonjë;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2021;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 315 datë 30/12/2021, si pjesë përbërëse e strukturës organizative për zbatimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 66 datë 28/12/2021 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Kolonjë, Institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative dhe Funksionet e deleguara për vitin 2021. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryej auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Kolonjë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik dhe Kartën e Auditimit, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 859/1 prot., datë 10.02.2020 (e përditësuar).

Auditi i Brendshëm i Bashkisë Kolonjë është i organizuar me 3 (tre) punonjës, 1 (një) përgjegjës auditit dhe 2 (dy) specialist auditit duke u bazuar në Ligjin nr.114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 10 në VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësisë auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik“ pika 3, Nga auditimi u konstatua se struktura e Auditit të Brendshëm për periudhën objekt auditimi (01.01.2021-31.12.2021) nuk ka në organikën e vetë 3 auditues sipas VKM -së sipër cituar, por është e organizuar me 2 auditues, z. F.Z i çertifikuar, i cili është i komanduar si përgjegjës sektori me urdhër nr. 171 datë 16.04.2020 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë dhe z. I.J i cili është specialist i auditit të brendshëm, i çertifikuar. Si rezultat funksionimi i Sektorit të Auditit të Brendshëm nuk është në nivelin e duhur në mbështetje të menaxhimit të lartë për zbatimin e objektivave, në Bashkinë Kolonjë, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me gërmën ‘c’ në nenin 10 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Pika 3 në VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësisë auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe gërma “a” në nenin 64 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur struktura e sektorit të auditit të brendshëm, si vijon;

Struktura e njësisë AB për vitin 2021

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime te vijueshme
	Për vitin 2021							
1	F.Z	P/Njesisë	16.04.2020	Univ.Tiranë/Financë	26	5	Viti 2018	po
2	I.J	Specialist	22.02.2017	Univ.Tiranë/F.Ekon.	26	5	Viti 2018	po

Burimi: NJAB Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2021.

Nga Sektori i Auditit të Brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit në zbatim të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin Publike”, Planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të dërguar në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave) dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Nga auditimi rezultoi se:

Për vitin 2021, Plani vjetor i auditimeve i miratuar me shkresën nr. 928 prot., datë 09.03.2021, përcjellë pranë Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në MFE, raporti i veprimtarisë së sektorit të AB, sipas të cilit janë planifikuar për t’u kryer 6 auditime dhe janë realizuar 5, pasqyruar si më poshtë:

Nr	Planifikuar	Nr Auditime	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr Auditime	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputhsh	Perform	Financ	IT	Kombin		
1	Drejtoria e Të Ardhurave	1	Drejtoria e Të Ardhurave	1	1		1			1	
2	Drejtoria e Plan Zhvillimit	1	Drejtoria e Plan Zhvillimit	1	1		1			1	
3	Spektori i Policisë Bashkiake	1	Spektori i Policisë Bashkiake	1	1					1	
4	Spektori i Gjendjes Civile	1	Spektori i Gjendjes Civile	1			1			1	
5	Drejtoria e Financës	1			1						
6	Detyrimet e Prapambetura	1	Detyrimet e Prapambetura	1	1					1	1
		6	Totali	5	5	0	3	0	0	5	1

Burimi: NJAB Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivitetin e vitit 2021 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr.617 prot., datë 11.02.2022.

-Plani strategjik 2021-2023 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2021 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.4943 prot., datë 19.10.2020.

-Karta e auditimit të brendshëm është miratuar nga Titullari i Bashkisë Kolonjë me urdhrin nr.859/1 prot., datë 10.02.2020.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2021, konstatohet se janë dhënë 19 rekomandime gjithsej, Rekomandimet janë pranuar të gjitha, prej të cilave 13 prej tyre janë zbatuar, 4 janë në proces zbatimi dhe 2 nuk janë zbatuar. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura ne numër				Rekomandime të shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pa Zbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2021	19	14	3	2	1			1
TOTALI		19	13	4	2	1			1

Burimi: NJAB Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i Gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Kolonjë, përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2021.

Situata: Për vitin 2021, numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë kanë qenë 2 punonjës të punësuar.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njesisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2021-2023 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së miratuar, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njesisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;

-Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njesisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm;

-Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit;

-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2021, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

-Për periudhën 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kolonjë, të cilat janë me risk të lartë, si Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve, Sektori Juridik dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”.

-Për vitin 2021 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për tu kryer 6 auditime dhe janë kryer 5 gjithsej.

Nr	Planifikuar	Kryer
1	Drejtoria e Të Ardhurave	Drejtoria e Të Ardhurave
2	Drejtoria e Plan Zhvillimit	Drejtoria e Plan Zhvillimit
3	Sektori i Policisë Bashkiake	Sektori i Policisë Bashkiake

4	Sektori i Gjendjes Civile	Sektori i Gjendjes Civile
5	Drejtoria e Financës	
6	Detyrimet e Prapambetura	Detyrimet e Prapambetura
		Totali

Në dosjet e përzgjedhura për auditim, u konstatua se:

1. Në dosjen e auditimit në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim Taksave, nuk administrohet vlerësimi i riskut, nuk dokumentohen metodat e përdorura në auditim.

2. Në auditimin e Drejtorisë së Financës (zyrës së gjendjes civile), nuk administrohet njoftimi për fillimin e auditimit, vlerësimi i riskut, nuk dokumentohen metodat e përdorura në auditim.

3. Në dosjen e auditimit të Policisë Bashkiake, nuk administrohet vlerësimi i riskut, nuk dokumentohen metodat e përdorura në auditim.

Kriteri: Shkronja “ç” në nenin 6, shkronja “ç” pika 2 në nenin 11, nenin 12, nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdherin nr.100, datë 25.10.2016”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhri e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar;

-Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

-Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.

Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

-Plotësimin e strukturës së NJAB Kolonjë;

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucionale.

III.2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2021.

➤ Dokumentacioni i audituar si më poshtë:

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;

2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;

3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat;

4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;

5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendime gjyqësore;

6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrit të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.

7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;

8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “EXCEL”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2021.

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se për vitin 2021 për përgatitjen e PBA 2021-2023 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.176, datë 23.12.2020, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 1104/1 prot., datë 08.01.2021. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimin të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Kolonjë.

Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- a. Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit.
- b. Ndërtimi i veprave publike (ujësjellës).
- c. Rikonstrukcion të objekteve shkollore.
- d. Mirëmbajtje të rrugëve dhe ndriçimi i tyre.
- e. Ndërtime për park lojërash për qytetin.

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njëjësive të Qeverisjes Vendore”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).

Programi i të ardhurave për vitin 2021 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr.15, datë 12.01.2021.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Kolonjë për vitin 2021 është 1,000,899 mijë lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2021, realizohen nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionët e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitet 2021-2023, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.1 PBA për periudhën 2021-2023 sipas programeve ekonomike që menaxhon
Bashkia Kolonjë

Nr.	Kodi	Emërtimi	PBA 2021	Buxheti vjetor 2021 (Plani i Rishikuar)	Realizimi periudhës progresiv	Diferenca
			(1)	(2)	(3)	(3-2)

1	1110	Planifikimi, Menaxhim, Administrim	45,973	49,631	45,161	-4,470
2	1120	Çështjet Financiare dhe Fiskale	17,644	17,257	16,551	-706
3	1170	Gjendja Civile	35	3,145	3,077	-68
4	3140	Shërbimet Policore	6,158	6,158	5,615	-543
5	3280	Shërbimet e mbrojtjes nga Zjarri	15,883	16,961	16,507	-454
6	3600	Marëdhënie me Komunitetin	2,956	2,456	2,133	-323
7	4130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik QKB		1,723	1,554	-169
8	4220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Ushqimi	6,115	5,515	5,247	-268
9	4240	Menaxh i infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	16,195	74,755	67,318	-7,437
10	4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	26,855	28,020	17,587	-10,433
11	4520	Rrjeti rrugor rural	8,895	11,408	11,259	-149
12	4760	Zhvillimi i Turizmit	9,250	9,250	8,178	-1,072
13	5100	Menaxhimi i Mbetjeve	21,524	20,537	20,114	-423
14	5320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	1,521	1,521	1,377	-144
15	6140	Urbanistika	4,062	3,762	3,344	-418
16	6260	Shërbime Publike	36,030	57,961	52,743	-5,218
17	6440	Ndriçimi Rrugor	11,837	11,837	10,725	-1,112
18	8130	Sporti dhe Argëtim	6,490	7,490	6,747	-743
19	8220	Tashëgimnia Kulturore, Eventet, Artistike	6,070	6,070	4,534	-1,536
20	9120	Arsimi Parashkollor	38,852	44,769	40,743	-4,026
21	9230	Arsimi Parauniversitar	14,757	15,633	12,379	-3,254
22	10140	Kujdesi Social për Personat e sëmurë dhe me aftësi të Kufizuara	3,264	3,264	3,260	-4
23	10430	Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijë	1,196	115,245	114,610	-635
24	10661	Strehimi Social	2,360	2,360	1,931	-429
		Totali i Shpenzimeve të Njësisë	303,887	1,072,249	1,000,899	-71,350

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2021-2023, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezultojnë se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është - 71,350 mijë lekë. Diferencë e konsiderueshme rezultojnë në programin ekonomik për “Administrimin e Pyjeve dhe Kullotave”, “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”, “Shërbime Publike”, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, “Arsimi Parashkollor”, “Arsimi Parauniversitar”.

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2021-2023 Bashkia Kolonjë ka planifikuar të ardhurat të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2 Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Plan 2021
Te ardhura tatimore	17,674
Te ardhura jotatimore	47,455
TOTAL	65,129

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i gjetjes: Zbatimi i Procedurave në përgatitjen e PBA 2021-2023.

Situata: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2021-2023, u konstatua se:

- Procedura e përgatitjes së PBA 2021-2023 nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kolonjë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2021-2023, janë miratuar jashtë afateve;

- Në buxhetin vjetor të vitit 2021 nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor.

Kriteri: Pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore”. Udhëzimi nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023”.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti: Planifikim jo i saktë dhe real i kërkesave buxhetore, si dhe mos kryerjen e investimeve në fusha të caktuara të aktivitetit të Bashkisë Kolonjë.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë dhe Drejtoria e Financës, gjatë hartimit dhe miratimit të PBA-së, të marrin masat për:

- Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;
- Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;
- Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;
- Planifikimin e fondeve për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kolonjë.

2.2.2 Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.

Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të KB.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Kolonjë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Kolonjë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit Kolonjë, e reflektuar në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Korçë.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Tabela nr. 3 Planifikimi i buxhetit për vitin 2021, Bashkia Kolonjë

Planifikimi i të ardhurave 2021		Planifikimi i shpenzimeve 2021	
Burimi i të ardhurave	000/ lekë	Emërtimi i zërave	000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2021	80,470	Art. 600 Paga	150,806
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2021		Art.601 Sigurime shoqërore dhe shend.	26,150
Total të ardhurat e veta	80,470	Art.602 Shpenzime operative	91,935
Transfertë e pa kushtëzuar	122,401	Art.604 Transferime korrente te brendshme	
Transfertë e pa kushtëzuar sektoriale	98,745	606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	
Transfertë specifike	2,271	Art.230-231 Investime	29,326
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2021		Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	5,671
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	223,418		
Totali të Ardhurave	303,888	Totali Shpenzimeve	303,888

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Rezulton se buxheti i konsoliduar (Bashki+Njësia e Varësisë Agjencia e Shërbimeve Komunale) vitit 2021 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 303,888 mijë lekë.

-Për vitin 2021, kanë ndodhur 4 ndryshime buxhetore me vlerë 42,660 mijë lekë, veprime që tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Tabela nr.4 Ndryshimet buxhetore për vitin 2021

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				
	Nr. datë	Vlera	Nr.datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli				
					Shtesa.Art.	Shuma	Pakësim.Art.	Shuma	
Viti 2021	171/23.12.2020	527,572	17/29.01.2021	38,804	602	11,372			
					604	200			
					230+231	27,232			
			26/26.02.2021	2,743	600	2,350			
					601	393			
		49/29.03.2021	500	602	500		600	500	
		128/15.12.2021	613	602	613				
Totali Viti 2021		527,572	4	42,660					

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.5 Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik

Nr.	Kodi	Emërtimi	Buxheti Vjetor 2021 (Plani i rishikuar)	Realizimi	Në %
1	1110	Planifikimi, Menaxhim, Administrim	49,631	45,161	91%
2	1120	Çështjet Financiare dhe Fiskale	17,257	16,551	96%
3	1170	Gjendja Civile	3,145	3,077	98%
4	3140	Shërbimet Policore	6,158	5,615	91%
5	3280	Shërbimet e mbrojtjes nga Zjarri	16,961	16,507	97%
6	3600	Marëdhënie me Komunitetin	2,456	2,133	87%
7	4130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik QKB	1,723	1,554	90%
8	4220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Ushqimi	5,515	5,247	95%
9	4240	Menaxh i infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	74,755	67,318	90%
10	4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	28,020	17,587	63%
11	4520	Rrjeti rrugor rural	11,408	11,259	99%
12	4760	Zhvillimi i Turizmit	9,250	8,178	88%
13	5100	Menaxhimi i Mbetjeve	20,537	20,114	98%
14	5320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	1,521	1,377	91%
15	6140	Urbanistika	3,762	3,344	89%
16	6260	Shërbime Publike	57,961	52,743	91%
17	6440	Ndriçimi Rrugor	11,837	10,725	91%
18	8130	Sporti dhe Argëtim	7,490	6,747	90%
19	8220	Tashëgimnia Kulturore, Eventet, Artistike	6,070	4,534	75%
20	9120	Arsimi Parashkollor	44,769	40,743	91%
21	9230	Arsimi Parauniversitar	15,633	12,379	79%
22	10140	Kujdesi Social	3,264	3,260	100%
23	10430	Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijë	115,245	114,610	99%

24	10661	Strehimi Social	2,360	1,931	82%
Totali i Shpenzimeve të Njësisë			1,072,249	1,000,899	93%

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:

Për vitin 2021 realizimi i buxhetit është në nivelin 93%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është “Transferta Korente të Brendshme”, “Garanci Punimesh”, “Transferta për Buxhetin Familjar dhe Individ”, Kapitale të Patrupëzuara, Paga”; Programi me realizimin më të ulët është “Fondi Rezervë dhe Emergjencat”;

2.2.3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Kolonjë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Kolonjë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të KB ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror.


Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2021-2023, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.6 Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2021

Art.	Emertimi	Plani progresiv	Fakti	%
600	Paga	147,721,329	143,029,511	97%
601	Sigurime Shoqërore	26,529,403	23,619,589	89%
602	Shpenzime operative	114,513,914	98,491,486	86%
604	Transferta Korente të Brendshme	1,296,394	1,296,394	100%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	115,002,432	114,651,656	100%
609	Fondi reserve + emergjencë	2,740,001	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara	2,600,000	2,557,486	98%
231	Kapitale të Trupëzuara	658,335,865	613,643,966	93%
466	Garanci Punimesh	3,609,338	3,609,338	100
TOTAL		1,072,348,676	1,000,899,426	93%

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Grafiku nr.1 Peshë e secilit artikull ndaj totalit



Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2021 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 93 %, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 604 “Transferta korrente të brendshme”, ku përfshihen ndihma ekonomike, duke vijuar me transferta për buxhet familjar dhe individ, kapitale të trupëzuara, shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, ndjekur nga kapitale të trupëzuara si dhe realizimin më të ulët e kanë

shpenzimet operative. Vihet re se për vitin 2021 art. (602) transferta korente të brendshme paraqiten 86 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

➤ **Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.**

Tabela nr.7 Buxheti sipas burimeve të financimit 2021

Art.	Emertimi	Fakt 2021				
		Gjithesëj	Nga të ardhurat e veta	Tr. Pakushtëzuar	Tr. kushtëz. Specifike	Tr. e Kushtëzuar
600	Paga	143,029,511	21,878,971	56,375,521	61,088,211	3,686,808
601	Sigurime Shoqërore	23,619,589		12,837,117	10,184,277	598,245
602	Shp. Operative	98,491,486	34,679,307	38,436,897	25,307,194	68,088
604	Transf. Korrente të brendshme	1,296,394		200,000	1,096,394	
606	Transf. për familje dhe individ	114,651,656	120,000	157,120	114,124,536	250,000
230-231	Investime	616,201,452	12,834,424	33,212,785	570,154,243	
	Garanci Punimesh	3,609,338	3,609,338	0	0	0
	Total	1,000,899,426	73,122,040	141,219,440	781,954,805	4,603,141

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferta e kushtëzuar specifike, në vlerën 781,954 mijë lekë, kanë peshën më të lartë në krahasim me burimet e tjera të të ardhurave të Bashkisë Kolonjë, ndjekur nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 141,219 mijë lekë, nga të ardhurat e veta në vlerën 73,122 dhe transferta e kushtëzuar në vlerën 4,603 mijë lekë.

Transferta e kushtëzuar specifike.

-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2021 është realizuar në vlerën 781,954 mijë lekë, ose 78% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar specifike, e zënë fondet e shpenzuara për investime, paga dhe fonde të shpenzuara për transferime.

Transferta e pakushtëzuar.

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për vitin 2021 është realizuar në vlerën 141,219 mijë lekë, ose 14 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

Të ardhurat e veta.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2021 është realizuar në vlerën 73,122 mijë lekë, ose 7.3 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga, investime dhe shpenzime operative.

Transferta kushtëzuar.

-Buxheti nga transferta specifike për vitin 2021 është realizuar në vlerën 4,603 mijë lekë, ose 0.5 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda transfertës specifike, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe sigurime shoqërore.

-Fonde nga FZHR nuk ka pasur.

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.**

Me miratimin e buxhetit për vitin 2021 është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin 2021 është planifikuar në masën 3,400 mijë lekë nga e cila 3,000 mijë lekë nga transferta e pakushtëzuar dhe 400 mijë lekë nga të ardhurat e veta. Sipas të dhënave nga Bashkia Kolonjë nga fondi rezerve/dhe kontigjencës janë shpenzuar 769 mijë lekë, për përballimin e shpenzimeve funerale për 3 familje në nevojë të cilat nuk kanë pasur mundësi financiare për përballimin e tyre si dhe për riparimin e makinës teknologjike lloji "Renault". Në fund të vitit 2021, nga fondi rezervë/dhe i kontigjencës ka mbetur pa u shpenzuar vlera 2,630 mijë lekë.

-Totali i fondit rezervë dhe kontigjencës është brenda limitit 3%, përjashtuar transfertën e kushtëzuar.

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.**

Nga Bashkia Kolonjë është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 2,271 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 2,261 mijë lekë, për mbulimin e shpenzimeve për situatën e shkatuara nga reshjet e shiut dhe dëborës në territorin e Bashkisë Kolonjë.

➤ **Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Kolonjë.**

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Kolonjë përgjatë periudhës 2021 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

➤ **Realizimi i Investimeve.**

Titulli gjetjes: Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

Situata: Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet jo të mira në vitin 2021, konkretisht në masën 93 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave , që do të thotë se nga Bashkia Kolonjë në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Kriteri: Shkronja “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Pika 24 dhe 25 në nenin 3, neni 47 në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Shkaku: Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin e të ardhurave të vitit të mëparshëm.

Efekti: Mos realizim i investimeve të planifikuara.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

➤ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak.**

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 446, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Për vitin 2021 Bashkia Kolonjë me shkresën nr. 2639 datë 01.06.2021, ka përcjellë në MFE raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e parë të vitit 2021, me shkresën nr. 4726 datë 30.09.2021 ka përcjellë në MFE raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e dytë të vitit si dhe me shkresën nr. 986 datë 28.02.2022 ka përcjellë në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë raportin vjetor të monitorimit të buxhetit.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

⁶ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshillit për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Kolonjë, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2021 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE, pra jo raportim periodik të tyre. Me fondet buxhetore të vitit 2021, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale. Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2021 ka ardhur duke u ulur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2021.

Tabela nr.8 Detyrimet e prapambetura për periudhën 2021

Detyrime e NJQV 2021	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2020	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2021	Total detyrime	Shlyerja gjate 2021	Mbetja në fund të vitit 2021
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Detyrime për vendime gjyqësore	8,267,536	710,310	8,977,846	5,443,734	3,534,112
Detyrime për shërbime	1,475,420	1,581,322	3,056,742	1,475,420	1,581,322
Detyrime për mirembajtje	904,915	156,800	1,061,715	940,800	120,915
Detyrime për mallra	1,384,800	0	1,384,800	1,384,800	0
Detyrime të tjera	149,219	0	149,219	104,114	45,105
Total Detyrime	12,181,887	2,448,432	14,630,319	9,348,868	5,281,454
Gjendja e llogarisë 520 në fund të vitit 2021 – garancitë e kontratave					22,689,789

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Kolonjë ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2021, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2021, përcjellë në MFE me shkresën nr.160/1 prot., datë 21.02.2022, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kolonjë ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën 5,281,454 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale dhe vendime gjyqësore, pasqyruar në tabelën më poshtë:

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2021, përcjellë në MFE me shkresën nr.160/1 prot., datë 21.02.2022, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kolonjë ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën 5,281,454 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, mallra dhe shpenzime dhe vendime gjyqësore, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.9 Situata Financiare

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	-		
a	Hua sftatjetë	-		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	-		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	5,281,454		
a	Shpenzime korrente	1,747,342		
a,1	Mallra dhe shërbime	1,747,342		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale			
b,1	Institucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore	3,534,112		
c,1	Marrëdhënie pune	460,310		

c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera	3,073,802		
III	Totali (I+II)	5,281,454	230,617,053	2.29%

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i gjetjes: Efektet negative në buxhet si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2021 janë në vlerën 3,534 mijë lekë ose rreth 67% mbi totalin e detyrimeve të raportuara.

Për rrjedhojë kemi një nivel të lartë të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore (të cilat janë nga periudha më të hershme), si dhe nga Bashkia Kolonjë nuk ka patur planifikim të saktë në buxhetet vjetore dhe nuk është respektuar radha e shlyerjes të detyrimeve duke i dhënë prioritet vendimeve gjyqësore të formës së prerë, e cila në 31.12.2021 përbën 67% të totalit të detyrimeve, pra nuk janë respektuar udhëzimet e buxhetit vjetore.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Kolonjë ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, konstatohet se:

- Si rrjedhojë e Vendimit nr. 28, datë 30.10.2020 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Kolonjë është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit "S.G", në vlerën 573,200 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2021 është kryer vetëm një likuidim pjesor në vlerën 250,000 lekë, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Bashkia Kolonjë i detyrohet subjektit "S.G" në vlerën 323,200 lekë të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, efizienz dhe efektivitet.

- Si rrjedhojë e Vendimit nr. 270, datë 04.03.2021 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Kolonjë është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit "H.Z", në vlerën 137,110 lekë, për të cilën nuk është kryer asnjë likuidim.

-Nga shqyrtimi i ditarit të bankës mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa arsye ligjore të subjektit (H.Z), rezulton se përgjatë vitit 2021 nuk është kryer asnjë likuidim i plot/pjesor, si dhe për subjektin (S.G) rezulton se përgjatë vitit 2021 është kryer një likuidim pjesor në vlerën 250,000 lekë, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, efizienz dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".

Kriteri: Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Kolonjë.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kolonjë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kolonjë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

-Shpronësimet për interes publik.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomie, Financës-Buxhetit rezultoi se përgjatë vitit 2021 nuk ka pasur detyrime për shpronësime të krijuara në vitin 2021 apo nga vite të mëparshme dhe të palikujduara.

➤ **Faturat e palikuiduara brenda afatit 30 ditor.**

Titulli gjetjes: Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor përgjatë vitit 2021, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i rradhës në likuidimin e tyre.

Situata: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Kolonjë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2021, ky afat nuk është respektuar në 7 raste për vlerën 5,281,454 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë dhe tabelën analitike në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.2” të raportit përfundimtar të auditimit.

Tabela nr.10 Përmbledhëse e faturave për vitin 2021

Artikulli	Sasia	Viti 2021/lekë
602	7	5,281,454
Totali	7	5,281,454

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën deri në fund të vitit 2021 janë 7 fatura të palikujduara për shpenzime për vendime gjyqësore, shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën 5,281,454⁷ lekë.

-Sa i përket likujdimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet rradha e likujdimit të tyre, pra fatura e parë likujdohet më parë, ilustruar me disa raste.

Konkretisht për rastin e detyrimit ndaj subjektit:

- I.N (Oponencë Teknike), faturë e datës 01.06.2020 në vlerën 284,783 lekë, likujduar më datë 04.08.2021, ndërkohë që deri më datë 04.08.2021 janë likujduar fatura të mbërritura më vonë se fatura e subjektit të mësipërm, si p.sh., subjekti 6 K shpk me faturë të datës 14.10.2020, likujduar më datë 29.04.2021;

- I.S shpk (mirëmbajtje sistemi), faturë e datës 28.08.2020 në vlerën 78,400 lekë, faturë e datës 29.09.2020 në vlerën 78,400 lekë të likujduara më datë 25.11.2021, ndërkohë që deri më datë 25.11.2021 janë likujduar fatura të mbërritura më vonë sesa fatura e subjektit të mësipërm, si psh., subjekti 6 K shpk me faturë të datës 14.10.2021, likujduar më datë 29.04.2021;

- T shpk me faturë të datës 10.09.2018 dhe faturë e datës 4.09.2018 në vlerën 120,915 lekë nuk janë likujduar deri më 31.12.2021 ndërkohë janë likujduar fatura të mbërritura më vonë se faturat e subjektit të mësipërm, si psh., subjekti O shpk me faturë të datës 02.11.2020, likujduar më datë 22.12.2021

-Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i rradhës në likujdimit të detyrimeve të prapambetura.

Kriteri: Pikat 8, 106 dhe 107 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Shkaku: Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i rradhës në likujdimit të detyrimeve të prapambetura.

Efekti: Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikujduara.

⁷ Pasqyruar lista e subjekteve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.2” të raportit përfundimtar të auditimit.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

2.2.5. Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria Ekonomike e Financës dhe Buxhetit për vitin 2021, në lidhje me investimet publike, rezultoi se nuk ka financim projektësh nga FSHZH/FZHR.

Tabela nr.11 Fonde të deleguara për vitin 2021 nga AKUM për investime si dhe likuidimi i tyre

Viti 2021							
Nr.	Objekti i prokurimit	Burimi Financimit	Dt.Lidhjes kontrates	Vlera Kont. Me tvsh	Afati i kontrates	Situacionuar deri 31.12.2021	Likuiduar 31.12.2021
1	Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës	AKUM	25.02.2021	391,298,650	12 muaj	391,298,650	78,048,559

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për vitin 2021, Bashkia Kolonjë ka lidhur 1 kontratë për investim në punë publike me objekt “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës”, me burim financimi nga AKUM. Fondet në vlerën 78,175,192 lekë për këtë objekt janë përcjellë me shkresën nr.362 prot., datë 12.02.2021 dhe deri në fund të vitit janë likuiduar fondet e përcjella nga AKUM.

-Kontratat e mësipërme janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Kolonjë dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Konkluzion i përgjithshëm:

-Buxheti i Bashkisë Kolonjë dhe PBA, në përgjithësi është miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore të ligjit të buxhetit për vitin 2021;

Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuar me VKB;

- Për hartimin e PBA 2021-2023 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Kolonjë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “ç” të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2021-2023, janë miratuar jashtë afateve;

- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;

-Për PBA 2021-2023 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxhetit vjetor, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtoret e Drejtorive të Bashkisë Kolonjë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

-Në PBA, si dhe buxhetin vjetor të vitit 2021, nuk janë planifikuar fonde për investime në fondin pyjor;

-Për vitin 2021 në krahasim me planet vjetore, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 93 %, ku realizimin më të lartë e ka “Transferta Korente të Brendshme”, “Garanci Punimesh”, “Transferta për Buxhetin Familjar dhe Individ”, Kapitale të Patrupëzuara dhe Paga”;

Programi me realizimin më të ulët është “Fondi Rezervë dhe Emergjencat”;

-Nga shqyrtimi i ditarit të bankës mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa shkaqe ligjore, rezulton se përgjatë vitit 2021 janë kryer likuidime të plota/pjesore, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet në vlerën 517,402 lekë si dhe për vendime gjyqësore për çështje të tjera janë likuiduar në vlerën 4,926,332 lekë.

-Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Kolonjë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2021, ky afat nuk është respektuar në 7 fatura për shpenzime për investime dhe shpenzime korrente në vlerën 5,281,454 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. E.I., në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe Nëpunësit Autorizues, si dhe znj. S. R. me funksion ish Drejtore e Drejtorisë së Financës.

2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor⁸.

Në zbatim të pikës II.2, nënpika 2.6, të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1)Evidencat analitike të llogarive debitore për taksat dhe tarifatat vendore.
- 2)Akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.
- 3)Evidencat e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare.
- 4)Të tjera dokumente për arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifatat vendore.
- 5)Vendimin e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale.
- 6)Vendimet e Këshillit të Bashkisë për strukturën organike.

I.Struktura e Drejtorisë së të ardhurave dhe tatim-taksave, Bashkia Kolonjë.

Për vitin 2021 me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr.172, datë 23.12.2020, është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Korçë me shkresën nr.1104/1, datë 06.01.2021. Me urdhrin nr.12, datë 08.01.2021 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sectorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe drejtoria e të ardhurave dhe tatim-taksave (*në vijim DATT*).

-DATT ka në përbërjen e saj, 1 drejtor, 3 specialist dhe 4 inspektor. Gjithashtu në NJA Leskovik është i punësuar 1 specialist për taksat, në varësi organizative të DATT.

Struktura e DATT Bashkia Kolonjë, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2021 pasqyrohet si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemer	Pozicioni	Ndryshimi gjatë 2021
1	Sh.L	Drejtor i te Ardhurave	Nuk ka ndryshime
2	L.K	Specialist Drejtoria e te Ardhurave	Nuk ka ndryshime
3	B.C	Specialist Drejtoria e te Ardhurave	Nuk ka ndryshime
4	D.G	Specialist Drejtoria e te Ardhurave	Nuk ka ndryshime
5	F.N	Inspektore	Kaluar arketare
6	F.Q	Inspektor	Nuk ka ndryshime
7	R.T	Inspektor	Nuk ka ndryshime
8	J.Z	Inspektor	Nuk ka ndryshime

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-DATT Bashkia Kolonjë, për vitin 2021 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Kolonjë nga taksat dhe tarifatat.

II.Taksat dhe Tarifatat e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Kolonjë.

⁸ Observacionet janë trajtuar në Kapitullin “Aneksë” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

Përgjatë vitit 2021, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar 1 paketë fiskale, konkretisht:

-Paketa fiskale për vitin 2021 është miratuar me VKB nr.158, datë 23.12.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.1104/1 prot., datë 06.01.2021.

Titulli gjetjes: Mangësi në ndarjen e detyrave për strukturat e ngarkuara me zbatimin e paketës fiskale 2021.

Situata: Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2021, kryesisht në ndarjen e detyrave, mbi strukturën që bën përlllogaritjen e taksës dhe tarifës dhe strukturën që ngarkohet për vjeljen e saj, konstatohet se për disa lloje taksash dhe tarifash nuk është përcaktuar sektori që do të bëjë përlllogaritjen dhe sektori që do të ndjekë vjeljen e taksës ose tarifës përkatëse. Gjithashtu konstatohet se në raste të caktuara për një lloj takse ngarkohet i njëjti sektor për përlllogaritjen, faturimin dhe vjeljen e taksës. Situata e mësipërme ndigon negativisht në aktivitetin e bashkisë në planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave, pasi krijohet mundësia për mbivendosje të funksioneve, mos identifikim të saktë të përgjegjësisë për veprimin/mosveprimin, paqartësi dhe vonesë në zbatimin e paketës fiskale etj. Mangësitë e mësipërme janë konstatuar në taksën e ndikimit në infrastrukturë, kontrollit veterinar, tarifën e tregtimit, parkimit, licencë/certifikatë në fushën e transportit, shërbimit nga institucionet e arsimit, kulturës, sportit, muzetë, tarifën për ujitjen dhe kullimin, shërbimet administrative, gjueti dhe peshkim, zhvillimin e turizmit.

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në nenin 62 të rregullores së brendshme të Bashkisë Kolonjë, mbanë përgjegjësi z. SH.L, Drejtor i DATT.

Kriteri: Shkronja “f” në pikën 4 në nenin 9, nenin 20 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Situata e mësipërme ndigon negativisht në aktivitetin e bashkisë në planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave, pasi krijohet mundësia për mbivendosje të funksioneve, mos identifikim të saktë të përgjegjësisë për veprimin/mosveprimin, paqartësi dhe vonesë në zbatimin e paketës fiskale etj.

Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave, të marrë masa për ndarjen e qartë të përgjegjësisë në planifikimin, faturimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

-Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Kolonjë, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmbledhur janë aplikuar/mbledhur 36 lloje taksash dhe tarifash.

Për vitin 2021 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, ndahen në 4 kategori:

1.Biznes;

2.Ambulant;

3.Familjar;

4.Institucione.

Kategoritë e mësipërme (përfshirë institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

-Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël.

-Kategoria e tretë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore, si dhe numri i tyre.

Nr	Lloji	2021
1	Biznesi i Madh	46
2	Biznesi i Vogël	238
3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	8
4	Institucione	25
	Total	278

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Të gjitha sa më sipër, mbi planifikimin dhe realizimin e tyre në mijë lekë, për vitin 2021, janë pasqyruar në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

-Për vitin 2021 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **80,470 mijë lekë** dhe janë realizuar në vlerën **65,129 mijë lekë**, ose 81% / rreth 15,134 mijë lekë më pak nga plani.

-Nga viti 2020 në vitin 2021 kemi rritje të të ardhurave të arkëtuara nga taksat dhe tarifave vendore me 9,502 mijë lekë.

-Në planin e taksave dhe tarifave vendore, vihet re për disa lloje taksash dhe tarifash nuk planifikohet saktë niveli i arkëtimit/nuk ndryshon planifikimi, pavarsisht se në vitin e kaluar janë realizuar të ardhura, konkretisht për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tabelës dhe reklamës, psh., në vitin 2020 kjo taksë është planifikuar 357 mijë lekë dhe janë arkëtuar 670 mijë lekë, ndërkohë që përsëri në vitin 2021, kjo taksë është planifikuar në vlerën 359 mijë lekë dhe realizimi është 601 mijë lekë; tarifa e peshkimit; të ardhura nga fondi pyjor me qira; tarifave për linjat ajrore dhe nëntokësore; dhënia me qira e aseteve të bashkisë.

-Veç sa më sipër, nga auditimi i planit të të ardhurave për vitin 2021, konstatohet se DATT, planifikon të arkëtojë detyrime të prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”, të cilat i përkasin periudhës 2011-2020.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat “a” dhe “e” të nenit 5 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e njësisve të vetëqeverisjes vendore”.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. SH.L, Drejtor i DATT.

Debitorët sipas kategorive të tyre.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, si dhe trashëguar nga vitet e mëparshme.

Në fund të vitit 2020 (progresive)	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
		46,367,378	44,197,528	2,169,850
Biznesi i Madh	28	4,622,879	4,091,753	531,126
Biznesi i Vogël	67	3,436,058	3,266,080	169,978
Institucione	1	661,339	661,339	-
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)dhe taksa e tokes	4064	25,946,441	25,946,441	-
Takse pasurie erseke	72	1,439,167	1,439,167	-
Taksa e tokës bujqësore qyteti Erseke,leskovik	332	478,071	478,071	-
Gjopa të Policisë Bashkiake		56,000	56,000	-
Qira trualli h.publik	10	135,640	135,640	-
HEC	1	6,887,989	6,354,618	533,371
Antena	2	2,519,075	1,583,700	935,375
Toka me qira	5	184,719	184,719	-
Krijuar brenda vitit 2021	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
		32,597,924	31,607,639	990,285
Biznesi i Madh	8 ⁹	1,312,532	1,158,112	154,420
Biznesi i Vogël	30 ¹⁰	933,901	828,999	104,902
NIPT Sekondar për punime të kryera	1	130,794	123,120	7,674
Institucione	1	92,800	92,800	-
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	3939	3,873,773	3,873,773	-
Takse pasurie erseke	67	425,779	425,779	-
Taksa e tokës bujqësore	2900	2,906,893	2,906,893	-
Gjopa të Policisë Bashkiake	24	126,500	126,500	-
Qira trualli h.publik	5 ¹¹	39,840	39,840	-
HEC	5 ¹²	1,948,016	1,770,924	177,092
Antena	1 ¹³	402,270	330,000	72,270
Toka me qira	6 ¹⁴	947,494	473,567	473,927
4 HEC-e të identifikuar në auditimin e mëparshëm	4	19,457,332	19,457,332	-
Në fund të vitit 2021 (progresive)	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
		78,965,302	75,805,167	3,160,135
Biznesi i Madh	31	5,935,411	5,249,865	685,546
Biznesi i Vogël	85	4,369,959	4,095,079	274,880
NIPT Sekondar për punime të kryera	1	130,794	123,120	7,674
Institucione	1	754,139	754,139	-
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	3939	29,820,214	29,820,214	-
Takse pasurie erseke	67	1,864,946	1,864,946	-

⁹ Pasqyruar lista e subjekteve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

¹⁰ Pasqyruar lista e subjekteve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

¹¹ Pasqyruar lista e subjekteve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

¹² Pasqyruar lista e subjekteve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

¹³ Pasqyruar lista e subjekteve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

¹⁴ Pasqyruar lista e subjekteve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

Taksa e tokës bujqësore	2900	3,384,964	3,384,964	-
Gjoha të Policisë Bashkiake	24	182,500	182,500	-
Qira trualli h.publik	5	175,480	175,480	-
HEC	5	8,836,005	8,125,542	710,463
Antena	3	2,921,345	1,913,700	1,007,645
Toka me qira	6	1,132,213	658,286	473,927
4 HEC-e të identifikuar në auditimin e mëparshëm	4	19,457,332	19,457,332	-

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezulton se:

-Në krahasim me fundin e vitit 2020, në fund të vitit 2021 kemi rritje të vlerës debitoare me 32,597,924 lekë.

Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Kolonjë në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.

➤ Në mënyrë të përmbledhur vlera e detyrimit tatimor të vlerësuar, për taksa dhe tarifa (gjelbërim, pastrim, ndriçim, ndërtesë, truall, ndikim në infrastrukturë, reklam, tabelë, zënie të hapësirës publike), progresivisht deri më datë 31.12.2021 është në vlerën **46,260,427 lekë**, ndërsa detyrimi tatimor i krijuar brenda vitit 2021 është në vlerën 9,676,472 lekë.

III.1. Kategoria “Biznes” dhe “Institucione”.

Titulli gjetjes: Mangësi në përditësimin e informacionit në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Biznes”, me pasojë efekte financiare.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga DATT Bashkia Kolonjë, regjistrin të taksave dhe tarifave vendore për subjektet që kanë ushtruar aktivitet në vitin 2021 në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, si dhe kryqëzimi i informacionit me databasën e DRT Korçë¹⁵ për subjektet me statusin “aktiv” për vitin 2021, u konstatuan mangësi në informacionin e administruar nga DATT Bashkia Kolonjë. Konkretisht mangësitë u konstatuan mosadministrimin e informacionit për **11** subjekte që kanë ushtruar aktivitet në Bashkinë Kolonjë, si dhe për disa subjekte të cilat janë biznes i madh, në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore administrohen si biznes i vogël¹⁶.

-Sa më sipër konstatohet se për vitin 2021, në 11 raste subjekte të kategorisë “biznes i madh” dhe “biznes i vogël” në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, nuk janë taksuar saktë/aspak, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 329,666 lekë.

-Veç sa më sipër regjistri i taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “biznes” sa i përket taksës së ndërtesës, duke patur në konsideratë përcaktimet e bëra në në VKM nr. 132, datë 7.3.2018¹⁷, e ndryshuar, ka mangësi në gjeneralitetet si, sipërfaqen dhe katet e objektit, nëse ka raste ku objekti është mbi një kat dhe njëri prej kateve shfrytëzohet për banim ndërkohë kati tjetër për veprimtari ekonomike.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. SH.L, Drejtor i DATT, zj. F.N, z. F.Q, z. R.T, z. J.Z inspektor pranë DATT, si dhe zj. B.C, zj. L.K dhe zj. D.G, specialiste të ardhurash.

Kriteri: Pika 7 në nenin 4, nenet 20-25 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Kreu II.1 dhe II.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kolonjë.

Ndikimi/Efekti: Mos përditësimi i regjistrin të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Biznes” ndikon negativisht në fondet që mund të arkëtojnë Bashkia Kolonjë. Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 329,666 lekë.

Shkaku: Mungesa e përditësimit të regjistrin të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Biznes”, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të bashkisë, si dhe mungesa e kryerjes së verifikimeve në terren nga DATT Bashkia Kolonjë.

¹⁵ Vendosur në dispozicion të grupit të auditimit nëpërmjet email-it nga DATT Bashkia Kolonjë.

¹⁶ Pasqyruar lista e subjekteve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

¹⁷ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave të marrë masat e nevojshme, për saktësimin e informacionit për subjektet e mësipërme, në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore, me qëllim taksimin e drejtë dhe të plotë të tyre, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 329,666 lekë.

Titulli gjetjes: Debitorët “Biznes”, “Institucione” dhe “Qiramarrës” të cilët nuk kanë likuaduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.

Situata: Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga DATT, rezulton se në fillim të vitit 2021 kanë qenë debitor 28 subjekte të biznesit të madh në vlerën 4,622,879 lekë, 67 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 3,436,058 lekë dhe 1 institucion në vlerën 661,339 lekë.

-Në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive rezultojnë debitor, 31 subjekte të biznesit të madh në vlerën 5,935,411 lekë, 85 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 4,369,959 lekë, 1 institucion në vlerën 754,139 lekë dhe 1 subjekt (NIPT sekondar) për tarifatat vendore sipas kohëzgjatjes së kantierit në vlerën 130,794 lekë, pra gjithësej **11,190,303 lekë** për **118** subjekte.

-Në fund të vitit 2021 në krahasim me fillimin e vitit 2021, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje. Konkretisht në fillim të vitit 2021 janë debitor 95 subjekte për vlerën 8,058,937 lekë, ndërkohë në fund të vitit 2021, janë 116 subjekte në vlerën 10,305,370 lekë. Konkretisht **gjatë vitit 2021 janë krijuar 38 subjekte debitor** për vlerën **2,246,433 lekë**, nga të cilët **21 subjekte** rezultojnë debitor për herë të parë, ndërkohë që **17 subjekte** të tjerë janë debitor edhe në vitet e mëparshme, veç debisë së krijuar në vitin 2021.

-Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga DATT Bashkia Kolonjë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, konstatohet se nuk janë marrë masa shtrënguese.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. SH.L, Drejtor i DATT.

-Për debitorët (kategoria biznes, të cilën e kemi përmendur në tabelën makro) të krijuar brenda vitit 2021 nuk është përllogaritur rast pas rasti kamatvonesë.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. SH.L, Drejtor i DATT, si dhe zj. B.C, zj. L.K dhe zj. D.G, specialiste të ardhurash.

“Subjektet qiramarrës”.

-Nga auditimi i marrëdhënieve kontraktore të Bashkisë Kolonjë me palët e treta, për dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, konkretisht të respektimit të detyrimit kontraktor për pagesën e qirasë (për vitin 2021), përllogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se:

Përgjatë vitit 2021, rezultojnë debitor ndaj Bashkisë Kolonjë, subjektet, si më poshtë vijon:

-6 “K” në vlerën 27,500 lekë (25,000 lekë principal + 2,500 lekë kamatvonesë) për periudhën e qirasë nga data 29.05.2021 deri më datë 30.05.2022.

-D në vlerën 14,400 lekë (14,400 lekë principal + 1,440 lekë kamatvonesë) për periudhën e qirasë nga data 20.03.2021 deri më datë 20.03.2022.

-G.N në vlerën 508,460 lekë (89,220 lekë principal + 419,240 lekë kamatvonesë) për periudhën e qirasë nga data 28.03.2020 deri më datë 27.03.2021, si dhe periudhën nga data 28.03.2021 deri më datë 28.03.2022.

-F.S në vlerën 170,109 lekë (140,109 lekë principal + 30,263 lekë kamatvonesë) për periudhën e qirasë nga data 30.05.2021 deri më datë 30.05.2022.

-V në vlerën 402,270 lekë (330,000 lekë principal + 72,270 lekë kamatvonesë) për periudhën e qirasë nga data 12.11.2020 deri më datë 12.11.2021.

-E.P në vlerën 1,445,428 lekë (1,314,025 lekë principal + 131,403 lekë kamatvonesë).

-E.T në vlerën 165,705 lekë (150,641 lekë principal + 15,064 lekë kamatëvonesë), si dhe 8,291,832 lekë, evidentuar në auditimin e mëparshëm, gjithësej 8,457,537 lekë.

-Ç në vlerën 336,884 lekë (306,258 lekë principal + 30,626 lekë kamatëvonesë), si dhe 10,096,720 lekë, evidentuar në auditimin e mëparshëm, gjithësej 10,433,604 lekë.

-Q & K në vlerën 936,780 lekë, evidentuar në auditimin e mëparshëm.

-B.G.E në vlerën 132,000 lekë, evidentuar në auditimin e mëparshëm.

Disa prej subjekteve të mësipërme (si G.N, F.S, V, E.P, E.T, Ç dhe Q&K) kanë marrë me qira sipërfaqe pasurie të paluajtshme në fond pyjor/kullosor, detyrimi i të cilëve, bazuar në përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 13 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”, mbledhet nga drejtoria e shërbimit pyjor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e këtyre subjekteve, konstatohet se nuk janë njoftuar subjektet për zgjidhje të njëanshme të kontratës së qirasë, si dhe nuk është hapur proces gjyqësor, me qëllim mbledhjen e detyrimeve me forcë nëpërmjet shërbimit të përmbarrimit.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi z. A.J, Drejtor i Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, pranë Bashkisë Kolonjë, si dhe për subjektet e tjera që kanë marrë me qira tokë bujqësore, mbanë përgjegjësi, z. SH.L, Drejtor i DATT.

Kriteri: Neni 76, neni 114 dhe neni 117 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Neni 64 në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;

-Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Pikën 4 të nenit 13 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”.

-Neni 63 në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Bashkisë Kolonjë.

Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 44,070,569 lekë, nga të cilat 25,225,139 lekë janë krijuar brenda vitit 2021.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore 44,070,569 lekë (principal dhe kamatë vonesë).

Për realizimin e të ardhurave nga tarifatat vendore, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Kolonjë.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Kolonjë mbi arkëtimin e tarifës së pastrimit, ndriçimit dhe turizmit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike/private në Bashkinë Kolonjë, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Paketa fiskale e vitit 2021;

-Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2021 - 31.12.2021;

-Leje ndërtimi, njoftim i fillimit dhe përfundimit të punimeve;

-Faturimi i detyrimit dhe pagesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1.Përshkrimi i situatës.

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura, u auditua dokumentacioni për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Kolonjë) ku rezultoi se përgjatë vitit 2021 (përfshirë edhe subjekte të cilat kanë nisur punimet në vitin 2020, por kanë përfunduar në vitin 2021) nuk janë taksuar 6 subjekte që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Kolonjë, si dhe 1 subjekt që nuk ka kryer likuidimin e tarifës së kantierit faturuar nga DATT Bashkia

Kolonjë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 396,321 lekë, pasqyruar si më poshtë vijon:

Nr	Objekti i Prokurimit/Leja e Ndërtimit	Vendndodhja	Kohëzgjatja e punimeve		Tarifa e pastrimit, ndricimit, gjelbërimit, (kohëzgjatja e kantierit) dhe turizmit (Lekë)	Pagesa	Debitor
			Filluar	Mbaruar			
1	Ndërtim	Fshatrat Reth Qyteti	01.01.21	31.12.2022	123,120 + 7,674 kamatvonesë		130,794
2	Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit	Fshatrat Reth Qyteti	07.12.2020	04.10.2021	94,166	nuk është përlogaritur	94,166
3	Ndriçim LED	Qytet Ersekë	25.11.2021	25.12.2021	9,416	nuk është përlogaritur	9,416
4	Këndi i lodrave për fëmijët	Qytet Ersekë	25.11.2021	31.12.2021	10,985	nuk është përlogaritur	10,985
5	Godinë për akomodim agroturizëm	Vrepcke	15.10.2020	Proces	96,750	nuk është përlogaritur	96,750
6	Rrugë lidhese per stacionin e telefonise celulare, rehabilitimi i asaj ekzistuese si dhe ndërtim i linjës elektrike ajrore	Germenj	23.10.2020	14.02.2021	28,410	nuk është përlogaritur	28,410
7	Objekt Industrial me Struktura Metalike	Qytet Ersekë	07.10.2021	31.12.2021	25,800	nuk është përlogaritur	25,800
Total							396,321

Burimi: DATT dhe Drejtoria e Urbanistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhimi i tarifës së pastrimit dhe shërbimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Kolonjë.

Situata: Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, u auditua dokumentacioni për subjektet e ndërtimit, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Kolonjë) të cilat kanë kryer punime ndërtimi.

-Në auditimin e kryer për ndjekjen e procedurave në krijimin e të ardhurave nga tarifat vendore për pastrimin dhe ndriçimin ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi, u konstatua se nga DATT, Bashkia Kolonjë, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e bashkisë. Nga përlogaritjet e kryera rezultoi se për vitin 2021 në 6 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit në vlerën 265,527 lekë gjithësej, si dhe 130,794 lekë 1 subjekt që nuk ka kryer likuidimin e tarifës së kantierit, gjithësej 396,321 lekë vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kolonjë.

-Situata e mësipërme është krijuar si rrjedhojë e mosraportimit pranë DATT Bashkia Kolonjë, të lejeve të infrastrukturës dhe dokumentacionin mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit, nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, por edhe nga puna e pamjaftueshme e DATT Bashkia Kolonjë, në verifikimin në terren të subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Kolonjë.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z.M.T, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. SH.L, Drejtor i DATT, zj. F.N, z. F.Q, z. R.T dhe z. J.Z inspektor pranë DATT.

Kriteri: Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;

Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Kreu II.1 dhe II.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kolonjë.

Ndikimi/Efekt: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 396,321 lekë.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të Bashkisë Kolonjë, si dhe puna e pamjaftueshme e verifikimit në terren.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave të marrë masa, për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 396,321 lekë.

Debitor nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake Kolonjë, është në vlerën 182,500 lekë, nga të cilat në vitin 2021 janë 24 gjoba në vlerën 126,500 lekë.

Gjobat e Policisë Bashkiake Kolonjë

Debitor deri në 2021	Subjekte	Vlerë
Gjithësej	25	182,500
Nga të cilat në 2021	24	126,500
Nga të cilat deri në 2020	1	56,000

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i Gjetjes: Procedurat e ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake Kolonjë.

Situata: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2021 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 182,500 lekë, nga të cilat në vitin 2021 janë krijuar 24 gjoba në vlerën 126,500 lekë;

Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse¹⁸.

Kriteri: Neni 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar.

Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në vlerën 182,500 lekë.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës dhe mosndjekja plotësisht e procesit të arkëtimin të gjobave të vendosura.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me sektorin e policisë bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 182,500 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

III.2.Familjet.

Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”.

Situata: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, për vitin 2021 janë taksuar 5922 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohet si më poshtë:

Nr	Njësi Administrative	Familje të taksuara 2021
1	Ersekë	1537
2	Qender Erseke	1453
3	Mollas	1078
4	Çlirim	488
5	Barmash	347
6	Navosel	369
7	Leskovik	550
8	Qender Leskovik	100
	TOTAL	5922

¹⁸ Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, “Për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmuor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative"; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

-Me qëllim vlerësimin nëse nga DATT Bashkia Kolonjë është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga DATT Bashkia Kolonjë me informacionin e administruar nga Zyra e Gjendjes Civile.

-Sipas gjendjes civile në Bashkinë Kolonjë dhe NJA janë 6507 familje ndërkohë në vitin 2021 janë taksuar 5922 familje.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Kolonjë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përllogaritjet vetëm për tarifën e pastrimit, ndriçimit, dhe turizmit (duke aplikuar tarifën më të ulët në vlerë dhe mesatarizuar tarifën), për numrin e familjeve të patakuara, do të kishim $900 \text{ lekë} * 585 \text{ familje}$ mesatarisht taksuar më pak = 526,500 lekë planifikuar më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se DATT Bashkia Kolonjë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 7.3.2018¹⁹, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. SH.L, Drejtor i DATT, si dhe zj. B.C, zj. L.K dhe zj. D.G, specialiste të ardhurash.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezultoi se për arkëtimin e taksave të familjeve Bashkia Kolonjë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A Ersekë, i cili vepron si agjent tatimor për llogaritjen e Bashkisë Kolonjë. Grupi i auditimit bëri kërkesë për numrin e familjeve, të cilat janë të pajisura me matës (pra kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë) ku rezultoi se 1861 familje nuk kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë, ç’ka do të thotë se taksat dhe tarifën vendore për këtë numër familjesh arkëtohen vetëm kur familjet marrin shërbime të ndryshme, si vërtetime etj, të paguajnë taksat dhe tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Kriteri: Pika 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Kreu II.1 dhe II.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kolonjë.

Neni 62 dhe 63 në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Kolonjë.

Ndikimi/Efekti: Mos evidentimi i saktë i numrit të familjeve për efekt taksimi të tyre ndikon negativisht në fondet që mund të arkëtojnë Bashkia Kolonjë nga kategoria “Familjar”.

Shkaku: Mungesa e përditësimit të regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë familjar, si dhe mungesa e kryerjes së verifikimeve në terren nga DATT Bashkia Kolonjë.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të marrë masat e nevojshme, për arkëtimin e taksave për 1861 familje, të cilat nuk kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe për rrjedhojë nga agjenti tatimor Ujësjellës-Kanalizime Sh.A Ersekë, nuk mundësohet arkëtimi i tyre.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të patakuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2021, rezultojnë 526,500 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë.

¹⁹ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksës së tokës bujqësore.

Situata: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithësej tokë bujqësore sipas DATT Bashkia Kolonjë janë 11215.5 Ha, nga të cilat 6709 Ha sipërfaqe shërben si bazë për planifikimin e arkëtimeve nga kjo taksë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore në Bashkinë Kolonjë

Nr	NJA	Tokë Bujqësorë Gjithsej	Sipërfaqja e tokës, ndarë me AMTP	Sipërfaqja e tokës së pandarë
1	Qender Ersekë	3811.7 ha	2679	1132
2	Mollas	3099.8 ha	1837	1262
3	Barmash	751 ha	453	298
4	Novosele	826 ha	627	199
5	Clirim	1310 ha	714	596
6	Erseke	129 ha	78	51
7	Leskovik	483 ha	321	162
8	Qender Leskovik	805 ha	506	299
	Total	11215.5	7215	3999

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konkretisht planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga DATT Bashkia Kolonjë, pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kolonjë

Kategoria e tokës	Sip/HA Qendër	Sip/HA Mollas	Sip/HA Barmash	Sip/HA Novosele	Sip/HA Clirim	Sip/HA Erseke	Sip/HA Leskovik
Kategoria II							
Kategoria III							
Kategoria IV							
Kategoria V							
Kategoria VI							
Kategoria VII	2679	1837	453	627	714	78	321
Kategoria VIII							
e. Totali sip. ha sipas planifikimit	6709						

NJA	Maturim 2021
Qender Erseke	1,635,110
Mollas	1,262,206
Barmash	313,275
Novosele	406,980
Clirim	485,709
Erseke	52,015
Leskovik	228,411
Qender Leskovik	200,000
Total	4,583,706

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër, duke patur në konsideratë sipërfaqen, kategorinë dhe vlerën për Ha të tokës bujqësore për çdo NJA konstatohet se, planifikimi i taksës së tokës bujqësore për vitin 2021 është bërë për 466,794 lekë më pak. Pra për 7215 Ha tokë bujqësore e ndarë me AMTP, planifikimi i taksës së tokës bujqësore duhet të ishte 5,050,500 lekë ose nga 4,583,706 lekë. Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. SH.L, Drejtor i DATT.

Kriteri: Pika 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Ndikimi/Efekti: Mos evidentimi i saktë i sipërfaqes së tokës bujqësore, çon në mos planifikimin e saktë të kësaj dhe mosadministrim me efektivitet dhe eficiencë të fondeve në vlerën 466,794 lekë, që ndikojnë negativisht në të ardhurat që mund të arkëtohen nga taksa e tokës bujqësore.

Shkak: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mbrotjes së Konsumatorit, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 466,794 lekë.

Titulli i gjetjes: Debitorët “Familjar” të cilët nuk kanë likujtuar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Kolonjë.

Situata: Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e ndriçimit, pastrimit, taksën e ndërtesës, truallit, si dhe taksën e tokës bujqësore.

Nr	Debitorët "Familje"	Progresive deri në 2020		Krijuar 2021		Progresive 31.12.2021	
		Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
1	Qendër Erseke	751	9,116,536	661	1,545,422	661	10,661,958
2	Nj.Mollas	846	7,407,772	438	2,041,781	438	9,449,553
3	Ersekë	1182	2,725,600	1013	1,280,482	1360	4,006,082
4	Leskovik	305	1,511,813	87	566,848	282	2,078,661
5	Nj.Lesovik	79	249,810	39	541,959	81	791,769
6	Çlirim	430	3,464,309	391	149,654	391	3,613,963
7	Novosele	277	1,346,304	263	311,928	263	1,658,232
8	Barmash	194	602,368	177	202,619	177	804,987
	TOTAL	4396	26,424,512	3069	6,640,693	3653	33,065,205

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2020 në mënyrë progresive janë 4396 familje debitorë për vlerën 26,424,512 lekë dhe në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive janë 3653 familje debitorë për vlerën 33,065,205 lekë, nga të cilat, në vitin 2021 është krijuar 6,640,693 lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2020, në fund të vitit 2021 kemi rritje të vlerës debitorë për taksat dhe tarifatat për kategorinë “familje”, ç’ka tregon për performancë të dobët të Bashkisë Kolonjë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

-Sa i përket familjeve debitorë, rezulton se nuk janë marrë masa ligjore (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitorë.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. SH.L, Drejtor i DATT.

Kriteri: Pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4, nenet 20-24 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 33,065,205 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 33,065,205 lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Përdorimi i të ardhurave.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2021 është realizuar përkatësisht në vlerën 73,122 mijë lekë, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për shpenzime për mallra dhe shërbime, si dhe për paga.

Përdorimi i të ardhurave – viti 2021

	Përshkrimi Shpenzimeve	Nga të ardhurat e veta
1	Paga	21,878,971
2	Shp.Operat	34,679,307

3	Transferata per familje dhe individe	120,000
4	Investime 230-231	12,834,424
5	Garanci Punimesh	3,609,338
	Totali	73,122,040

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar në krye të herës, detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të Bashkisë Kolonjë, llojin e mangësive të identifikuara si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi:

- z. SH.L, Drejtor i DATT;
- zj. F.N, inspektor pranë DATT;
- z. F.Q, inspektor pranë DATT;
- z. R.T, inspektor pranë DATT;
- z. J.Z inspektor pranë DATT;
- zj. B.C, specialist i të ardhurave pranë DATT;
- zj. L.K specialist i të ardhurave pranë DATT;
- zj. D.G, specialist i të ardhurave pranë DATT;
- z. M.T, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
- z. A.J, Drejtor i Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.

III.2.3. Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2021, konkretisht:

Pasqyrat Financiare të vitit 2021.

- Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2021 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:
 - Pasqyrat financiare të vitit 2021;
 - Ditari i Bankës;
 - Ditari i Arkës;
 - Ditari i Magazinës;
 - Ditari i Pagesave;
 - Ditari i Veprimeve të ndryshme;
 - Aktrakordimet me Degën e Thesarit Kolonjë;
 - Situacionet dhe akt-marrjet në dorëzim të investimeve të kryera;
 - Inventarët etj.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm dhe i mbështetur në testet e kontrollit dhe testet thelbësore të transaksioneve për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.

▪ Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2021 janë:

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
- Gjithashtu është dhënë informacion mbi:

Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Kolonjë me NIPT K.....G;

Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2021-31.12.2021;

- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Përgatitur nga zj. G.D;
- Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Kolonjë me shkresën nr.2434 prot., datë 16.05.2021, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Kolonjë z. E.I.

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Kolonjë të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Kolonjë, si dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Kolonjë²⁰.

Nga auditimi i disa prej llogarive të pasqyrave financiare u konstatua se:

Titulli i gjetjes: Mosrespektimi i afatit të raportimit të pasqyrave financiare të vitit 2021.

Situata: Pasqyrat financiare të Bashkisë Kolonjë për vitin 2021 janë përcjellë në Degën e Thesarit Kolonjë më datë 16.05.2022, pra jashtë afatit ligjor (brenda muajit Mars të vitit 2022).

Kriteri: Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 118.

Ndikimi/Efekt: Ndikim negativ në vendimmarrjen e nivelit drejtues të Bashkisë Kolonjë për kryerjen e përmirësimeve në veprimet kontabël gjatë vitit ushtrimor 2022.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme për raportimin e pasqyrave financiare, brenda afatit të përcaktuar.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Situata: Llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2021 pasqyrohet në vlerën 58,542,301 lekë. Lëvizjet debitore dhe kreditore të kësaj llogarie përgjatë periudhës 2020-2021 pasqyrohen si më poshtë:

Levizja e llogarisë 468 Sintetike				Viti 2021		
Viti	Bashkia Kolonjë dhe NJA	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2020	Debi	Kredi	Mbetja
2021		Debitorë të ndryshëm	50,000,812	13,969,105	5,427,616	58,542,301

Ndërkohë sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit, bazuar në të dhënat e vendosura (regjistrat e taksave dhe tarifave vendore, tabelat për subjektet me aktivitet HEC, antenna telefonie, etj) nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Kolonjë, lëvizjet debitore dhe kreditore të llogarive përkatëse, rezultoi se vlera e llogarisë nr.468 në fund të vitit 2021 është kontabilizuar më pak për vlerën **20,423,001 lekë**, pasqyruar analiza si më poshtë vijon:

²⁰ Pasqyruar trajtimi i pasqyrave financiare në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.4” të projektraportit të auditimit.

Në fund të vitit 2020 (progresive)	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
	46,367,378	44,197,528	2,169,850
Biznesi i Madh	4,622,879	4,091,753	531,126
Biznesi i Vogël	3,436,058	3,266,080	169,978
Institucione	661,339	661,339	-
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)dhe taksa e tokes	25,946,441	25,946,441	-
Takse pasurie erseke	1,439,167	1,439,167	-
Taksa e tokës bujqësore qyteti Erseke,leskovik	478,071	478,071	-
Gjoha të Policisë Bashkiake	56,000	56,000	-
Qira trualli h.publik	135,640	135,640	-
HEC	6,887,989	6,354,618	533,371
Antena	2,519,075	1,583,700	935,375
Toka me qira	184,719	184,719	-
Krijuar brenda vitit 2021	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
	32,597,924	31,607,639	990,285
Biznesi i Madh	1,312,532	1,158,112	154,420
Biznesi i Vogël	933,901	828,999	104,902
NIPT Sekondar për punime të kryera	130,794	123,120	7,674
Institucione	92,800	92,800	-
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	3,873,773	3,873,773	-
Takse pasurie erseke	425,779	425,779	-
Taksa e tokës bujqësore	2,906,893	2,906,893	-
Gjoha të Policisë Bashkiake	126,500	126,500	-
Qira trualli h.publik	39,840	39,840	-
HEC	1,948,016	1,770,924	177,092
Antena	402,270	330,000	72,270
Toka me qira	947,494	473,567	473,927
4 HEC-e të identifikuar në auditimin e mëparshëm	19,457,332	19,457,332	-
Në fund të vitit 2021 (progresive)	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
	78,965,302	75,805,167	3,160,135
Biznesi i Madh	5,935,411	5,249,865	685,546
Biznesi i Vogël	4,369,959	4,095,079	274,880
NIPT Sekondar për punime të kryera	130,794	123,120	7,674
Institucione	754,139	754,139	-
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	29,820,214	29,820,214	-
Takse pasurie erseke	1,864,946	1,864,946	-
Taksa e tokës bujqësore	3,384,964	3,384,964	-
Gjoha të Policisë Bashkiake	182,500	182,500	-
Qira trualli h.publik	175,480	175,480	-
HEC	8,836,005	8,125,542	710,463
Antena	2,921,345	1,913,700	1,007,645
Toka me qira	1,132,213	658,286	473,927
4 HEC-e të identifikuar në auditimin e mëparshëm	19,457,332	19,457,332	-

Burimi: Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Situata e mësipërme ka ardhur si rrjedhojë e mosraportimit të plotë dhe të saktë të vlerës debitorë nga Drejtoria e të Ardhurave për Drejtorinë e Financës, mospërlllogaritjes së kamat-vonesave.

-Gjithashtu konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërpasiv llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Pra pasqyrat financiare të Bashkisë Kolonjë për vitin 2021 nuk janë sipas formatit të përcaktuar pikën 10 të Udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, z.Sh. L., Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave dhe G. D., Nëpunës Zbatues, hartues i pasqyrave financiare.

Kriteri: Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12;

Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c” dhe pika 10.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të përbërjes së debitorëve të Bashkisë Kolonjë në fund të vitit 2021. Pasqyrat financiare nuk janë sipas formatit të miratuar dhe për rrjedhojë nuk japin informacion të plotë dhe të saktë.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimi e Llogarisë nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, vlera kontabël paraqitet në shumën 0 lekë.

Situata: Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Ujësjellës Kanalizime Kolonjë Sh.A” me NIPT K...O, u konstatua se Bashkia Kolonjë zotëron 100% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 1 aksion me vlerë nominale 183.473.532 lekë, në total 183,473,532 lekë.

-Gjithashtu Bashkia Kolonjë është aksionare edhe në shoqërinë “K” Sh.A me objekt aktiviteti “Mbledhja, transporti, administrimi, depozitimi i mbetjeve bashkikake dhe komunale, industriale, mbetjeve të spitaleve, ndertimeve, sistemit të ujrave të zeza, kanalizimit, rezervuareve, mbetjeve bujqesore, mbetjeve voluminaoze bashkiake dhe komunale”. Në këtë shoqëri Bashkia Kolonjë zotëron 12 aksione me vlerë nominale 16.550 lekë, ose 198,600 lekë gjithësej.

-Pra sa më sipër llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar me **183,672,132 lekë**.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, zj.G.D, Drejtor i Financës.

Kriteri: Urdhri i Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

VKM nr.660, datë 12.9.2007 “për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve Njësive të Qeverisjes Vendore”.

VKM nr.63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”.

Situata: Llogaria nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Kolonjë, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 40,777,530 lekë. Llogaria nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Lëvizja e kësaj llogarie përgjatë vitit 2021 pasqyrohet si më poshtë:

Llogaria 466 levizjet dhe gjendja në fund të vitit 2021				
Emertimi	Celja 01.01.2022	Kreditim	Debitim	Mbetja 31.12.2021
Kreditorë për mjete nën ruajtje	21,697,079	22,689,789	3,609,338	40,777,530

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar, paraqiten si më poshtë:

Nr	Objekti	Subjekti	Vlera
1	Kanali Ujites Kabash-Leskovik	K.K	362,192
2	Gjimnazi P.N.Luarasi Erseke	A	1,125,304
3	Kanali Ujites Kabash-Leskovik	K.K	137,807
	Total		1,625,303

-Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 1,625,303 lekë për vitin 2021.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, zj.G.D, Drejtor i Financës.

Kriteri: Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.

Ndikimi/Efekt: Llogaria nr. 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorin e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

Situata: Llogaria nr.215 “Mjete transporti” paraqet vlerën neto të mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Kolonjë më datë 31.12.2021 në shumën 23,632,377 lekë.

-Nga shqyrtimi llogarisë analitike të mjeteve të transportit, rezulton se kemi klasifikim të gabuar të disa makinerive në këtë llogari, si 1 ekskavator, 1 fadromë, 1 rul, 2 rimorkiator dhe 1 makineri për vlerën 9,33,364 lekë të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë 214, si dhe për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%).

Nr	Emërtimi	Vlera neto
1	Fadrome	1,271,071
2	Eskavator	6,695,785
3	Rul	912,000
4	Rimorkiator	40,000
5	Rimorkio Bot	26,508
7	Makineri	398,000
	Total	9,343,364

-Gjithashtu konstatohet se në llogarinë nr.215 nuk është bërë shtesë vlera prej 425,000 lekë, për riparimin e makinës teknologjike modeli “Renault”.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, zj.G.D, Drejtor i Financës.

Kriteri: Nomenclatura e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 2140240-Paisje dhe makineri për konstruksione (ndertime); 2140260-Paisje pastrimi për rrugët; 2140320-Mjete dhe paisje të tjera teknike; Shkronja “b”, pika 2, Klasa 2 “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtim kontabël) në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Ndikimi/Efekt: Llogaria nr. 215 “Mjete transporti”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarive nr.213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore”.

Situata:Gjendja e llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore” në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën kontabël neto 1,052,133,276 lekë. Nga analiza e llogarisë analitike, konstatohet se janë kontabilizuar si AQT, objektet “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” për vlerën 99,965,404 lekë dhe “Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave nga burimet e Kozelit”, për vlerën 94,619,989 lekë, të cilat në datë 31.12.2021 janë në statusin “investime në proces”, pasi akoma nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Kolonjë. Pasqyruar statusi i tyre në tabelën më poshtë:

Nr.	Objekti	Marrë në dorëzim
1	Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut.	25.04.2022
2	Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave nga burimet e Kozelit.	27.01.2022

Burimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sa më sipër rezulton se llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore” është mbivlerësuar për vlerën **194,585,393 lekë**, vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë nr. 231 “Investime në proces”.

-Gjithashtu konstatohet se në llogarinë nr.213, nuk është kapitalizuar edhe vlera e mbetur e investimit me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit”, për shumën 19,950,000 lekë, e cila qëndron e kontabilizuar në llogarinë nr.231, si investim në proces, ndërkohë që ky objekt është marrë në dorëzim për vlerën e plotë të tij më datë 13.10.2021.

-Veç sa më sipër konstatohet se në llogarinë nr.213 nuk është bërë shtesë vlera prej 925,000 lekë, investim për riparimin e sifonit në kanal in ujitës të fshatit Borovë.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, zj.G.D, Drejtor i Financës.

Kriteri: Shkronja “b”, pika 2, Klasa 2 “Aktivet afatgjata”²¹ (përbërja dhe trajtim kontabël) në Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.213, duke kryer veprimet e nevojshme në debi/kredi të llogarisë nr.231 dhe llogarisë 101 “Fondet bazë”.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarive nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”.

Situata:Gjendja e llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione” në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën kontabël neto 567,893,713 lekë. Nga analiza e llogarisë analitike, konstatohet se nuk është bërë shtesë vlera prej 660,000 lekë, investim për riparimin e taracave në shkollat 9-vjeçare Barmash dhe Qinam.

-Gjithashtu konstatohet se në llogarinë nr.212, nuk është kapitalizuar edhe vlera e mbetur e investimit me objekt “Rikonstruksion banese sociale në Leskovik”, për shumën 7,827,049 lekë, e cila qëndron e kontabilizuar në llogarinë nr.231, si investim në proces, ndërkohë që ky objekt është marrë në dorëzim për vlerën e plotë të tij më datë 14.04.2021, si dhe vlera prej 2,439,264 lekë, për blerjen e materialeve të ndërtimit për rikonstruksionin e qendrës multifunkionale të qytetit Ersekë.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, zj.G.D, Drejtor i Financës.

²¹ Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivët afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

Kriteri: Klasa 2 “Aktivet afatgjata”²² në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale” – matja fillestare.

Ndikimi/Efekt: Llogaritë nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkak: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.212, duke kryer veprimet e nevojshme në debi/kredi të llogarisë nr.231 dhe llogarisë 101 “Fondet bazë”.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 231 “Investime në proces”.

Situata: Llogaria nr.231 “Investime në proces”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën kontabël 633,882,463 lekë. Nga auditimi i ditarit të bankës, njoftimit të fillimeve dhe përfundimit të punimeve, faturave të mbërritura për investime dhe të palikujduara në fund të vitit 2021, konstatohet se llogaria 231 është mbivlerësuar për shumën 70,993,843 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit të gabuar të:

10,266,313 lekë (investime në ndërtesa), vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë nr.212;

19,950,000 lekë (investime në ujësjellës), vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë nr.213;

40,777,530 lekë (garanci punimesh), vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë nr.520, pasi janë disponibilitete në thesar.

-Gjithashtu konstatohet se llogaria nr.231 është nënvlerësuar për shumën 252,499,750 lekë, vlera e mbetur e investimit për ndërtimin e ujësjellësit të qytetit të Ersekës dhe të disa fshatrave nga burimet e Kozelit. Në fund të vitit 2021, subjekti që ka kryer punimet e ndërtimit ka situacionuar të gjithë vlerën e punimeve, pra duke përfunduar punimet në terren, ndërkohë që nga vlera e plotë e investimit, deri në 31.12.2021, është likujduar vlera prej 244,599,988 lekë. Pra në kushtet e mësipërme, vlera e mbetur debitohet në llogarinë nr.231, duke kredituar llogarinë nr.404 dhe debituar llogarinë nr.4342, pasi këto fonde priten të alokohen nga buxheti i shtetit dhe jo i Bashkisë Kolonjë.

Për konstatimin e shpenzimeve për blerjen apo krijimin e aktivitet:

Debitohet 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në analizë shtatëshifrore;

Kreditohet 404 “Furnitorë për investime”.

Në momentin e alokimit të fondeve përkatëse, likujdimin e faturës dhe marrjen në dorëzim të investimit, kryhen veprimet duke bërë lëvizjet në llogarinë 404, llogarinë 231, llogarinë 213, llogarinë 4342, llogarinë 466 dhe 520.

Si duhet të kontabilizohej llogaria nr.231

Nr	Objekti	Debi	Kredi	Kredi	Debi
		Llogaria 231	Llogaria 212	Llogaria 213	Llogaria 520
1	Rik.banese sociale leskovik		7,827,049		
2	Rrjeti I shperndarjes te furnizimit me uje 14 fshatra	74,146,131			
3	Rik.Kanali I Gjoncit			19,950,000	
4	Ujesjellesi Leskovik	99,965,404			
5	Ndertimi I ujesjellesit erseke	94,619,989			
6	Rik.Rrjeti I Brendshem dhe I jashtem leskovik	142,500,000			
7	Ndertimi I ujesjellesit erseke	137,750,000			
8	Rikualifikim Pali Prifti	9,879,096			
9	Rikualifikim Pali Prifti	2,850,000			
10	Rikualifikim Pali Prifti	190,000			

²² Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

11	Rikualifikim Pali Prifti	988,000			
12	Blerje materiale qendra multifunkionale		39,264		
13	Blerje materiale qendra multifunkionale		500,000		
14	Blerje materiale qendra multifunkionale		400,000		
15	Blerje materiale qendra multifunkionale		1,500,000		
16	Garanci 5%				40,777,530
17	Ndertimi I ujesjellesit erseke	252,499,750			

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, zj.G.D, Drejtor i Financës.

Kriteri: Klasa 2 “Aktivet afatgjata”²³ në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Ndikimi/Efekt: Llogaria nr. 231 “Investime në proces”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitet afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

Titulli i gjetjes: Mbi inventarizimin, kontabilizimin si AQT dhe regjistrimin në kadastër të aseteve në pronësi të Bashkisë Kolonjë.

Situata: Si çdo institucion publik, edhe Bashkia Kolonjë, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Kolonjë i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkëmbimi i ish komunave, aktualisht NJA të Bashkisë Kolonjë, ish Bashkisë Leskovik, aktualisht NJA Leskovik në Bashkinë Kolonjë. Me qëllim pasqyrimit real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Kolonjë duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitet, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitet, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit, bëhet regjistrimi i tyre në regjistrat publik të pronës dhe në kontabilitet, duke vijuar me përditësimin periodik të tyre, sa herë që ka ndryshime në statusin juridik/fizik/monetar të saj. Për kryerjen e detyrave të mësipërme Bashkia Kolonjë ka detyrimin që të krijoj ose të ngarkoj një strukturë të posaçme, e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj vetëm inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri.

Të gjitha sa më sipër përcaktohen në kuadrin rregullator, si: Ligji nr. 20/2020 datë 5.3.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; Ligji nr.111/2018 “Për Kadastrën”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala për zbatimin e tyre.

-Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Kolonjë. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të

²³ Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivitet afatgjatë, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

Bashkisë Kolonjë, konkretisht në nenet 44 dhe 59, përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, përkatësisht:

-Në nenin 44 detyrat e “Specialistit jurist” përcaktohet se për pronat e bashkisë merr në evidencë pronat e paluajtshme të Bashkisë dhe ndjek ndryshimet e saj në vazhdimësi; Ndjek zhvillimet dhe procedurat ligjore që kanë lidhje me keto prona – Ky pozicion përgjatë vitit 2021 ka qenë vakant, si dhe nga komunikimi me zyrën e protokollit, nga Kryetari i Bashkisë Kolonjë, nuk është nxjerrë urdhër i brendshëm për caktimin e një punonjësi tjetër për kryerjen e funksioneve të mësipërme.

-Në nenin 59 detyrat e “Specialistit të Kontabilitetit”, përcaktohet se: “Mban librin e aktiveve afatgjata të bashkisë, kontrollon llogaritjen e amortizimit. Zbaton kërkesat ligjore për lëvizjen, inventarizimin dhe nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve” – Nga verifikimi i regjistrave të aseteve, nuk rezulton të jetë kryer plotësisht detyra e mësipërme.

Për ta ilustruar situatën e mësipërme dhe nëse është zbatuar plotësisht kuadri rregullator, kemi analizuar pasqyrimin e llogarive kontabël, përkatësisht llogarinë nr.210 “Toka, Troje, Terrene”, e cila në fund të vitit 2020, paraqitet në vlerën 3,330,850 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2021, llogarisë nr.211 “Pyje, plantacione”, e cila paraqitet në vlerën 25,909,872 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2021 dhe të llogarisë nr.212 “Ndërtesa e konstruksione”.

-Duke vijuar, Bashkia Kolonjë administron inventar të pronave, tokave dhe pasurive natyrore që shtrihen në territorin administrativ të saj, të cilat janë në pronësi/përdorim nga Bashkia Kolonjë dhe strukturat në varësi të saj. Ky inventar përbëhet nga 4394 prona të llojeve të ndryshme, si troje, ndërtesa, terrene sportive, pyje, kullota, toka bujqësore, lulishte, trotuar, vepra të ujitjes, ujësjellës-kanalizimeve etj. Informacioni në këtë regjistër është përditësuar rreth 6-7 vite përpara, që kur NJA Leskovik ka qenë në nivel bashkie, pra nuk është përditësuar me informacion mbi ndryshimet e mëpasshme në statusin juridik/fizik/monetar të pasurive të mësipërme.

-Nga 4394 pasuri, sipas inventarit rreth 3527 prej tyre, janë në pronësi të Bashkisë Kolonjë.

-Nga 3527 pasuri në pronësi të Bashkisë Kolonjë, rreth 28/1% prej tyre janë regjistruar në kadastrë dhe janë pajisur me certifikatë pronësie, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Vendndodhja	Nr., i pronave të B.Kolonjë	Nr., i pronave të regjistruara
Ersek qytet	383	19
Ersek fshatra	263	
Leskovik qytet	351	5
Leskovik fshatra	937	
Novoselë	345	0
Barmash	321	0
Mollas	285	3
Çlirim	642	1
Total	3527	28

Gjithashtu nga analiza e llogarisë nr.210, konstatohet se:

1. Nuk është kryer inventarizimi i tyre;
2. Objektet e kontabilizuara nuk pasqyrohen me emërtimet e tyre, por vetëm me mbishkrimin “Toka, troje dhe terrene”, pra nuk identifikohet përbërja e kësaj llogarie dhe saktësia e veprimeve kontabël;
3. Rregjistri që mbahet nga Drejtoria e Financës për këtë llogari, nuk është i plotë me informacion, pasi mungon informacioni për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës etj.
4. Nuk është kryer kontabilizimi i trojeve të lira dhe ato të zëna me ndërtesat, që sipas rastit i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Kolonjë, nëpërmjet akteve ligjore/nënllogjore, si dhe për më tepër ato troje të cilat janë pajisur edhe me certifikatë pronësie, pasqyruar si më poshtë:

Nr	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji i pronës	Adresa	Truall (m2)	Ndërtesë (m2)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Shënime	Administruar në inventarin e pronave	Lekë/m ² truall ²⁴	Vlera
1	2691	321/1	Truall	Milec - Mollas	5000	0	Për ndërtimin e stacionit të transferimit të mbetjeve të ngurta dhe të varrezave	Miraturar me VKM Nr. 190, datë	Jo	93	465,000
2	2691	321/2	Truall	Milec -	14350	0		Jo	93		

²⁴ Përcaktuar në VKM nr.89, datë 03.0.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH”.

				Mollas				15.3.2017			1,334,550
3	1594	8/73/1	Truall	Ersekë	74700	1531	Ish brigatë këmbësorie		Po	1775	132,592,500
4	1594	8/73/2	Truall	Ersekë	509	302	Ish dega e mobilizimit		Po	1775	903,475
5	1594	8/74/1	Truall	Ersekë	1369.5	115.5	Zyra		Po	1775	2,430,863
7	1594	8/74/4	Truall	Ersekë	54.63	54.63	Zyra		Po	1775	96,968
8	1594	5/46/1	Truall	Ersekë	1080	300	Biblioteka		Po	1775	1,917,000
9	1594	5/84	Truall	Ersekë	580	302	Çerdhe fëmijësh Rruga Ahmet Bektashi		Po	1775	1,029,500
10	2430	3/192	Truall	Leskovik	3259	1083	Shkolla, Konvikti, çerdhe		Jo	797	2,597,423

-Sa më sipër llogaria nr.210 është nënvlerësuar me vlerën **143,367,279 lekë**, vlerë e matshme.

-Nga analiza e llogarisë nr.211, konstatohet se:

1. Nuk është kryer inventarizimi i tyre;

2. Llogaria analitike nr.211 pasqyron informacion vetëm për 1 objekt në vlerën 1,067,680 lekë, ku theksojmë se ky objekt nuk është emërtuar, ndërkohë që në bilanc vlera e llogarisë nr.211 është 25,909,872 lekë, ose 24,842,192 lekë nuk dokumentohen.

3. Rregjistri që mbahet nga Drejtoria e Financës për këtë llogari, nuk është i plotë me informacion, pasi mungon informacioni për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës etj.

4. Nuk është kryer kontabilizimi i pyjeve, kullotave, zonave shkëmbore, të cilat janë në pronësi të Bashkisë Kolonjë, si dhe për më tepër ato troje të cilat janë pajisur edhe me certifikatë pronësie, pasqyruar si më poshtë:

Nr	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji i pronës	Adresa	Truall (m2)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Shënime	Administruar në inventarin e pronave	Lekë/m ²	Vlera
1	3164	1840/1	Zallishte	Rehovë	144184		Miratuar me VKM Nr. 247, datë 27.03.2013	Jo	100 ²⁵	14,418,400
2	3164	1840/3	Zallishte	Rehovë	108000			Jo	100	10,800,000
3	3164	1840/3	Zallishte	Rehovë	36184			Jo	100	3,618,400
4	1948	820/2	Pyll	Hemël-Mollas	251976			Jo	100	25,197,600
5	3510	685	Zallishte	Starje-Ersek fshat	1020711	E cila ndahet si më poshtë	Miratuar me VKM Nr. 764, datë 30.9.2020	Jo	100	102,071,100
	3510	685/1	Zallishte	Starje-Ersek fshat	60000	Dhënë me qira		Jo	100	6,000,000
	3510	685/2	Zallishte	Starje-Ersek fshat	197000	Dhënë me qira		Jo	100	19,700,000
	3510	685/3	Zallishte	Starje-Ersek fshat	183400	Dhënë me qira		Jo	100	18,340,000
	3510	685/4	Zallishte	Starje-Ersek fshat	180000	Dhënë me qira		Jo	100	18,000,000
	3510	685/5	Zallishte	Starje-Ersek fshat	400311	Dhënë me qira		Jo	100	40,031,100

-Sa më sipër llogaria nr.211 është nënvlerësuar me vlerën **156,105,500 lekë**, vlerë e matshme.

-Nga analiza e llogarisë nr.212, konstatohet se:

1. Nuk është kryer inventarizimi i të gjithë ndërtesave në pronësi të Bashkisë Kolonjë;

2. Nuk është kryer kontabilizimi i të gjithë ndërtesave në pronësi të Bashkisë Kolonjë, si më poshtë:

Nr.	Emri i Pronës Adresa	Sa ndërtesë (m ²)
1	Ish fabrika e konservave në ish. N.G.P	1058
2	Garazh makine, mbrapa zyrave të ishndërmarrjes ndërtimit	28
3	Frigoriferi ne Ish Ndërmarrja e Grumbullim Përpunimit	1038
4	Ambjent ne katin përdehe i ish shtëpisë së Pionerit Bulevardi "Dëshmorëve"	83
5	Stadiumi "Gramozi" Rruga e "Dëshmorëve"	
6	Magazina e pjesëve të ndrimt Degëzimi i rrugës "Riza Taçi"	251
7	Magazinë e repart marangoze Rruga 20 Maji Blloku Nr. 4	100
8	Ish dega e mobilizimit	220
9	Ish garazhde të makinave të bashkisë dhe të ish këshillit të rrethit	98
10	Ish infirmieria I N G P-së dhe ish zyrat e karburantit të rrethit	72
11	Ish hoteli i oficerave	178
12	Garazh Komuna Qendër Ersekë	20
13	Çerdhe e Re Shëtitëtorja "15 Maji" Bashkia Leskovik	325
14	Q. Shëndetësore Fshati Radanj	24
15	Shkolla 9-Vjeçare Fshati Zharkanj	127
16	Shkolla 9-Vjeçare Fshati Vitisht	63
17	Shkolla 9-Vjeçare Fshati Shijan	109
18	Qendra Shëndetësore Fshati Mësiçkë	60

²⁵ Përcaktuar në VKM nr.89, datë 03.0.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH".

19	Qendra Shëndetësore Fshati Mësiçkë	105
20	Ish magazinë Fshati Novoselë	200
21	Garazh, depo Fshati Novoselë	281
22	Shkollë Filllore Fshati Psar i Zi	191

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z.E.I, Kryetar i Bashkisë Kolonjë dhe zj.G.D, Drejtor i Financës.

Kriteri: Nenin 35, nenin 37, nenin 41 dhe nenin 44 në Ligjin nr. 20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 6 në Ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; Nenin 62 në Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Nenin 9 dhe nenin 12 në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM Nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Kapitulli III, pika 30 dhe paragrafi 104 në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”

Ndikimi/Efekti: Llogaritë nr. 210 “Toka, troje, terrene”, nr. 211 “Pyje Plantacione” dhe nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione” nuk paraqesin situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorin e Financës të planifikojë në buxhet një fond të detajuar për kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve nga ekspertë vlerësues të licencuar.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të nxjerrë urdhër të brendshëm, për përcaktimin e afatit konkret si dhe ngritjen e një strukture të posaçme, me objekt vetëm inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, për:

- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene”, nr.211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”.

- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Situata: Gjendja e llogarisë nr.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën kontabël 59,121,291 lekë. Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Nga analiza e llogarisë analitike, rezulton se në llogarinë 4341, ndër të tjera janë kontabilizuar edhe debitorët (llogaria 468) ndaj Bashkisë Kolonjë, për taksa dhe tarifa vendore, gjoha, si dhe qiratë. Përbërja e kësaj llogarie pasqyrohet si më poshtë:

Llogaria		Debi	Kreditimi 4341
423-429	Personeli, para ,gjoha	577,118	59,121,291
468	Debitorë të ndryshëm	58,542,301	
411	Klientë e llogari të ngjashme	1,872	
	Total	59,121,291	59,121,291

-Sa më sipër konstatohet se në llogarinë 4341 është bërë kontabilizim i gabuar i vlerës së debitorëve për taksa dhe tarifa vendore, gjoba, si dhe qiratë. Konkretisht nga analizimi i përbërjes së debitorëve, për disa zëra Bashkia Kolonjë nuk ka detyrimin që t'i arkëtojë ato për llogari të buxhetit të shtetit, pasi nuk janë taksa të ndara apo Bashkia Kolonjë të veprojë si agjent tatimor për llogari të institucioneve të tjera. Në këtë rast kemi të bëjmë me taksa dhe tarifa vendore, si dhe gjoba, të cilat kalojnë direkt në buxhetin e Bashkisë Kolonjë, pasqyruar si më poshtë vijon:

Emërtimi i zërave në llogarinë 468	Vlera
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	31,437,086
NIPT Sekondar për punime të kryera	123,120
Takse pasurie erseke	1,654,202
Taksa e tokës bujqësore	3,459,150
Gjoba të Policisë Bashkiake	182,500
Biznesi i Madh	5,336,030
Biznesi i Vogël	4,007,408
Institucione	754,139
Total	46,953,635

-Sa më sipër llogaria nr.4341 është mbivlerësuar me vlerën **46,953,635 lekë**.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, zj.G.D, Drejtor i Financës.

Kriteri: Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” klasa 4 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve”.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet kontabilizimi i saktë i llogarisë nr.4341, duke pasqyruar në këtë llogari detyrime të Bashkisë Kolonjë ndaj buxhetit të shtetit.

III.2.4. Mbi planifikimin dhe zbatimin procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për investime në punë publike.

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën 01.07.2021 – 31.12.2021, Bashkia Kolonjë referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **27** procedura prokurimi me vlerë kontrate **15,672** mijë lekë, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **2,048** mijë lekë ose **12%**. Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **208** OE/BOE, nga të cilat janë s’kualifikuar **181** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE është **1** procedur ose 4 % e procedurave të zhvilluara.Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.07.2021 – 31.12.2021	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate	Diferenca	Në %
GJITHESEJ	27	17,721,616	15,672,815	2,048,801	12%
-Të hapura	0	0	0	0	
- Kërkesë me propozim	0	0	0	0	

- Shërbim konsulence	0	0	0	0
- Negocim pa shpallje	0	0	0	0
- E hapur e thjeshtuar	3	6,249,999	5,493,080	756,919
- Vlerë e vogël	24	11,471,617	10,179,735	1,291,882
Sipas objekteve				
-Objekte në fushën e punëve publike	7	7,851,541	6,708,590	1,142,951
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	20	9,995,075	8,964,225	1,030,850

Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjedhi për auditim:

-17 procedura prokurimi me vlerë kontrate 14,050,215 lekë, ose 90% të vlerës së kontratave të lidhura për periudhën 01.07.2021-31.12.2021.

Periudha 01.07.2021-31.12.2021

Prokurimet me vlerë të lartë

1. “Blerje materiale ndërtimi për rikonstrukcionin e katit të parë të qendrës multifunktionale të qytetit Ersekë, Bashkia Kolonjë”.
2. “Ndriçim LED qyteti Ersekë, Bashkia Kolonjë viti 2021”.
3. “Këndi i lodrave për fëmijët, qyteti Ersekë Bashkia Kolonjë viti 2021, (Faza I)”.

Prokurimet me vlerë të vogël

4. “Shërbim mirëmbajtje Furnizim Vendorsje Pompe Naftë për Eskavatorin Volvo EC220D në Bashkinë Kolonjë”.
5. “Blerje uniforma për sektorin e MZSH”.
6. “Blerje materiale për mirëmbajtjen e shkollave, kopshteve, konvikteve dhe çerdhes për vitin shkollor 2021-2022 në Bashkinë Kolonjë”.
7. “Blerje materiale për riparimin e trotuareve të Bashkisë Kolonjë për vitin 2021”.
8. “Blerje ushqime për konviktin e Bashkisë Kolonjë periudha Shtator-Dhjetor 2021”.
9. “Riparim i Makinës Teknologjike Reno vit prodhimi 2003 në pronësi të Bashkisë Kolonjë”.
10. “Blerje materiale për sektorin e MZSH në Bashkinë Kolonjë”.
11. “Riparim Sifoni në kanal in ujitës fshati Borovë viti 2021 në Bashkinë Kolonjë”.
12. “Hartimi i planit të mbarështrimit të fondit pyjor dhe kullosor pjesë të ekonomisë pyjore Orgockë (pjesa 2) për vitin 2021 në Bashkinë Kolonjë”.
13. “Blerje orendi dhe pajisje guzhine për çerdhen “Motrat Qirjazi” në Bashkinë Kolonjë”.
14. “Zhblllokim të ujëlëshuesve fundorë në 5 Ujëmbledhësat Barmash, Starje, Gostivisht, Zharkanj, Radanj 2 për rritjen e sigurisë së digave, në Bashkinë Kolonjë”.
15. “Riparim hidro-izolimi i tarracave në shkollat 9-vjeçare Barmash e Qinam në Bashkinë Kolonjë”.
16. “Blerje materiale për shpenzime dekori (verë - dimër) për aktivitetet e vitit 2021”.
17. “Ndërtim Prita në Përrenjtë Starje dhe Mesiçkë viti 2021 në Bashkinë Kolonjë”.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit të mësipërme u konstatuan mangësi në procedurat si më poshtë vijon²⁶:

²⁶ Ndikimi, kriteri, shkaku dhe rekomandimi janë dhënë në fund të trajtimit të procedurave të prokurimit në mënyrë të përmbledhur, me qëllim eliminimin e përsëritjes.

1.Tenderi me objekt: “Blerje materiale ndërtimi për rikonstruksionin e katit të parë të qendrës multifunkionale të qytetit Ersekë, Bashkia Kolonjë” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale ndërtimi për rikonstruksionin e katit të parë të qendrës multifunkionale të qytetit Ersekë, Bashkia Kolonjë”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 14, Datë 01.11.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 490 dt. 01.11.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 491 dt. 01.11.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur e thjeshtuar	1. A.T 2. M.T 3. A.C	1. E.M – (Kryetar) 2. E.H – (Anëtar) 3. G.D – (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 2,083,183	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE "A.C", 2,032,720 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 50,463 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 15.11.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë dhe granti qendror	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S’kualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s’ka; APP–s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr.19 prot., datë 14.12.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 2,439,264 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 5 ditë	19. Zgjatja e kontratës me - ditë -

Sa më sipër u konstatua:

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.5338, datë 01.11.2021, i ndryshuar, nga NJP.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Në pikën 2.2.1 nga AK kërkohet që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018-2019-2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht 833,273 lekë pa TVSH – Sipas përcaktimit në shkronjën ”c” të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

Kapaciteti teknik

Në pikën 2.3.1 nga AK kërkohet që OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës – Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën “b” të në pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Në pikën 2.3.2 nga AK kërkohet që OE duhet të ofrojë/në garanci për mallin e ofruar si dhe ndërrimin nga difekte fabrikimi. Për përmbushjen e kësaj pike operatori/et ekonomik duhet

të paraqesë/in një vetëdeklaratë të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor se në rast defektesh fabrikimi operatori merrë përsipër zëvendësimin e mallit. Gjithashtu në pikën 2.3.6 kërkohet që OE duhet të paraqesë/in fletë garanci për mallin e ofruar **deri në 1 vit për artikujt B “materiale të nevojshme për realizimin e punimeve mekanike” dhe C “materiale të nevojshme për realizimin e punimeve elektrike”, ilustruar me disa prej tyre si, tubo, rakorderi, saracineska, prize, përcjellës, etj** - Kërkesat e mësipërme nuk janë konkrete dhe në përputhje me kuadrin rregullator të fushës, konkretisht në nenin 32 të Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, pasi për përmbushjen e kësaj pike duhet fletë-garancia dhe jo vetëdeklaratë, gjithashtu në kërkesën e mësipërme nuk është specifikuar se çfarë duhet të mbulojë garancia në produktet e sjella dhe zonën mbi të cilën vepron ajo. Për më tepër që shitësi i produktit duhet të ketë pjesë këmbimi të nevojshme për mirëmbajtjen dhe riparimin e mallrave brenda periudhës së garancisë, qoftë kjo garanci sipas dispozitave ligjore apo atyre kontraktuale.

Në **pikën 2.3.3** nga AK kërkohet që OE **në rast se nuk janë prodhues** duhet të paraqesin për të gjitha produktet e kërkuara **vërtetim** ose **deklaratë** ose **autorizim nga prodhuesi**, ose **nga distributor i autorizuar prej prodhuesit**, vërtetuar me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis **ofertuesit-distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi. (Nëse dokumentacioni është në gjuhë të huaj duhet e përkthyer dhe noterizuar **si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit**) – Kjo kërkesë nuk është në përputhje me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet kërkesës së mësipërme, praktikisht përcaktohet që OE që do të marrë pjesë në garë duhet të jetë përfaqësues i autorizuar i prodhuesit, i cili ka prodhuar, produktet që do të ofertohen nga OE që do të marrë pjesë në garë. Sqarojmë se OE që do të marrë pjesë në garë mund të jetë importues dhe/ose shpërndarës i produkteve, si dhe bazuar në përcaktimet e bëra në nenin 12 dhe 13 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, për një produkt që tregton nuk ka detyrim që të ketë **vërtetim** ose **deklaratë** ose **autorizim**, por mjafton të ketë dokumentacionin teknik të produktit në gjuhën shqipe, deklaratë konformiteti EC, manual përdorimi, si dhe siguron vetë që në rast se produkti nuk është në përputhje e tërheq atë nga tregu duke marrë masat korrigjuese, sjelljen e tij në konformitet/dorëzimin e produktit të ri, sipas deklaratës së garancisë që do të ofrojë për produktet përkatëse.

Në **pikën 2.3.7** nga AK kërkohet që OE duhet të disponojë një mjet transporti kamion ose kamionçinë – Kërkesa e mësipërme nuk është e plotë, pasi nuk kërkohet që OE të ketë të punësuar një shofer të pajisur me lejen e drejtimit dhe dëshmi profesionale, në përputhje me kategorinë përkatëse që duhet në varësi të tonazhit të mjetit të transportit.

Përsa më sipër sipas rolit të tyre në NJP, mban përgjegjësi z.A.T, z.M.T dhe zj.A.C.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë me nr.491 dt. 01.11.2021 është ngritur KVO e cili përbëhet nga, zj. E.M, Kryetar, z. E.H dhe zj. G.D, Anëtar. Nga KVO janë mbajtur procesverbalet nr.1, datë 15.11.2021 dhe nr.2, datë 16.11.2021 për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.3, datë 14.12.2021 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A.C", me ofertë në vlerën 2,032,720 lekë pa TVSH me diferencë nga fondi limit në vlerën 50,463 lekë.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, konstatohet se bilanci i vitit 2018 ka pasaktësi në përmbajtjen e tij, konkretisht për formatin e aktiveve, jepet informacion për vitin 2017;

-Subjekti nuk ka likujduar detyrimet për sigurimet shoqërore në vlerën 16,950 lekë, sipas vërtetimit formulari E-SIG 02/a, lëshuar më datë 14.11.2021. Gjithashtu ky dokument nuk është dorëzuar fizikisht në momentin e dorëzimit të dokumenteve nga OE shpallur fitues, në vijim të njoftimit për shpalljen e fituesit.

-Deklarata e garancisë për produktet e sjella nga OE, nuk është në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 32 të Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, pasi nuk specifikohet se çfarë mbulon garancia në produktet e sjella/zonën mbi të cilën vepron ajo.

-Për produktin çimento 32.5 N, sipas ofertës teknike prodhuesi është subjekti “A.C” Sh.A. Autorizimi i lëshuar nga subjekti “L” Sh.P.K, ku autorizon subjektin “A.C” që të tregtojë produktin e mësipërm. Për të provuar lidhjen prodhues-distributor-ofertues, nga OE në fazën e dorëzimit të ofertës, është paraqitur kontrata e furnizimit datë 01.01.2013, lidhur ndërmjet subjektit “A.C” Sh.A dhe subjektit “L” Sh.P.K, por kontratës i ka mbaruar afati i vlefshmërisë më datë 31.03.2013.

-Gjithashtu kontrata e mësipërme nuk është dorëzuar fizikisht, në momentin e dorëzimit të dokumenteve nga OE shpallur fitues, në vijim të njoftimit për shpalljen e fituesit.

-Kontrata nr.319/11 prot., datë 04.01.2018, ndërmjet subjektit R Sh.P.K dhe subjektit L Sh.P.K nuk përmban mallrat që do furnizohet subjekti L Sh.P.K. Oferta bashkëlidhur kontratës është për të përcaktuar çmimet e materialeve në zbatim të nenit 4 “çmimi” dhe jo të nenit 1 “objekti”. Në fund të kontratës nuk është vula e subjektit L Sh.P.K.

-Gjithashtu kontrata e mësipërme nuk është dorëzuar fizikisht, në momentin e dorëzimit të dokumenteve nga OE shpallur fitues, në vijim të njoftimit për shpalljen e fituesit.

-Për rastin e kontratës datë 14.11.2021 të subjektit “A.C” me subjektin “E.T” Sh.P.K, nga verifikimi i ekstraktit të subjektit në QKB, rezulton se ai nuk është prodhues i produkteve që do të furnizojë subjektin “A.C”, pra është tregtues i tyre dhe në këto kushte për të plotësuar lidhjen prodhues-distributor-ofertues, duhet të ishte autorizimi i prodhuesit ndaj subjektit “E.T” Sh.P.K, për produktet që do të furnizohen sipas kontratës së mësipërme.

-Në dokumentin noterial, Nr.REP.7654, datë 05.11.2021, nuk specifikohet se çfarë dokumentesh janë noterizuar (njehsuar kopja me origjinalin), në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “g” të pikës 2 të nenit 105 të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”;

-Nuk administrohet vërtetimi noterial për përkthimin e katalogut teknik të produkteve të subjektit “D”. Në dokumentet e përkthyer në gjuhën shqipe, duhet nënshkrimi i përkthyesit²⁷. Pra që përkthimi të jetë i rregullt, duhet që veç dokumentit noterial (që duhet origjinal dhe i qartë në përmbajtje), edhe përkthimi i dokumenteve të jetë kryer nga një përkthyes i autorizuar dhe çdo dokument i përkthyer të jetë i firmosur nga përkthyesi. Sa më sipër nuk vërtetohet kryerja e përkthimit në gjuhën shqipe nga një përkthyes i autorizuar.

2.Tenderi me objekt: “Ndriçim LED qyteti Ersekë, Bashkia Kolonjë viti 2021” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndriçim LED qyteti Ersekë, Bashkia Kolonjë viti 2021”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 13, Datë 30.09.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 433 dt. 30.09.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 434 dt. 30.09.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur e thjeshtuar	1. A.T 2. M.T 3. A.C	1. E.M – (Kryetar) 2. E.H – (Anëtar) 3. G.D – (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 2,083,333	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE "A", 1,857,440 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 225,893 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 27.10.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë dhe granti qendror	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) S’kualifikuar - 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S’ka

²⁷ Neni 135 i Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”.

b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr.18 prot., datë 25.11.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 2,228,928 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 1 muaj/30 ditë	19. Zgjatja e kontratës me - ditë -

Sa më sipër u konstatua:

Titulli i gjetjes: Vendosija e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 30.09.2021, i ndryshuar, nga NJP.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Në pikën 2.2.1 nga AK kërkohet që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018-2019-2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht 833,333 lekë pa TVSH – Sipas përcaktimit në shkronjën "c" të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

Kapaciteti teknik

Në pikën 2.3.1 nga AK kërkohet që OE duhet të paraqesë dëshmi për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 30%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 625,000 lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës – Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën "a" të pikës 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, për kontratat e punëve publike, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 30%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Në pikën 2.3.3 nga AK kërkohet që OE me anë të një deklarate të duhet të përcaktojë **Drejtuesin/t Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (**Inxhinier Ndërtimi**), për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera - Sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", shprehimisht: "Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi". Pra sa më sipër nuk jemi në kushtet kur preventivi i punimeve është mbi 30,000,000 lekë, si dhe nuk është e nevojshme deklarata e mësipërme.

-Gjithashtu është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, përjashtuar ata me formimin profesional Elektracist (Hidraulik, Manovrator, Specialist ndërtimi, Shofer mjetesh të rënda) të kërkohet dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik e lëshuar nga ISHTI, ose nga një trup çertifikuese e akredituar në RSH-së, pasi kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për punonjësit e tjerë të cilët nuk do të kryejnë punime elektrike. Për më tepër që për manovratorin dhe shoferin e mjeteve të rënda, janë të mjaftueshme dëshmitë të cilat jepen sipas kuadrit rregullator të fushës, si dëshmia e aftësisë

profesionale për mjete punimi, certifikata e aftësimin profesional, të cilat vërtetojnë kualifikimet e punonjësve në fushën, në të cilën ata kryejnë detyrat e tyre.

Përsa më sipër sipas rolit të tyre në NJP, mban përgjegjësi z.A.T, z.M.T dhe zj.A.C.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë me 434 dt. 30.09.2021 është ngritur KVO e cili përbëhet nga, zj. E.M, Kryetar, z. E.H dhe zj. G.D, Anëtar. Nga KVO janë mbajtur procesverbalet nr.1, datë 27.10.2021 dhe nr.2, datë 29.10.2021 për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 4 OE, përkatësisht:

1.A Sh.P.K me ofertën në vlerën 1,857,440 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 225,893 lekë;

2.S Sh.P.K me ofertën në vlerën 1,874,587 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 208,746 lekë;

3.BOE Z Sh.P.K dhe I.K Sh.P.K, me ofertën në vlerën 1,876,317 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 207,016 lekë;

4.R.C Sh.P.K, me ofertën në vlerën 2,031,630 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 51,703 lekë.

-Nga 4 OE që kanë marrë pjesë është shpallur fitues OE "A", me çmimin më të ulët, konkretisht në vlerën 1,857,440 lekë pa TVSH me diferencë nga fondi limit në vlerën 225,893 lekë, pasi kriteret e veçanta të kualifikimit përmbushen nga të gjithë OE që kanë marrë pjesë në garë.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, rezulton se OE plotëson kriteret e kualifikimit.

3.Tenderi me objekt: "Këndi i lodrave për fëmijët, qyteti Ersekë Bashkia Kolonjë viti 2021, (Faza I)" me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Këndi i lodrave për fëmijët, qyteti Ersekë Bashkia Kolonjë viti 2021, (Faza I)"		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 12, Datë 30.09.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 430 dt. 30.09.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 431 dt. 30.09.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur e thjeshtuar	1. A.T 2. M.T 3. E.C	1. E.M – (Kryetar) 2. E.Z – (Anëtar) 3. E.H – (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 2,083,333	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE "A", 1,602,920 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 480,413 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 25.10.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë dhe granti qendror	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S'kualifikuar - 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka KPP-s'ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave.		
14. Lidhja e kontratës Nr.17 prot., datë 25.11.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 1,923,504 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 2 muaj/61 ditë	19. Zgjatja e kontratës me - ditë -

Sa më sipër u konstatua:

Titulli i gjetjes: Vendosija e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kritereve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 30.09.2021, i ndryshuar, nga NJP.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Në pikën 2.2.1 nga AK kërkohet që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018-2019-2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht 833,333 lekë pa TVSH – Sipas përcaktimit në shkronjën "c" të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

Kapaciteti teknik

Në pikën 2.3.1 nga AK kërkohet që OE duhet të paraqesë dëshmi për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 30%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 625,000 lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës – Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën "a" të pikës 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, për kontratat e punëve publike, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 30%** të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Në pikën 2.3.3 nga AK kërkohet që OE me anë të një deklarate të duhet të përcaktojë **Drejtuesin/t Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (**Inxhinier Ndërtimi**), për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera - Sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", shprehimisht: "Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi". Pra sa më sipër nuk jemi në kushtet kur preventivi i punimeve është mbi 30,000,000 lekë, si dhe nuk është e nevojshme deklarata e mësipërme.

-Gjithashtu është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, përjashtuar ata me formimin profesional Elektracist (Manovrator, Specialist ndërtimi dhe teknik ndërtimi, Shofer mjetesh të rënda) të kërkohet dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik e lëshuar nga ISHTI, ose nga një trup çertifikuese e akredituar në RSH-së, pasi kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për punonjësit e tjerë të cilët nuk do të kryejnë punime elektrike. Për më tepër që për manovratorin dhe shoferin e mjeteve të rënda, janë të mjaftueshme dëshmitë të cilat jepen sipas kuadrit rregullator të fushës, si dëshmia e aftësisë profesionale për mjete punimi, certifikata e aftësisë profesionale, të cilat vërtetojnë kualifikimet e punonjësve në fushën, në të cilën ata kryejnë detyrat e tyre.

Në pikën 2.3.3, nga AK ndër të tjera, kërkohen edhe dy shoferë, ndërkohë që në pikën 2.3.5, në kërkesat për mjetet e transportit, është kërkuar vetëm një kamion.

Në pikën 2.3.5 nga AK kërkohet që OE të disponojë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës "minimumi 7 – maksimumi 10 ton", gjithashtu është kërkuar edhe vinç kullë – Kërkesa e AK duke vendosur kufirin maksimal për kapacitetin mbajtës të kamionit është e pa argumentuar, pasi një kërkesë e tillë kufizon një OE që mund të ketë kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 ton (11 apo 12 ton) dhe kriteri i mësipërm e kufizon të marrë pjesë në garë. Gjithashtu kërkohet vinç kullë, ndërkohë që AK mund të kishte vendosur kërkesën për disponimin e kamionit me vinç, i cili mundëson edhe vetëshkarkimin e materialeve.

Përsa më sipër sipas rolit të tyre në NJP, mban përgjegjësi z.A.T, z.M.T dhe z.E.C.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë me 431 dt. 30.09.2021 është ngritur KVO e cili përbëhet nga, zj. E.M, Kryetar, z. E.H dhe z. E.Z, Anëtar. Nga KVO janë mbajtur procesverbalet nr.1, datë 25.10.2021 dhe nr.2, datë 29.10.2021 për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.3, datë 25.11.2021 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE, përkatësisht:

1.A Sh.P.K me ofertën në vlerën 1,602,920 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 480,413 lekë;

2.XH Sh.P.K me ofertën në vlerën 1,685,728 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 397,605 lekë;

3.A Sh.P.K me ofertën në vlerën 1,685,728 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 304,411 lekë;

-Nga 3 OE që kanë marrë pjesë është shpallur fitues OE “A”, me çmimin më të ulët, konkretisht në vlerën 1,602,920 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 480,413 lekë.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, rezulton se OE plotëson kriteret e kualifikimit.

Konkluzion

Sa më sipër rezulton se në një rast OE i shpallur fitues nuk përmbush plotësisht kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte bërë kualifikimin e tij, por duhet të kishte anuluar tenderin përkatës.

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar në krye të herës, detyrat e përcaktuara për rolin e titullarit, NJP dhe KVO në administrimin e procedurave të prokurimit publik deri në lidhjen e kontratës me OE të shpallur fitues, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi:

Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO)

zj. E.M, Kryetar i KVO në 1 procedurë;

z. E.H, Anëtar i KVO në 1 procedurë;

zj. G.D, Anëtar i KVO në 1 procedurë.

Për Njësinë e Prokurimit Publik (NJP)

z.A.T, Kryetar i NJP në 3 procedura;

z.M.T, Anëtar i NJP në 3 procedura;

zj.A.C, Anëtar i NJP në 2 procedura;

z.E.C, Anëtar i NJP në 1 procedurë.

Kriteri: Nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 dhe nenin 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;

Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, pikën 4 në nenin 39, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55, pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Kufizim të konkurrencës dhe cenimin e qëllimeve të kuadrit ligjor për prokurimin.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, të analizojë arsyet e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe të kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë

masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

Titulli i Gjetjes: Mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik, për blerje mallrash, shërbimesh dhe investimesh (blerje të vogla).

Situata: Nga auditimi i këtyre procedurave u konstatua si më poshtë:

- Në 14 raste nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit;
- Në 14 raste urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokollin, si dhe në 11 raste nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;
- Në 14 raste ftesa për ofertë nuk ka nr., protokollin dhe datë;
- Në 14 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;
- Në 14 raste dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- Në 12 raste nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përllogaritur fondin limit;
- Në 7 raste afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, si dhe nga Komisioni i blerjeve të vogla nuk është përllogaritur penalitet;
- Në 1 rast nuk dokumentohet procesverbali për tërheqjen e OE shpallur fitues dhe për kalimin tek OE i radhës;
- Në 1 rast nuk administrohet procesverbali i marrjes në dorëzim të projekt zbatimit për hartimin e planit të mbarë-shtrimit të fondit pyjor kullësor për vitin 2021.

Kriteri: Shkronjat “dh”, “e” dhe “ë” të pikës 2 në nenin 26, pikën 1 të nenit 27, pikën 3 të nenit 40, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pikën 3 në nenin 74, nenin 76, nenin 77 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar; Pikën 7, 8 dhe 17 në udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”; Pika 5 dhe pika 6 në Udhëzimin nr. 8 datë 01.09.2021 “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”.

Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në transparencën dhe administrimin e fondeve buxhetore të alokuara për prokurimin me vlerë të vogël.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

Rekomandimi: Gjithashtu për 7 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përllogaritet penaliteti përkatës dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

Më hollësisht rastet trajtuar si më poshtë vijon:

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “**Shërbim mirëmbajtje Furnizim Vendosi Pompe Naftë për Eskavatorin Volvo EC220D në Bashkinë Kolonjë**”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, S.HL, E.C dhe E.Z;

-Urdhri nr. 24, datë 05.07.2021, i prokurimit për shërbimi mirëmbajtje furnizim vendosë pompë naftë për Eskavatorin Volvo EC220D në Bashkinë Kolonjë.

-Urdhri nr. 320, me nr. 3243 prot., datë 05.07.2021, për ngritjen e komisionit të përgatitjes së specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit me përbërje R.K, S.D dhe N.M; Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 320,000 lekë pa TVSH;

-Urdhri nr. 335 me nr. 3539 prot., datë 19.07.2021, për ngritjen e komisionit për ndjekjen e punës dhe të marrjes në dorëzim të mallit, me përbërje si vijon: S.D, Y.Ç dhe N.M;

-Procesverbali nr. s'ka, datë 19.07.2021 për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallit;

-Fletë hyrja në magazinën e institucionit me nr. 38 datë 19.07.2021;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 5/2021, datë 23.07.2021, në vlerën e 312,500 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE "O.M" me ofertën më të ulët, në vlerën 302,900 lekë pa TVSH. OE Fitues është njoftuar në datë 09.07.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit. Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 12.07.2021 OE "O.M" është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "O.M" ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE "A 2018" i renditur i dyti me ofertën 308,000 lekë pa TVSH. OE Fitues është njoftuar në datë 12.07.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit. Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 13.07.2021 OE "A 2018" nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta s'kualifikoj OE "A 2018";

AK ka vazhduar me OE "H.I" i renditur i treti me ofertën 312,500 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 7,500 lekë pa TVSh. OE Fitues është njoftuar në datë 13.07.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit. Në dosje administrohet preventivi për riparimin e pompës së naftës për Eskavatorin Volvo EC220D, por nuk është përcaktuar se ku është referuar komisioni për të nxjerrë vlerën e fondit limit;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokoll;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokoll dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE "H.I" shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet vërtetimi mbi Gjendjen Gjyqësore që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk administrohet deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk administrohet vërtetimi për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSSHE;

-Nuk administrohet kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje e vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar;

-Dokumentacioni i dorëzuar nga OE rezulton se nuk janë origjinal dhe as kopje të noterizuara sipas ftesës për ofertë;

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 13.07.2021, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 14.07.2021, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 19.07.2021, pra 5 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për realizimin e nënshkrimit të kontratës, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësimin komisionit i prokurimit.

5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje uniforma për sektorin e MZSH”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, SH.L, E.C dhe E.Z;

-Urdhri nr. 26, datë 30.07.2021, i prokurimit për blerje uniforma për sektorin e MZSH; Fondi limit nuk është përcaktuar;

-Urdhri nr. 407, me nr. 4427 prot., datë 15.09.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje si vijon: V.D, M.X dhe B.K;

-Procesverbali nr. s'ka, datë 15.09.2021 për marrjen në dorëzim të mallrave;

-Fletë hyrja në magazinën e institucionit me nr. 43 datë 15.09.2021;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 26/2021, datë 15.09.2021, në vlerën e 296,400 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje SH.L, E.Z dhe E.C, ku është shpallur fituesi OE “A – E. Z” me ofertën më të ulët, në vlerën 219,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 03.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 04.08.2021 OE “A – E. Z” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “A – E. Z” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE ‘S.A i renditur i dyti me ofertën 225,800 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 04.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 05.08.2021 OE ‘S.A nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë, në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta s’kualifikoj OE “S.A”;

AK ka vazhduar me OE ‘U.P i renditur i treti me ofertën 230,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 05.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se OE ‘U.P ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “O.T” i renditur në vendin e katërt me ofertën 233,333 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 05.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 06.08.2021 OE “O.T” nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë, në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta s’kualifikoj OE “O.T”;

AK ka vazhduar me OE ‘B i renditur në vendin e pestë me ofertën 239,800 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 06.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 09.08.2021 OE ‘B shpk nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë, si dhe ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE ‘E.A dhe “2 H 2016” i renditur në vendin e gjashtë dhe vendin e shtatë me të njëjtën vlerë oferte 240,000 lekë pa TVSH. Procedura do të zhvillohet me short në datën 10.08.2021 në ambientet e Bashkisë Kolonjë.

OE Fitues është njoftuar në datë 09.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 10.08.2021 OE ‘E.A ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, OE H 2016 nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta s’kualifikoj OE H 2016;

AK ka vazhduar me OE ‘J.G i renditur në vendin e tetë me oferte 245,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 10.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Nuk dokumentohet procesverbali për tërheqjen e OE shpallur fitues dhe për kalimin tek OE i radhës i renditur në vendin e nëntë me ofertë 247,000 lekë pa TVSH;

OE Fitues është njoftuar në datë 01.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit.

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për përlllogaritjen e fondit limit;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokollin, si dhe nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokollin dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Nuk administrohet deklarata e garancisë së mallit të prokuruar;

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE "E.M" shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore;

-Mungon deklarata e OE shpallur fitues i cili duhet të marrë përsipër transportin e mallrave pranë magazinës së Bashkisë Kolonjë.

-Mungon dorëzimi i mostrave për secilin artikull;

-Mungon Çertifikata ISO 22301:2012;

-Mungon kopje e çertifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje e vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar;

-Afati i dorëzimit të mallit nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi dorëzimi i mallit është përcaktuar të bëhet brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 01.09.2021, pra malli duhej të dorëzohej brenda datës 10.09.2021, ndërkohë është dorëzuar më datë 15.09.2021, pra 5 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për dorëzimin e mallit, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi komisioni i prokurimit.

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje materiale për mirëmbajtjen e shkollave, kopshteve, konvikteve dhe çerdhes për vitin shkollor 2021-2022 në Bashkinë Kolonjë".

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, SH.L, E.C dhe E.Z;

-Urdhri nr. 27, datë 30.07.2021, i prokurimit për blerjen e materialeve për mirëmbajtjen e shkollave, kopshteve, konvikteve dhe çerdhes për vitin shkollor 2021-2022 në Bashkinë Kolonjë.

Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 778,900 lekë pa TVSH;

-Urdhri nr. 368, me nr. 3969 prot., datë 13.08.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje si vijon: E.D, M.J dhe A.L;

-Procesverbali nr. s'ka, datë 13.08.2021 për marrjen në dorëzim të mallrave;

-Fletë hyrja në magazinën e institucionit me nr. 27 datë 13.08.2021;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 4/2021, datë 13.08.2021, në vlerën e 882,000 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje SH.L, E.C dhe E.Z, ku është shpallur fituesi OE "B.B" me ofertën më të ulët, në vlerën 683,400 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 03.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 04.08.2021 OE "B.B" është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "B.B" ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE "D & C" i renditur i dyti me ofertën 690,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 04.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit. Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 04.08.2021 OE ‘D & C’ është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE ‘D & C’ ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE ‘S-A 2016’ i renditur i treti me ofertën 695,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 04.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se OE ‘S 2016’ nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta s’kualifikoj OE ‘S 2016’;

AK ka vazhduar me OE ‘K.GJ’ i renditur i katërt me ofertën 697,800 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 05.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 06.08.2021 OE ‘K.GJ’ nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë, në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta s’kualifikoj OE ‘K.GJ’;

AK ka vazhduar me OE ‘A’ i renditur në vendin e pestë me ofertën 717,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 09.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 09.08.2021 OE ‘A’ është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE ‘A’ ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE ‘M.H’ i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 735,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 43,900 lekë pa TVSh.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit. Konkretisht në preventivin e mallrave të hartuar nga inxhinieri Muharrem Tartari, nuk pasqyrohet informacioni se ku është referuar për përcaktimin e çmimit për njësi të mallrave;

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e inxhinierit për të përllogaritur fondin limit, pra inxhinieri nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokollin, si dhe nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokollin dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Nuk administrohet deklarata e garancisë së mallit të prokuruar;

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE ‘M.H’ shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore;

-Mungon deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Mungon deklarata e OE shpallur fitues i cili duhet të marrë përsipër transportin e mallrave pranë magazinës së Bashkisë Kolonjë.

-Afati i dorëzimit të mallit nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi dorëzimi i mallit është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 09.08.2021, pra malli duhej të dorëzohej brenda datës 10.08.2021, ndërkohë është dorëzuar më datë 13.08.2021, pra 2 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për dorëzimin e mallit, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mban përgjegjësi komisioni i prokurimit.

7. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale për riparimin e trotuareve të Bashkisë Kolonjë për vitin 2021”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit;

-Urdhri nr. 30, datë 30.08.2021, i prokurimit për blerjen e materialeve për riparimin e trotuareve të Bashkisë Kolonjë për vitin 2021;

Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 416,270 lekë pa TVSH, çmimet janë mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;

-Urdhri nr. 404, me nr. 4404 prot., datë 14.09.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim;

-Procesverbali nr. s’ka, datë 11.11.2021 për marrjen në dorëzim të mallrave;

-Fletë hyrja në magazinën e institucionit me nr. 32 datë 11.11.2021;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 16/2021, datë 11.11.2021, në vlerën e 492,000 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE “T.I” me ofertën më të ulët, në vlerën 372,000 lekë pa TVSH. OE Fitues është njoftuar në datë 31.08.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 01.09.2021 OE “T.I” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “T.I” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “B.C.I” i renditur i dyti me ofertën 377,700 lekë pa TVSH. OE Fitues është njoftuar në datë 01.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 02.09.2021 OE “B.C.I” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “B.C.I” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “E.K.M” i renditur i treti me ofertën 388,000 lekë pa TVSH. OE Fitues është njoftuar në datë 02.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se OE “E.K.M” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “O.H” i renditur i katërt me ofertën 388,600 lekë pa TVSH. OE Fitues është njoftuar në datë 03.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 07.09.2021 OE “O.H” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “2 S” i renditur në vendin e pestë me ofertën 389,900 lekë pa TVSH. OE Fitues është njoftuar në datë 07.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 08.09.2021 OE “2 S” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “2 S” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “A. K.M” i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 398,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 08.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 09.09.2021 OE “A.K.M” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “A. K..M” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “A.C” i renditur në vendin e shtatë me ofertën 410,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 6,270 lekë pa TVSh.

OE Fitues është njoftuar në datë 09.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Kolonjë përfaqësuar nga Kryetari E.I dhe Operatorit Ekonomik "A.C" Shpk është lidhur Kontratë-Furnizim-Mallra me nr. 13 datë 14.09.2021 për “Blerje materiale për riparimin e trotuareve të Bashkisë Kolonjë për vitin 2021” sipas preventivit të paraqitur nga

Bashkia Kolonjë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Realizimi i kësaj kontrate duhet të realizohet brenda 24-orëve nga data e njoftimit të fituesit.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e inxhinierit për të përlllogaritur fondin limit, pra inxhinieri nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokollin, si dhe nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokollin dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Nuk administrohet deklarata e garancisë së mallit të prokuruar;

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE "A.C" shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Mungon vërtetim për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSSHE;

-Mungon vërtetimi bankar që të përmbajë nr. e llogarisë dhe IBAN-in;

-Mungon kopje e çertifikatës elektronike për fiskalizim, dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar;

-Mungon deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Mungon deklarata e OE shpallur fitues i cili duhet të marrë përsipër transportin e mallrave pranë magazinës së Bashkisë Kolonjë.

-Afati i dorëzimit të mallit nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi dorëzimi i mallit është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 09.09.2021, pra malli duhej të dorëzohej brenda datës 10.09.2021, ndërkohë është dorëzuar më datë 11.09.2021, pra 1 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për dorëzimin e mallit, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mban përgjegjësi komisioni i prokurimit;

8. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje ushqime për konviktin e Bashkisë Kolonjë periudha Shtator-Dhjetor 2021".

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit;

-Urdhri nr. 32, datë 07.09.2021, i prokurimit për blerjen e ushqimeve për konviktin e Bashkisë Kolonjë periudha shtator-dhjetor 2021;

Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 396,430 lekë pa TVSH;

-Urdhri nr. 406, me nr. 4422 prot., datë 15.09.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave;

-Procesverbali i marrjes në dorëzim i ushqimeve dhe ecuria e zbatimit të kontratës nuk është zbatuar nga komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave i ngritur nga Kryetari i Bashkisë;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturave tatimore që janë dorëzuar cdo muaj pranë Financës së AK dhe në total janë likuiduar në vlerën e 475,200 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE "O.T" me ofertën më të ulët, në vlerën 366,667 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 09.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 10.09.2021 OE "O.T" nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta s'kualifikoj OE "O.T";

AK ka vazhduar me OE "J.G" i renditur i dyti me ofertën 383,333 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 10.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 10.09.2021 OE "J.G" është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e

vlerësimit të ofertave, OE 'J.G' ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE 'E i renditur i treti me ofertën 385,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 10.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezultoi se OE 'është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE 'E ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE "R.L" i renditur në vendin e katërt me ofertën 396,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 430 lekë pa TVSh.

OE Fitues është njoftuar në datë 10.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Kolonjë përfaqësuar nga Kryetari E.I dhe Operatorit Ekonomik "R.L" Shpk është lidhur Kontratë-Furnizimi me nr. 05, me nr. 4422 prot., datë 15.09.2021 për "Blerje ushqime për konviktin Ersekë periudha Shtator-Dhjetor 2021" sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Kolonjë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Realizimi i kësaj kontrate duhet të realizohet deri më datë 31.12.2021 dhe hyn në fuqi pas nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit. Konkretisht në preventivin e mallrave të hartuar nga komisioni për përllogaritjen e fondit limit, nuk pasqyrohet informacioni se ku është referuar për përcaktimin e çmimit për njësi të mallrave si dhe nuk administrohen ofertat e çmimeve të marra në treg;

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përllogaritur fondin limit, pra komisioni për përllogaritjen e fondit limit nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokoli;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokoli dhe datë.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Nuk administrohet raport analizë, lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës, për produktet e ofruara;

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE "R.L" shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021;

-Nuk administrohet vërtetimi për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSSHE;

-Nuk administrohet vërtetim mbi Gjendjen Gjyqësore, që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk administrohet deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk administrohet deklarata e OE shpallur fitues i cili duhet të marrë përsipër transportin e mallrave çdo ditë sipas kërkesës së AK.

-Nuk administrohet vetë-deklarimi nga OE shpallur fitues, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet kon-formë kërkesave ligjore;

-Nuk administrohet kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje e vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar;

Komisioni i prokurimit duhet të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mban përgjegjësi komisioni prokurimit;

9. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Riparim i Makinës Teknologjike Reno vit prodhimi 2003 në pronësi të Bashkisë Kolonjë".

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit;

-Urdhri nr. 34, datë 09.09.2021, i prokurimit për riparinin e makinës teknologjike Reno me vit prodhimi 2003 në pronësi të Bashkisë Kolonjë.

Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 427,000 lekë pa TVSH;

- Urdhri nr. 405 me nr. 4421 prot., datë 15.09.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim;
- Procesverbali nr. s'ka, datë 16.09.2021 për marrjen në dorëzim të mallrave;
- Fletë hyrja në magazinën e institucionit me nr. 44 datë 16.09.2021;
- Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 6/2021, datë 16.09.2021, në vlerën e 425,000 lekë me TVSH;
- Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE "L.S" me ofertën më të ulët, në vlerën 246,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 10.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 10.09.2021 OE "L.S" është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "L.S" ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE 'N i renditur i dyti me ofertën 278,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 10.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 10.09.2021 OE 'N është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE 'N ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE 'H.I i renditur i treti me ofertën 425,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 2,000 lekë pa TVSh.

OE Fitues është njoftuar në datë 13.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

- Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit. Konkretisht në preventivin e mallrave të hartuar nga komisioni me përbërje z.R.K, z. S.D dhe N.M, nuk pasqyrohet informacioni se ku është referuar për përcaktimin e çmimit për njësi të mallrave dhe për shërbimin e kryer;
- Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përllogaritur fondin limit, pra komisioni që ka hartuar preventivin nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;
- Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokollin, si dhe nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;
- Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokollin dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

- Nuk administrohet deklarata e garancisë së mallit të prokuruar;
- Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- OE "H.I" i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:
- Vërtetim mbi Gjendjen Gjyqësore që lidhet me aktivitetin profesional;
- Mungon deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;
- Mungon vërtetim për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSSHE;
- Mungon vërtetim nga banka e nivelit të dytë për nr. e lloagrisë dhe IBAN;
- Mungon kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar;
- Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi lëvrimi i mallit/realizimi të shërbimit/punës është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 13.09.2021, pra malli/shërbimi duhej të realizohej brenda datës 14.09.2021, ndërkohë është dorëzuar më datë 16.09.2021, pra 2 ditë vonësë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për dorëzimin e mallit, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mban përgjegjësi komisioni i prokurimit;

10. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale për sektorin e MZSH në Bashkinë Kolonjë”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit;

-Urdhri nr. 36, datë 20.09.2021, i prokurimit për blerjen e materialeve për sektorin e MZSH në Bashkinë Kolonjë;

Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 209,000 lekë pa TVSH; Procesverbali i llogaritjes së fondit limit është pa nr. prot., pa firmë dhe vulë të titullarit si dhe nuk administrohen ofertat e marra në treg, ku dhe është përcaktuar përlllogaritja e fondit limit;

-Urdhri nr. 425, datë 27.09.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit;

-Procesverbali nr. s'ka, datë 28.09.2021 për marrjen në dorëzim të mallrave;

-Fletë hyrja në magazinën e institucionit me nr. 46 datë 28.09.2021;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 235/2021, datë 28.09.2021, në vlerën e 222,000 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE “BCI” me ofertën më të ulët, në vlerën 170,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 21.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 22.09.2021 OE ‘BCI’ është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “BCI” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE ‘S.R i renditur i dyti me ofertën 185,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 24,000 lekë pa TVSh.

OE Fitues është njoftuar në datë 22.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit. Konkretisht në preventivin e mallrave të hartuar nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, nuk pasqyrohet informacioni se ku është referuar për përcaktimin e çmimit për njësi të mallrave;

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përlllogaritur fondin limit, pra komisioni nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokollin, si dhe nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokollin dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Nuk administrohet deklarata e garancisë së mallit të prokuruar;

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

- OE “S.R shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet oferta ekonomike e operatorit ekonomik shpallur fitues;

-Nuk administrohet deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk administrohet deklarata e OE shpallur fitues i cili duhet të marrë përsipër transportin e mallrave pranë magazinës së Bashkisë Kolonjë.

-Nuk administrohet vërtetimi mbi Gjendjen Gjyqësore që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk administrohet vërtetimi për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSSHE, për muajin gusht;

-Nuk administrohet kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje e vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar;

-Afati i dorëzimit të mallit nuk është përcaktuar nga AK;

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mban përgjegjësi komisioni i prokurimit;

11. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Riparim Sifoni në kanal in ujitës fshati Borovë viti 2021 në Bashkinë Kolonjë”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit;

-Urdhri nr. 39, datë 23.09.2021, i prokurimit për riparimin e Sifonit në kanal in ujitës fshati Borovë viti 2021 në Bashkinë Kolonjë.

Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 999,742 lekë pa TVSH;

-Urdhri nr. 452, me nr. 4923 prot., datë 12.10.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve;

-Procesverbali nr. s'ka, datë 12.10.2021 për marrjen në dorëzim të punimeve;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 289/2021, datë 12.10.2021, në vlerën e 1,110,000 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE “S.R” me ofertën më të ulët, në vlerën 925,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 74,742 lekë pa TVSh.

OE Fitues është njoftuar në datë 24.09.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Kolonjë përfaqësuar nga Kryetari E.I dhe Operatorit Ekonomik "S.R" Shpk është lidhur Kontratë Punimesh me nr. 10, nuk ka nr. prot., datë 30.09.2021 për “Riparim sifoni në kanal in ujitës fshati Borovë viti 2021 në Bashkinë Kolonjë” sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Kolonjë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Sipas ftesës për Ofertë nënshkrimi i kësaj kontrate duhet të realizohet brenda 24-orë nga shpallja e fituesit të tenderit, në të kundërt do të refuzohet dhe nuk do të shpallet fitues.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit. Administrrohet preventivi i punimeve e hartuar nga inxhinieri M.T, i cili është bazuar në VKM nr. 629 datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”;

-Nuk administrrohet urdhri i titullarit për caktimin e inxhinierit për të përllogaritur fondin limit, pra inxhinieri nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokoli, si dhe nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e punimeve që do të prokurohen;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokoli dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Nuk administrrohet deklarata e garancisë së punimeve të prokuruar;

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE “S.R shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrrohet vërtetimi mbi Gjendjen Gjyqësore që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk administrrohet deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk administrrohet vërtetimi për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSSHE për muajin gusht, dhe shtator;

-Nuk administrrohet kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje e vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar;

-Afati i nënshkrimit të kontratës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi nënshkrimi i kontratës është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 24.09.2021, pra nënshkrimi i kontratës duhej të realizohej brenda datës 25.09.2021, (meqenëse data 25 dhe 26.09.2021 ka qenë ditë pushimi)

kontrata duhet të nënshkruhej brenda datës 27.09.2021, ndërkohë është nënshkruar më datë 30.09.2021, pra 3 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për realizimin e nënshkrimit të kontratës, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mban përgjegjësi komisionit i prokurimit;

12. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Hartimi i planit të mbarështrimit të fondit pyjor dhe kullor pjesë të ekonomisë pyjore Orgockë (pjesa 2) për vitin 2021 në Bashkinë Kolonjë”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit;

-Urdhri nr. 43, datë 21.10.2021, i prokurimit për hartimin e planit të mbarështrimit të fondit pyjor dhe kullor pjesë të ekonomisë pyjore Orgockë (pjesa 2) për vitin 2021 në Bashkinë Kolonjë.

-Urdhri nr. 465, me nr. 5027 prot., datë 18.10.2021, për ngritjen e komisionit të përgatitjes së termave të referencave dhe përlllogaritjes së fondit limit. Është përlllogaritur fondi limit për hartimin e planit të mbarështrimit të fondit pyjor dhe kullor në vlerën 916,667 lekë pa TVSH;

-Urdhri nr. 554, me nr. 5941 prot., datë 09.12.2021, për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të planit të mbarështrimit të pjesës ekonomisë pyjore Orgockë”;

-Procesverbali nr. s’ka, me nr. 5943 prot., datë 09.12.2021 për marrjen në dorëzim të Projekt-Zbatimit;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 3/2021, datë 13.12.2021, në vlerën e 1,093,200 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE “B.B” me ofertën më të ulët, në vlerën 884,500 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 22.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 25.10.2021 OE ‘B.B është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE ‘B.B ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE ‘L & C i renditur i dyti me ofertën 911,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 5,667 lekë pa TVSh.

OE Fitues është njoftuar në datë 25.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Kolonjë përfaqësuar nga Kryetari E.I dhe Operatorit Ekonomik "L & C" Shpk është lidhur Kontratë Shërbime-Projektimi me nr. 15, me nr. 5319 prot., datë 01.11.2021 për “hartimin e planit të mbarështrimit të fondit pyjor dhe kullor pjesë të ekonomisë pyjore Orgockë (Pjesa 2) për vitin 2021 në Bashkinë Kolonjë” sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Kolonjë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit. Për përcaktimin e fondit limit komisioni është bazuar në VKM nr. 361 datë 12.5.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullor publik”;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokoll, si dhe nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e punimeve që do të prokurohen;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokoll dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

- OE “L & C shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet vërtetimi mbi Gjendjen Gjyqësore që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk administrohet deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk administrohet vërtetimi për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSSHE;

-Nuk administrohet deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;

-Nuk administrohet deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme;

-Nuk administrohet kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje e vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar;

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit.

- Nuk administrohet procesverbali i marrjes ne dorëzim të projekt zbatimit për hartimin e planit të mbarë-shtrimit të fondit pyjor kullor për vitin 2021;
- Nuk administrohet formulari i ofertës ekonomike e operatorit ekonomik shpallur fitues;
- Sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i prokurimit;

13. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje orendi dhe pajisje guzhine për çerdhen “Motrat Qirjazi” në Bashkinë Kolonjë”.

Përshkrimi i veprimeve;

- Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit;
- Urdhri nr. 44, datë 26.10.2021, i prokurimit për blerje orendi dhe pajisje guzhine për çerdhen Motrat Qirjazi në Bashkinë Kolonjë;

Fondi limit nuk është përcaktuar;

- Urdhri nr. 535, me nr. 5765 prot., datë 01.12.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim;

-Procesverbali nr. s'ka, datë 02.12.2021 për marrjen në dorëzim të mallrave;

-Fletë hyrja në magazinën e institucionit me nr. 210 datë 02.12.2021;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 127/2021, datë 02.12.2021, në vlerën e 537,600 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE “L.X” me ofertën më të ulët, në vlerën 387,500 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 27.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 01.11.2021 OE “L.X” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “L.X” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE ‘M.V i renditur i dyti me ofertën 399,860 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 01.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 03.11.2021 OE ‘M.V.’ ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE ‘M.M i renditur i treti me ofertën 422,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 03.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se OE ‘M.M ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “N.H” i renditur në vendin e katërt me ofertën 448,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 04.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit. Konkretisht në preventivin e mallrave të hartuar nga zj. M.V, nuk pasqyrohet informacioni se ku është referuar për përcaktimin e çmimit për njësi të mallrave;

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e zj. M.V për të përllogaritur fondin limit, pra nuk ka qenë e autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokoll;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokoll dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Nuk administrohet deklarata e garancisë së mallit të prokuruar;

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE “N.H i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Vërtetim mbi Gjendjen Gjyqësore;

-Mungon deklarata e OE shpallur fitues i cili duhet të marrë përsipër transportin e mallrave pranë magazinës së Bashkisë Kolonjë.

-Afati i dorëzimit të mallit nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi dorëzimi i mallit është përcaktuar të bëhet brenda afatit 24 - orë , duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 04.11.2021, pra malli duhej të dorëzohej brenda datës 05.11.2021, ndërkohë është dorëzuar më datë 02.12.2021, pra 28 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për dorëzimin e mallit, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.
Sa më sipër mbanë përgjegjësi komisionit i prokurimit;

14. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Zhbllokim të ujëlëshuesve fundorë në 5 Ujëmbledhësat Barmash, Starje, Gostivisht, Zharkanj, Radanj 2 për rritjen e sigurisë së digave, në Bashkinë Kolonjë”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit;
-Urdhri nr. 47, datë 03.11.2021, i prokurimit për zhbllokimin e ujëlëshuesve fundorë në 5 ujë-mbledhësat Barmash, Starje, Gostivisht, Zharkanj, Radanj 2 për rritjen e sigurisë së digave, në Bashkinë Kolonjë
Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 833,333 lekë pa TVSH;
-Urdhri nr. 506, me nr. 5446 prot., datë 10.11.2021, për ngritjen e komisionit për ndjekje dhe marrjen në dorëzim të punimeve;
-Procesverbali nr. s'ka, datë 24.11.2021 për marrjen në dorëzim të punimeve të mirëmbajtjes;
-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 13/2021, datë 24.11.2021, në vlerën e 946,800 lekë me TVSH;
-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE “S 2016” me ofertën më të ulët, në vlerën 789,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 44,333 lekë pa TVSh.

OE Fitues është njoftuar në datë 04.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Kolonjë përfaqësuar nga Kryetari E.I dhe Operatorit Ekonomik "S 2016" Shpk është lidhur Kontratë Punimesh me nr. 16, datë 08.11.2021 për “Zhbllokimin e ujëlëshuesve fundorë në 5 ujë-mbledhësat Barmash, Starje, Gostivisht, Zharkanj, Radanj 2 për rritjen e sigurisë së digave, në Bashkinë Kolonjë” sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Kolonjë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Nënshkrimi i kësaj kontrate duhet të realizohet brenda 24 - orëve nga shpallja e fituesit të tenderit, në të kundërt do të refuzohet dhe nuk do të shpallet fitues.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit. Konkretisht në preventivin e punimeve të hartuar nga inxhinieri M.T, i cili është bazuar në VKM nr. 629 datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”;
-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e inxhinierit për të përllogaritur fondin limit, pra inxhinieri nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;
-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokollin, si dhe nuk pasqyrohet volumi i punimeve që do të prokurohet;
-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokollin dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
-OE “S” shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:
-Mungon vërtetimi mbi Gjendjen Gjyqësore, në lidhje me veprimtarinë profesionale;
-Mungon deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;
-Mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSSHE për muajin tetor dhe nëntor;

-Mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve vendore (taksa dhe tarifa) të lëshuara nga njësia vendore ku ka selinë subjekti për vitin 2021. Në dosje administrohet vërtetimi nga njësia vendore për vitin 2020;

-Mungon kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje e vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar;

-Afati i nënshkrimit të kontratës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi nënshkrimi i kontratës është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 04.11.2021, pra nënshkrimi i kontratës duhej të realizohej brenda datës 05.11.2021, ndërkohë është nënshkruar më datë 08.11.2021, pra 3 ditë vonësë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për realizimin e nënshkrimit të kontratës, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i prokurimit;

15. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Riparim hidro-izolimi i tarracave në shkollat 9-vjeçare Barmash e Qinam në Bashkinë Kolonjë”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit;

-Urdhri nr. 49, datë 11.11.2021, i prokurimit për Riparim hidro-izolimi i tarracave në shkollat 9-vjeçare Barmash e Qinam në Bashkinë Kolonjë.

Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 799,800 lekë pa TVSH;

-Urdhri nr. 533, me nr. 5734 prot., datë 26.11.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim;

-Procesverbali nr. s'ka, datë 02.12.2021 për marrjen në dorëzim të mallrave;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 24/2021, datë 02.12.2021, në vlerën e 792,000 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE “A” dhe “E” me ofertën më të ulët, në vlerën 540,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 12.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 15.11.2021 OE “A” dhe OE “E.H” nuk janë paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur të s'kualifikoj OE “A.D dhe OE “E.H”;

AK ka vazhduar me OE ‘L.X i renditur i treti me ofertën 576,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 15.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 16.11.2021 OE ‘L.X është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE ‘L.X ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “L” i renditur në vendin e katërt me ofertën 589,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 16.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 17.11.2021 OE ‘L nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta s'kualifikoj OE ‘L;

AK ka vazhduar me OE “M.H” i renditur në vendin e pestë me ofertën 625,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 17.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 18.11.2021 OE “M.H ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE ‘B.B i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 633,600 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 18.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 23.11.2021 OE 'B.B' nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta s'kualifikoj OE 'B.B';

AK ka vazhduar me OE 'U' i renditur në vendin e shtatë me ofertën 660,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 139,800 lekë pa TVSh.

OE Fitues është njoftuar në datë 23.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Kolonjë përfaqësuar nga Kryetari E.I dhe Operatorit Ekonomik "U" Shpk është lidhur Kontratë Punimesh me nr. 20 me nr. 5736 prot., datë 26.11.2021 për "Riparim hidro-izolim i tarracave në shkollat 9-vjeçare Barmash e Qinam në Bashkinë Kolonjë për vitin 2021" sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Kolonjë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Nënshkrimi i kësaj kontrate duhet të realizohet brenda 24 - orëve nga shpallja e fituesit të tenderit, në të kundërt do të refuzohet dhe nuk do të shpallet fitues.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit. Konkretisht në preventivin e mallrave të hartuar nga inxhinieri M.T, nuk pasqyrohet informacioni se ku është referuar për përcaktimin e çmimit për njësi të mallrave;

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e inxhinierit për të përllogaritur fondin limit, pra inxhinieri nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokollin, si dhe nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokollin dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Nuk administrohet deklarata e garancisë së mallit të prokuruar;

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE "U shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Mungon vërtetim mbi Gjendjen Gjyqësore, që lidhet me aktivitetin profesional;

-Mungon deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Afati i nënshkrimit të kësaj kontrate nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të realizohet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 23.11.2021, pra nënshkrimi i kësaj kontrate duhej të realizohej brenda datës 24.11.2021, ndërkohë është nënshkruar më datë 26.11.2021, pra 2 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për nënshkrimin e kësaj kontrate, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i prokurimit;

16. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje materiale për shpenzime dekori (verë - dimër) për aktivitetet e vitit 2021".

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit;

-Urdhri nr. 60, datë 23.11.2021, i prokurimit për blerjen e materialeve për shpenzime dekori për aktivitetet e vitit 2021 në Bashkinë Kolonjë.

Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 416,244 lekë pa TVSH;

-Urdhri nr. 546, me nr. 5875 prot., datë 06.12.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim;

-Procesverbali nr. s'ka, datë 06.12.2021 për marrjen në dorëzim të mallrave;

-Fletë hyrja në magazinën e institucionit me nr. 42 datë 06.12.2021;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 42/2021, datë 06.12.2021, në vlerën e 476,400 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE "B" me ofertën më të ulët, në vlerën 388,800 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 25.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 26.11.2021 OE “ B” nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta s’kualifikoj OE ‘B’;

AK ka vazhduar me OE ‘E.A i renditur i dyti me ofertën 395,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 26.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 01.12.2021 OE ‘E.A është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE ‘E.A ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE ‘E.M i renditur i treti me ofertën 397,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 01.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit. Diferenca me fondin limit është 19,244 lekë pa TVSh.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përlogaritjen e fondit limit. Konkretisht në preventivin e mallrave të hartuar nga inxhinieri z. F.L, z. X.B dhe z. D.Z nuk pasqyrohet informacioni se ku është referuar për përcaktimin e çmimit për njësi të mallrave;

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përlogaritur fondin limit, pra komisioni i cili ka hartuar preventivin, nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokoli, si dhe nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokoli dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Nuk administrohet deklarata e garancisë së mallit të prokuruar;

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE ‘E.M’ shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Vërtetim mbi Gjendjen Gjyqësore;

-Vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;

-Vërtetim për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSSHE;

-Mungon kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softëer-ike në përdorim;

-Afati i dorëzimit të mallit nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi dorëzimi i mallit është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 01.12.2021, pra malli duhej të dorëzohej brenda datës 02.12.2021, ndërkohë është dorëzuar më datë 06.12.2021, pra 4 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për dorëzimin e mallit, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i prokurimit;

17. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Ndërtim Prita në Përrenjtë Starje dhe Mesiçkë viti 2021 në Bashkinë Kolonjë”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 17, me nr. 243 prot., datë 13.01.2021, për ngritjen e komisionit të prokurimit;

-Urdhri nr. 61, datë 24.11.2021, i prokurimit për ndërtimin e pritave dhe përrenjtë Starje dhe Mesiçkë viti 2021 në Bashkinë Kolonjë.

Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje, është në vlerën 499,985 lekë pa TVSH;

-Urdhri nr. 538, me nr. 5819 prot., datë 02.12.2021, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve;

-Procesverbali nr. s’ka, datë 13.12.2021 për marrjen në dorëzim të punimeve të mirëmbajtjes;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 10/2021, datë 13.12.2021, në vlerën e 539,076 lekë me TVSH;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ku është shpallur fituesi OE "A" me ofertën më të ulët, në vlerën 449,230 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 50,755 lekë pa TVSh.

OE Fitues është njoftuar në datë 25.11.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Kolonjë përfaqësuar nga Kryetari E.I dhe Operatorit Ekonomik "A" Shpk është lidhur Kontratë Punimesh me nr. 22, nr. 5794 prot., datë 01.12.2021 për "Ndërtim Prita në Përrenjtë Starje dhe Mesiçkë viti 2021, në Bashkinë Kolonjë" sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Kolonjë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Nënshkrimi i kësaj kontrate duhet të realizohet brenda 24 - orëve nga shpallja e fituesit të tenderit, në të kundërt do të refuzohet dhe nuk do të shpallet fitues.

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit. Konkretisht në preventivin e punimeve të hartuar nga inxhinieri M.T, është bazuar në VKM nr. 629 datë 15.07.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre";

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e inxhinierit për të përllogaritur fondin limit, pra inxhinieri nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokoli, si dhe nuk pasqyrohet volumi i punimeve që do të prokurohet;

-Ftesa për ofertë nuk ka nr., protokoli dhe datë.

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Nuk administrohet deklarata e garancisë së mallit të prokuruar;

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE "A shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Mungon vërtetimi mbi Gjendjen Gjyqësore, në lidhje me veprimtarinë profesionale;

-Mungon deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSSHE për muajin shtator, tetor dhe nëntor;

-Afati i nënshkrimit të kontratës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi nënshkrimi i kontratës është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 25.11.2021, pra nënshkrimi i kontratës duhej të realizohej brenda datës 26.11.2021, ndërkohë është nënshkruar më datë 01.12.2021, pra 5 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për realizimin e nënshkrimit të kontratës, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i prokurimit;

Zbatimi i punimeve.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatua si vijon:

1. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut" Bashkia Kolonjë, me këto të dhëna.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut" Bashkia Kolonjë .		
14.Lidhja e kontratës Nr. 2104 Prot., datë 08.06.2020 BOE "A " & "4" sh.p.k Objekti do të financohet nga AKUMIM	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 274,456,182.47 lekë me TVSH	16.Likuiduar: Sit. nr. 1 në vlerën 35,100,000 lekë me TVSH Sit. nr. 2 në vlerën 20,126,741 lekë me TVSH Sit. nr. 3 në vlerën 50,000,000 lekë me TVSH Sit. nr. 4 në vlerën 10,000,000 lekë me TVSH Sit. nr. 5 në vlerën 115,789,473.68 lekë me TVSH Sit. nr. 6 (përfundimtar) në vlerën 43,439,968 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar	18.Afati i kontratës në dite	19. Zgjatja e kontratës

-Vlera 274,456,182.47 lekë me TVSH.	Fillimi punimeve: 08.06.2020 Përfundimi punimeve: 07.06.2021	S'ka.
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "N" sh.p.k	Licenca MK.3101/7	Kontratë me nr. 2105 prot, datë 08.06.2020
21. Kolaudatori i punimeve -F (AKUM) -Z (AKUM) -M (Bash Kolonjë)	Licenca Nr: MK.3544 Licenca Nr: MK.0709/3 Licenca Nr: MK.2580/3	Shkresa nr. 1706 prot, datë 16.08.2021
22.Akt Kolaudimi Datë: 20.06.2022	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 25.06.2022 investimi është marrë në dorëzim përkohësisht nga Ndërmarrja Ujësjetellës Kanalizime Sh.A Kolonjë, përfaqësuar nga z. I.R në cilësinë e drejtorit.	

Titulli i Gjetjes: Diferenca në volume dhe punime të pa kryera në objektin "Rikonstruksion i rjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut".

Situata: Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve për objektin e mësipërm, rezultoi si vijon.

I. Kaptazhi dhe stacioni i burimit të Mullirit të Radanjit.

Zëri 22 (2.373) Vetrato xhami i temperuar brenda godinës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin prej 44.73 m² vetrato me xham të temperuar. Në dosjen teknike nuk provohet se ky xham është i temperuar me çertifikatë prodhimi ose shitje. Nga auditimi në fakt vërehet se ky zë pune është realizuar sipas zërit 2.375 me çmim 9,120 lekë dhe jo sipas zërit ofertues 2.373 me çmim 14,995 lekë.

Sa më sipër trajtuar, diferenca prej 5,875 (14,995 lekë – 9,120 lekë) për volumin 44.73 m² është përfituar tepër si zë pune i realizuar jo në përputhje me specifikimet teknike, në mënyrë të pa drejtë në vlerën **262,788 lekë** pa TVSH (44,73 m² x 5,875lekë) nga BOE "A " & "4" sh.p.k.

IX. Rezervuarët e ujit 2x500 m³, godina e dezinfektimit dhe sistemimi.

Zëri 14 (3.An/56) F. Montim shtyllë konike 9 ml, LED me dy krahë çdo 30 ml përfshirë të gjithë aksesorët e nevojshëm.

Situacioni përfundimtar pasqyron 6 copë shtylla me çmim 169,878.8 lekë.

Nga auditimi në fakt u konstatua se janë vendosur vetëm 2 (dy) shtylla konike, siç duket edhe në fotografi.

Sa më sipër, nga sipërmarrësi i punimeve BOE "A " & "4" sh.p.k, është librezuar dhe situacionuar 4 (katër) shtylla pa u vendosur fare, duke përfituar në mënyrë të pa drejtë në vlerën **679,515.2 lekë** pa TVSH (4 copë x 169,878.8 lekë).

X. Tubacione pjesë speciale për rezervuarin dhe sheshin + dhoma e dezinfektimit.

Zëri 23 (M 150) Ultrasonik Matës Uji Ø 150.

Situacioni përfundimtar pasqyron 2 (dy) copë "Ultrasonik Matës Uji Ø 150" me çmim 102,564 lekë. Nga auditimi në fakt u konstatua se ky zë punë nuk është realizuar fare, pra nuk janë vendosur matësit e ujit.

Sa më sipër, nga sipërmarrësi i punimeve BOE "A " & "4" sh.p.k, është librezuar dhe situacionuar 2 (dy) "Ultrasonik Matës Uji Ø 150" pa u vendosur fare, duke përfituar në mënyrë të pa drejtë në vlerën **205,127.58 lekë** pa TVSH (2 copë x 102,564 lekë).

XI. Tubacione pjesë speciale për rezervuarin dhe sheshin + dhoma e dezinfektimit.

Zëri 24 (M 200) Ultrasonik Matës Uji Ø 200.

Situacioni përfundimtar pasqyron 2 (dy) copë "Ultrasonik Matës Uji Ø 200" me çmim 136,196 lekë. Nga auditimi në fakt u konstatua se ky zë punë nuk është realizuar fare, pra nuk janë vendosur matësit e ujit.

Sa më sipër, nga sipërmarrësi i punimeve BOE "A " & "4" sh.p.k, është librezuar dhe situacionuar 2 (dy) "Ultrasonik Matës Uji Ø 200" pa u vendosur fare, duke përfituar në mënyrë të pa drejtë në vlerën **272,392.57 lekë** pa TVSH (2 copë x 136,196 lekë).

XII. Tubacione pjesë speciale për rezervuarin dhe sheshin + dhoma e dezinfektimit.

Zëri 28 (M 200) Ultrasonik Matës Uji Ø 150.

Situacioni përfundimtar pasqyron 2 (dy) copë "Ultrasonik Matës Uji Ø 150" me çmim 170,000 lekë. Nga auditimi në fakt u konstatua se ky zë punë nuk është realizuar fare, pra nuk janë vendosur matësit e ujit.

Sa më sipër, nga sipërmarrësi i punimeve BOE “A “ & “4” sh.p.k, është librezuar dhe situacionuar 2 (dy) “Ultrasonik Matës Uji Ø 150” pa u vendosur fare, duke përfituar në mënyrë të pa drejtë në vlerën **340,000 lekë** pa TVSH (2 copë x 170,000 lekë).

XIII. Dhoma e Dezinsektimit.

Zëri A5.12 (2.404) Lyrje muri jashtë.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 102.16 m² lyrje me çmim 173 lekë.

Nga auditimi në fakt u konstatua se ky zë punë nuk është realizuar fare.

Sa më sipër, nga mos realizimi i këtij zëri pune, sipërmarrësi i punimeve BOE “A “ & “4” sh.p.k, ka përfituar në mënyrë të pa drejtë në vlerën **17,674 lekë** pa TVSH (102.16 x 173 lekë).

XIV. A-Instalimet elektromekanike në stacionin e pompave.

Vendosje e pajisjeve elektromekanike

Zëri 6 (An-66) Sistemi i matjes të prurjeve të ujit në distancë në stacionin e pompave dhe depon grumbulluese si dhe komandim në distancë i el/pompave që përbëhet nga: Kompjuter, program SCADA + program komunikimi + konfigurimi të pajisjeve elektronike, ruter, pajisje elektronike memorizuese, kontrolluese me burim të pamvarur ushqimi me modul komunikimi për kartën SIM për rrjetin GSM/GPRS, abonim një vjeçar për shërbimin GSM.

Nga auditimi në fakt u konstatua se ky zë punë nuk është realizuar fare, pra nuk janë vendosur pajisjet sipas zërit “Sistemi i matjes të prurjeve të ujit në distancë në stacionin e pompave dhe depon grumbulluese si dhe komandim në distancë i el/pompave që përbëhet nga: Kompjuter, program SCADA + program komunikimi + konfigurimi të pajisjeve elektronike, ruter, pajisje elektronike memorizuese, kontrolluese me burim të pamvarur ushqimi me modul komunikimi për kartën SIM për rrjetin GSM/GPRS, abonim një vjeçar për shërbimin GSM”.

Sa më sipër, nga sipërmarrësi i punimeve BOE “A “ & “4” sh.p.k, është librezuar dhe situacionuar zëri i punimeve pa u realizuar fare, duke përfituar në mënyrë të pa drejtë në vlerën **214,102 lekë** pa TVSH (1 x 214,102 lekë).

XV. B. Makineri dhe Pajisje. Stacioni i pompave Bistrovicë.

Zëri 7 (An-66) “Sistemi i matjes të prurjeve të ujit në distancë në stacionin e pompave dhe depon grumbulluese si dhe komandim në distancë i el/pompave që përbëhet nga: Kompjuter, program SCADA + program komunikimi + konfigurimi të pajisjeve elektronike, ruter, pajisje elektronike memorizuese, kontrolluese me burim të pamvarur ushqimi me modul komunikimi për kartën SIM për rrjetin GSM/GPRS, abonim një vjeçar për shërbimin GSM”.

Nga auditimi në fakt u konstatua se ky zë punë nuk është realizuar fare, pra nuk janë vendosur pajisjet sipas zërit “Sistemi i matjes të prurjeve të ujit në distancë në stacionin e pompave dhe depon grumbulluese si dhe komandim në distancë i el/pompave që përbëhet nga: Kompjuter, program SCADA + program komunikimi + konfigurimi të pajisjeve elektronike, ruter, pajisje elektronike memorizuese, kontrolluese me burim të pamvarur ushqimi me modul komunikimi për kartën SIM për rrjetin GSM/GPRS, abonim një vjeçar për shërbimin GSM”.

Sa më sipër, nga sipërmarrësi i punimeve BOE “A “ & “4” sh.p.k, është librezuar dhe situacionuar ky zë pune pa u realizuar fare, duke përfituar në mënyrë të pa drejtë në vlerën **2,819,934 lekë** pa TVSH (1 komplet x 2,819,93402 lekë).

XVI. 5. Instalime mekanike DN32/PN20 ana e dërgimit të pompave vertikale.

Zëri 7 (An-77) F.V. Matës uji elektromagnetik 4-20 mA.

Situacioni përfundimtar pasqyron 1 (një) copë “Matës uji elektromagnetik 4-20 mA” me çmim 382,058 lekë.

Nga auditimi në fakt u konstatua se ky zë punë nuk është realizuar fare, pra nuk është vendosur fare “Matës uji elektromagnetik 4-20 mA” në anën e dërgimit të pompave vertikale.

Sa më sipër, nga sipërmarrësi i punimeve BOE “A “ & “4” sh.p.k, është librezuar dhe situacionuar ky zë pune pa u vendosur fare, duke përfituar në mënyrë të pa drejtë në vlerën **382,058 lekë** pa TVSH (1 copë x 382,058 lekë).

XVII. 6. Furnizim vendosje e sistemit të ndriçimit dhe prozave.

Zëri 16 (An-224) F.V. Sistem video citofoni dhe komandimi hyrje-mbyllje të portës metalike të stacionit të pompave.

Situacioni përfundimtar pasqyron 1 (një) komplet “Sistem video citofoni” me çmim 139,658 lekë.

Nga auditimi në fakt u konstatua se ky zë punë nuk është realizuar fare, pra nuk është vendosur fare “Sistem video citofoni” te stacioni i pompave.

Sa më sipër, nga sipërmarrësi i punimeve BOE “A “ & “4” sh.p.k, është librezuar dhe situacionuar ky zë pune pa u vendosur fare, duke përfutur në mënyrë të pa drejtë në vlerën **139,658 lekë** pa TVSH (1 copë x 139,658 lekë).

Kriteri: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2105 prot., datë 16.08.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 809 prot., datë 29.03.2021.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrim në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, volume pune të pa kryera dhe jo të rakorduara saktë.

Shkaku: Pasqyrim jo i saktë në librezën e masave nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **942,303.20 lekë pa TVSH** nga shoqëria BOE “A “ & “4-A-M” SHPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 2104 Prot., datë 08.06.2020 me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” Bashkia Kolonjë .

Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe grupin e kolaudimit të punimeve si dhe Ndërmarrjen e Ujësjetllës Kanalizime Sh.A Kolonjë në cilësinë e administrimit të investimit, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pa vendosura në objekt.

Dalja e përgjegjësive, realizimi i zërave të punimeve sipas PZ dhe ST në shumën **4,390,946.15 lekë**, të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kolonjë, Ndërmarrja e Ujësjetllës Kanalizimeve Sh.A Kolonjë, Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Grupi i Kolaudimit të punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë me datë 25.04.2024. Në rast të kundërt, mosvendosja e pajisjeve dhe vënja në funksion e scadës, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.

Titulli i Gjetjes: Zbatimi i punimeve të ndërtimit të objektit: “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” Bashkia Kolonjë, pa leje ndërtimi infrastrukturore.

Situata: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” u konstatua se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë, nuk ka miratuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore për projektin e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me Nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK Bashkisë Kolonjë.

Kriteri: Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;

-VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Realizimi i projektit të zbatimit pa leje ndërtimi infrastrukturore dhe gjithashtu procedura e prokurimit është zhvilluar pa disponimin e saj.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Kolonjë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa që të pajisin me Leje Ndërtimi Infrastrukturore për çdo projekt zbatimi sipas legjislacionit në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1.Z. E.I në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë.

2.Z. V.B, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

3.Z. F.SH, Inxh. Hidroteknik përfaqësues i AKUM, Tiranë me Licencë MK. 3544, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

4.Z. Z.I, Inxh. Hidroteknik përfaqësues i AKUM, Tiranë me Licencë MK. 0709/3, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

5.Z. M.T, Inxh. Ndërtimi, përfaqësues i AK, me Licencë MK. 2580/3, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

2. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt “**Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë**”, me këto të dhëna.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë” Bashkia Kolonjë .		
14.Lidhja e kontratës Nr. 5808 Prot., datë 07.12.2020 BOE “K “ & “A ” sh.p.k	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 75,131,311 lekë me TVSH	16.Likuiduar: Sit. nr. 1 në vlerën 21,000,000 lekë me TVSH Sit. nr. 2 në vlerën 24,365,291.1 lekë me TVSH Sit. nr. 3 (përfundimtar) në vlerën 29,766,020 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera 75,131,311 lekë me TVSH.	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 07.12.2020 Përfundimi punimeve: 04.10.2021	19. Zgjatja e kontratës S’ka.
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “M” sh.p.k & “E” sh.p.k.	Licenca MK.1811/7 (M)	Kontratë me nr. 5809 prot, datë 07.12.2020
21. Kolaudatori i punimeve BOE “4” sh.p.k & “N” sh.p.k, përfaqësuar nga “4” sh.p.k	Licenca Nr: MK.3572 (4)	Shkresa nr. 2353 prot, datë 17.05.2021
22.Akt Kolaudimi Datë: 13.10.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 25.10.2021 investimi është marrë në dorëzim përkohësisht Komisioni përbëhet nga: M.T, S.V dhe E.C.	

Titulli i Gjetjes: Diferenca në volume në punime ndërtimi në objektin “Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë”.

Situata: Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve për objektin e mësipërm, rezultoi si vijon.

I. PUNIME NË SEKSIONIN E KANALIT NGA PIKETA 1 DERI 4

II. Punime meremetimi i plotë i kanalit (Piketa 1-1/4, 1/4 -2) l=231 ml

Zëri 7 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujitës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 180 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë.

Libreza e masave pasqyron 180 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 180 m² shtresë zhavorri është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **41,580 lekë pa TVSH** [180 m² x 231 lekë].

VI. Punime meremetimi i plotë i kanalit (Piketa 3-3/28, 3/28-4) l=634 ml

Zëri 7 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujitës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 1080 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë.

Libreza e masave pasqyron 1080 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 1080 m² shtresë zhavorri është

librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **249,480 lekë pa TVSH** [1080 m² x 231 lekë].

2. PUNIME NË SEKSIONIN E KANALIT NGA PIKETA 4 DERI 9

VII. Punime meremetimi i plotë i kanalit (Piketa 4-5) l=292 ml

Zëri 5 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujitës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 175 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 175 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 175 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **40,425 lekë pa TVSH** [175 m² x 231 lekë].

XI. Punime meremetimi i plotë i kanalit (Piketa 7-8) l=1000 ml

Zëri 5 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujitës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 1700 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 1700 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 1700 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **392,700 lekë pa TVSH** [1700 m² x 231 lekë].

3. PUNIME NË SEKSIONIN E KANALIT NGA PIKETA 9 DERI 18

Zëri 6 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujitës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 162 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 162 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 162 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **37,422 lekë pa TVSH** [162 m² x 231 lekë].

XI. Punime meremetimi i plotë i kanalit (Piketa 9/6-10) l=137 ml

Zëri 7 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujitës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 233 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 233 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 233 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **53,823 lekë pa TVSH** [233 m² x 231 lekë].

XII. Punime meremetimi i plotë i kanalit (Piketa 10/1-11) l=277 ml

Zëri 7 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujitës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 471 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 471 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 471 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **108,801 lekë pa TVSH** [471 m² x 231 lekë].

XIII. Punime meremetimi i plotë i kanalit (Piketa 11/1-12) l=155 ml

Zëri 7 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujitës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 264 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 264 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 264 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **60,984 lekë pa TVSH** [264 m² x 231 lekë].

4. PUNIME NË SEKSIONIN E KANALIT NGA PIKETA 18 DERI 38

XIII. Punime meremetimi i pjesshëm i kanalit (Piketa 33/1-38) l=155 ml

Zëri 5 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujitës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 200 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 200 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 200 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **46,200 lekë pa TVSH** [200 m² x 231 lekë].

1. PUNIME NË SEKSIONIN E KANALIT NGA PIKETA 43 DERI 44

XV. Punime meremetimi i pjesshëm i kanalit (Piketa 38-51) l=970 ml

Zëri 5 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujëtës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 485 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 485 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 485 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **112,035 lekë pa TVSH** [485 m² x 231 lekë].

VII. Punime meremetimi i pjesshëm i kanalit (Piketa 56-56/9) l=92 ml

Zëri 5 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujëtës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 156 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 156 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 156 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **36,036 lekë pa TVSH** [156 m² x 231 lekë].

IX. Punime meremetimi i pjesshëm i kanalit (Piketa 56/9-57) l=40 ml

Zëri 5 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujëtës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 68 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 68 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 68 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **15,708 lekë pa TVSH** [68 m² x 231 lekë].

X. Punime meremetimi i pjesshëm i kanalit (Piketa 58-59) l=15 ml

Zëri 6 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujëtës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 26 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 26 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 26 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **6,006 lekë pa TVSH** [26 m² x 231 lekë].

XI. Punime meremetimi i pjesshëm i kanalit (Piketa 61-61/9) l=135 ml

Zëri 6 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujëtës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 230 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 230 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 230 m² shtresë zhavorr është librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **53,130 lekë pa TVSH** [230 m² x 231 lekë].

XII. Punime meremetimi i pjesshëm i kanalit (Piketa 61/9-62) l=195 ml

Zëri 6 (3.183/a) Shtresë zhavorri nën shtresë betoni të kanalit ujëtës.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 332 m² shtresë zhavorri me çmim 231 lekë. Libreza e masave pasqyron 332 m² shtresë zhavorri argumentuar në mënyrë analitike.

Në fakt nga auditimi në objekt por edhe i dokumentacionit mbështetës si foto, etj, rezultoi se ky zë punimi nuk është realizuar fare. Prandaj volumi prej 332 m² shtresë zhavorr është

librezuar dhe situacionuar tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga BOE “K” SH.P.K & “A.I.G.C” SH.P.K, në shumën **76,692 lekë pa TVSH** [332 m² x 231 lekë].

Kriteri: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin e KM Nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Udhëzimin e KM Nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5808 prot., datë 07.12.2020.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5809 prot., datë 07.12.2020.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, janë librezuar dhe situacionuar volume pune të pa kryera .

Shkaku: Pasqyrim jo i saktë në librezën e masave nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, ku rezultuan punime të pakryera.

Dalja e përgjegjësive, mbi kryerjen e zërit “*Gërmim dheu me krahë bankinë kanal*” sipas PZ dhe ST në shumën **1,264,272 lekë**, të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kolonjë, sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve si dhe kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë me datë 25.10.2023. Në rast të kundërt, diferenca në sasi dhe në vlerë do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

Titulli i Gjetjes: Zbatim i punimeve të ndërtimit të objektit: “Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë” pa leje ndërtimi.

Situata: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve të kontratës me objekt: “Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë” u konstatua se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë, nuk ka miratuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore për projektin e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me Nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK Bashkisë Kolonjë.

Kriteri: Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar;

-VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Realizimi i projektit të zbatimit pa leje ndërtimi infrastrukturore dhe gjithashtu procedura e prokurimit është zhvilluar pa disponimin e saj.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Kolonjë.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa që të pajisin me Leje Ndërtimi Infrastrukturore për çdo projekt zbatimi sipas legjislacionit në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z. E.I,** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë.

2. **Z. T.S** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

3. **Z. F.P,** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

3. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës” Bashkia Kolonjë, me këto të dhëna.

1. Zbatimi i Kontratës së Punimeve me objekt: “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës”, Bashkia Kolonjë, Viti 2021				
14.Lidhja e kontratës Nr. 1022 prot., datë 25.02.2021	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 391,298 lekë. OE fitues: “A” SHPK		16.Likuiduar ----- Në aneksin e aktit	
17- Situacioni Përfundimtar Në aneksin e aktit	18.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 12 muaj. 25.02.2021-25.02.2022 Fillim i punimeve: 27.05.2021 Përfundim i punimeve : 23.05.2022		19. Zgjatja e kontratës Amendimi 904 prot., datë 23.02.2022, 3 (tre) muaj	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “A” SHPK	Licenca Nr: MK. 1476/12 Dt.18.06.2021	Kontrata nr. 1021 prot., datë 25.02.2021	Vlera (me TVSH) e kontratës: 3,942,675 lekë	Likuiduar:
21. Kolaudatori i punimeve: BOE “4”	Licenca Nr: MK.3572/2 Dt 04.10.2022	Kontrata nr. 4730 prot., datë 03.10.2022	Vlera (me TVSH) e kontratës: 591,401 lekë	Likuiduar:
22.Akt Kolaudimi: datë 12.10.2022	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 14.10.2022			

Titulli i Gjetjes: Diferenca në volume punime dhe, zëra pune të pa kryera në objektin “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës”.

Situata: Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit bazë dhe rishikuar; preventivit bazë dhe të rishikuar; preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit për punë civile, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e ndryshuar për disa zëra pune (Shtresë zhavori 10 cm; Struktura të monolite b/a C25/30 t=40cm (bazament e mur b/arme); Shkallë, inoks, gjatësia 3350 mm, gjerësia 330mm), në vlerën **1,323,023 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon, mbas shqyrtimit të observacionit, dhe konkretisht:

Tabela nr. 2.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni pjesor/përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +/- (Volum/lekë)	
3	Punime për rrethim depot 75 m³ Helmes;							
38	Shtresë zhavori 10 cm	m ³	1,355	1.66	1.66	-	1.66	2.244
39	Struktura të monolite b/a C25/30 t=40cm (bazament e mur b/arme)	m ³	14,851	5.75	5.75		5.75	85,393
	1 Depo							87,637
	2 Depo							
4	Punime për rrethim depo 75 m³ Kreshova; Stajre 2 depo; Bejkovë; Gostivisht							
38	Shtresë zhavori 10 cm	m ³	1,355	1.62	1.62	-	1.62	2,195
39	Struktura të monolite b/a C25/30 t=40cm (bazament e mur b/arme)	m ³	14,851	5.63	5.63	-	5.63	83,537
	1 Depo							85,732
	5 Depo							428,660
4	Punime për rrethim depo 75 m³ Psar							
38	Shtresë zhavorri 10 cm	m ³	1,355	1.55	1.55	-	1.55	2.098
39	Struktura të monolite b/a C25/30 t=40cm (bazament e mur b/arme)	m ³	14,851	5.38	5.38	-	5.38	79,824
								81,992
4	Punime për rrethim depo 75 m³ Qafzes 1							
38	Shtresë zhavori 10 cm	m ³	1,355	1.73	1.73	-	1.73	2,341
39	Struktura të monolite b/a C25/30 t=40cm (bazament e mur b/arme)	m ³	14,851	6	6	-	6	89,106
								91,447
4	Punime për rrethim depo 75 m³ Qafzes 2							
38	Shtresë zhavori 10 cm	m ³	1,355	2.05	2.05	-	2.05	2,780
39	Struktura të monolite b/a C25/30 t=40cm (bazament e mur b/arme)	m ³	14,851	7.13	7.13	-	7.13	105,813
								108,593
4	Punime për rrethim depo 75 m³ Rehovë							
38	Shtresë zhavori 10 cm	m ³	1,355	1.58	1.58	-	1.58	2,146
39	Struktura të monolite b/a C25/30 t=40cm (bazament e mur b/arme)	m ³	14,851	5.50	5.50	-	5.50	81,681
								83,827
4	Punime për rrethim depo 75 m³ Selenicë							
38	Shtresë zhavori 10 cm	m ³	1,355	2.05	2.05	-	2.05	2,829

39	Struktura të monolite b/a C25/30 t=40cm (bazament e mur b/arme)	m ³	14,851	7.25	7.25	-	7.25	107,670
								110,499
4	Punime për rrethim depo 75 m Vodicë							
38	Shtresë zhavori 10 cm	m ³	1,355	1.55	1.55	-	1.55	2,098
39	Struktura të monolite b/a C25/30 t=40cm (bazament e mur b/arme)	m ³	14,851	5.38	5.38	-	5.38	79,824
								81,922
	SHUMA në lekë pa TVSH							1,074,577

Burimi: Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela nr. 3.

Nr	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacioni pjesor/për fundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +/- (Volum/lekë)	
	Punimet për rrethim e Depove							
7.	Mollas (Rikonstruksion)							
	Punime ndërtimi							
6	Shkallë, inoks, gjatësia 3350mm, gjerësia 330mm, me ndimës nën	m	5,000	9.70	9.70	-	9.70	48,500
	SHUMA në lekë paTVSH						48,500	

Burimi: Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela nr. 4.

Nr	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacioni pjesor/për undimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +/- (Volum/lekë)	
	Punimet për rrethim e Depove							
7.	Mollas (Rikonstruksion)							
	Punime ndërtimi							
	Shtresë zhavori 10 cm	m ³	1,355	2.34	2.34		2.34	3,171
19	Struktura monolite b/a C25/30 t=40cm (bazament e b/arme)	m ³	14,851	8.13	8.13	-	8.13	120,664
	SHUMA në lekë paTVSH						123,835	

Burimi: Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela nr. 5.

Nr	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacioni pjesor/për fundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +/- (Volum/lekë)	
	Punimet ndërtimi në Depo 100 m³ Qinam							
-	Punimerrethimi							
-	Struktura monolite b/a C25/30 t=40cm (bazament e b/arme)	m ³	14,851	5.13	5.13	-	5.13	76,111
	SHUMA në lekë paTVSH						76,111	

Burimi: Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Kriteri: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

-Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1022 prot., datë 25.02.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1021 prot., datë 25.02.2021.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 4730 prot., datë 03.10.2022.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrim në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, punime të pakryera në volumet e situacionuara.

Shkaku: Kryerje punime ndërtimi, jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës së sipërmarrjes.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **1,323,023 lekë pa TVSH** nga

shoqëria OE "A" SHPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 1022 Prot., datë 25.02.2021 me objekt "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës" Bashkia Kolonjë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: 1. Z. E.I, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë; 2. Znj. E.C, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, 3. Z. N.G, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

4. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt "Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit", me këto të dhëna.

1. Zbatimi i Kontratës së Punimeve me objekt: "Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit", Bashkia Kolonjë, Viti 2021				
14. Lidhja e kontratës Nr. 5151 prot., datë 29.10.2020	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 497,280,095 lekë. OE fitues: "A" SHPK		16. Likuiduar ----- Në aneksin e aktit	
17- Situacioni Përfundimtar 497,079,737,90	18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 24 muaj. Fillim i punimeve: 09.11.2020 Përfundim i punimeve: 04.10.2021		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka zgjatje të afatit	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "A" SHPK	Licenca Nr: MK. 1476/12 Dt. 18.06.2021	Kontrata nr. 5374 prot., datë 06.11.2020	Vlera (me TVSH) e kontratës: 3,778,102 lekë	Likuiduar:
21. Kolaudatori i punimeve: BOE "4" & "N" SHPK	Licenca Nr: MK. 3572/2 Dt 04.10.2022	Kontrata nr. 2352 prot., datë 17.05.2021	Vlera (me TVSH) e kontratës: 645,109 lekë	Likuiduar:
22. Akt Kolaudimi: datë 21.01.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim dt. 27.01.2022			

Titulli i Gjetjes: Diferenca në volume në punime ndërtimi në objektin "Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit".

Situata: Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit bazë dhe rishikuar; preventivit bazë dhe të rishikuar; preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit për punë civile, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt (Zërat: "Hedhje rrafshim ngjeshje dheu" dhe "Gërmim dheu me krah kat. IV"), mbas shqyrtimit të observacioneve, rezultojnë diferenca në volume pune gërmim, në vlerën **290,800 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni pjesor	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +/-	
							Vol.	Vlera
	1. Linja e ujësjellësit							
2	Rrjeti kryesor							
	Hedhje rrafshim ngjeshje dheu	m ³	250	25,540	25,540	24,820	720	180,000
	Gërmim dheu me krah kat. IV	m ³	1,385	3,700	3,700	3,620	80	110,800
	SHUMA (në lekë pa TVSH)							290,800

Burimi: Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sa më sipër, diferenca prej 720 m³ për zërin: "Hedhje rrafshim ngjeshje dheu" dhe diferenca prej 80 m³ gërmim dheu, janë përfituar tepër nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **290,800 lekë pa TVSH**.

Kriteri: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplininimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.

Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5151 prot., datë 29.10.2020.

Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5374 prot., datë 06.11.2020.

Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 2352 prot., datë 17.05.2021.

Ndikimi/Efekt: Pasqyrim në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, punime të pakryera në volumet e situacionuara.

Shkaku: Kryerje punime ndërtimi, jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës së sipërmarrjes.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **290,800 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE “A.N.K” SHPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 5151 Prot., datë 29.10.2020 me objekt “Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit” Bashkia Kolonjë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: 1. Z. E.I, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë; 2. Znj. E.C, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, 3. Z. N.G, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

III.2.5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Për auditimin e pikës 5 “Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, u shqyrtua:

-Dokumentacioni mbi lejet e ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerje punimesh dhe certifikatat e përdorimit për subjektet përfutues të lejeve të ndërtimit për periudhën 01.07.2021-31.12.2021;

-Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;

-VKM nr.408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar;

-Paketa fiskale për vitin 2021 mbi shkallën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja.

Planifikimi i territorit.

Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) për territorin administrativ të Bashkisë Kolonjë ka nisur procesin e hartimit në kuadër të prokurimit të shërbimit të konsulencës nga ish Ministria e Zhvillimit Urban për Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 Bashki në Shqipëri, “Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për bashkitë...”, dhe është miratuar me Vendim Këshilli Bashkiak Nr. 29, datë 23.04.2019 dhe më pas është miratuar në KKT me Vendimin nr.2 , datë 17.05.2019.

Përjashtim nga kompetencat për të shqyrtuar kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi nga Bashkia Kolonjë bëjnë zonat me rëndësi kombëtare.

Në Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, neni 3, pika 15 - **kushtet zhvillimore janë kushtet e përcaktuara nga plani i detajuar vendor ose, në mungesë, nga plani i përgjithshëm vendor dhe, në mungesë të të dyjave, të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës i planifikimit që shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit të domosdoshëm për pajisjen me leje ndërtimi.**

Neni 29 Përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë

Kryetari i bashkisë është përgjegjës për: a) vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë; b) vlerësimin e respektimit të kërkesave ligjore për punimet e kryera mbi bazën e deklaratës paraprake për kryerje punimesh; c) dhënien e certifikatës së përdorimit, sipas nenit 42 të këtij ligji, për lejet e ndërtimit të miratuara prej tij.

Kontrolli dhe zhvillimi i territorit.

Bashkia Kolonjë, për periudhën 01.07.2021 deri në 31.12.2021, ka pasur 15 aplikime në sistem për leje zhvillimi, leje ndërtimi etj, përkatësisht:

-5 aplikime për leje zhvillimi (refuzuar);

-0 për leje ndërtimi me sipërfaqe mbi 250 m²;

-1 aplikim për leje ndërtimi me sipërfaqe deri 250 m² (miratuar);

-9 deklaratat paraprake për kryerje punimesh (miratuar);

-Nga 9 deklaratave paraprake për kryerje punimesh, u konstatuan mangësi në 3 prej tyre, si dhe në 1 leje ndërtimi të dhënë përgjatë periudhës 01.07.2021-31.12.2021.

Titulli i gjetjes: Mosrespektimi i kuadrit rregullator të fushës në miratimin e lejeve të ndërtimit, deklaratave paraprake për kryerje punimesh.

Situata: Bashkia Kolonjë në rolin e autoritetit vendor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës dhe atë sektorial, në miratimin e aplikimeve për deklaratave paraprake për kryerje punimesh, si dhe të lejeve të ndërtimit, ku sipas rastit është konstatuar tejkalim i kompetencave ligjore dhe devijim nga kuadri rregullator i fushës.

Nga auditimi i procedurave të ndjekuara nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kolonjë, u konstatua se në:

-3 raste subjektet janë pajisur me deklaratë paraprake për kryerje punimesh, ndërkohë që kanë qenë në kushtet e kryerjes së punimeve që kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe jo deklaratë paraprake për kryerje punimesh.

-1 rast është miratuar leja e ndërtimit në kushtet e mungesës së dokumentacionit të plotë në formë dhe përmbajtje, si dhe në kundërshtim me tipologjinë e ndërtimit që lejohet në njësinë strukturore përkatëse.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. G.E në rolin e nëpunësit në sistemin e-leje, z. E.C, në rolin e kontrolluesit, z. M.T, në rolin e drejtuesit, dhe z. E.I, Kryetari i Bashkisë Kolonjë, miratues.

Kriteri: Shkronjën “a” dhe “b” të nenit 29, nenin 41, pikën 1 të nenit 44 në Ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; Pikën 3 dhe 3/1 në nenin 3, shkronjën “g” në pikën 1 në nenin 9, nenin 11, pikën 3 në nenin 14, pikat 2 dhe 4 në nenin 15 dhe shkronjën “rr” në pikën 1 në nenin 19 të VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar; Pikën 6 në Vendimin nr.12, datë 27.02.2019 të KKT; Pikën 1 në nenin 16 në Ligjin nr.9426, datë 06.10.2005 “Për blegtorinë”, i ndryshuar; Pikën 4 të nenit 14 të Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; VKM nr. 550, datë 15.7.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”.

Ndikimi/Efekti: Cenimi i qëllimeve të kuadrit rregullator për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të munguar në lejen e ndërtimit të miratuar përgjatë vitit 2021, si dhe bashkërendimin e punës, vlerësimin dhe marrjen në konsideratë të mendimeve të autoriteteve publike kompetente gjatë aplikimit deri në miratimin e lejes së ndërtimit/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve.

Më hollësisht praktikat trajtuar si më poshtë vijon:

1. Deklaratë paraprake miratuar me vendimin nr.43, datë 11/08/2021 për subjektin E.R, projektuar punimet nga M.G me licencë nr. A.1568/1. Dokumentacioni i dorëzuar:

Aplikimi për deklaratë paraprake; Foto të objektit në gjëndjen ekzistuese; Dokumenti i pronësisë; Projekti teknik; Licenca e projektuesit; Prokurë përfaqësimi për aplikim dhe kryerje veprimesh në sistemin e-lejet; Deklarata e projektuesit; Mandat pagesa e tarifës administrative të aplikimit; Relacioni arkitektonik etj.

Konstatohet se:

- Sipas informacionit të pasqyruar në aplikimin për deklaratë paraprake, rezulton se projekti është bërë nga subjekti juridik "G" Sh.P.K dhe në këto kushte duhej të dorëzohej licenca e subjektit në fushën e projektimit. Në vijim të këtij argumenti, konstatohet se edhe deklarata e përgjegjësisë profesionale, duhet të lëshohet nga subjekti "G" Sh.P.K, pjesë e të cilës në drejtuesit teknik duhet të jetë edhe projektuesja e projektit të punimeve zj.M.G;

- Në prokurën e përfaqësimit të zj.M.G, ka firmosur vetëm zj.E.R, jo edhe pronari tjetër A.R, të cilët sipas dokumentit të pronësisë janë pronarë përkatësisht në masën ½ të pasurisë së mësipërme, në të cilat do të kryhen punimet përkatëse. Gjithashtu në vijim të sa më sipër, nuk administrohet prokura ku A.R autorizon E.R, për kryerjen e veprimeve për pasurinë e mësipërme;

- Nga verifikimi i dokumentacionit të pronësisë, konkretisht krahasimit të planimetrisë së katit përdhe dhe planimetrisë ekzistuese me planimetrinë e re të katit përdhe të pasqyruar në projektin teknik të punimeve (pasqyruar me foto), konstatohet se faqja e murit në drejtimin veri-lindje në planimetrinë e katit përdhe (gjendja ekzistuese) ndryshon këndin e pjerësisë me planimetrinë e re të katit përdhe, ç'ka tregon se, veç punimeve të mirëmbajtjes së zakonshme, kemi punime rikonstruksioni me ndryshim të formës, ndryshim të vëllimit ndërtimor, punime që prekin muret mbajtës të lidhur me themelin e objektit dhe në këto kushte subjekti duhet të pajiset me leje ndërtimi dhe jo deklaratë paraprake për kryerje punimesh.

-Sa më sipër subjekti ndodhet në kushtet, ku duhet të pajiset me leje ndërtimi dhe jo deklaratë paraprake për kryerje punimesh, të cilat sjellin edhe mungesën e aplikimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë²⁸.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën "b" të nenit 29, nenin 41 në Ligjin nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; Nenin 11 të VKM nr.408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. G.E në rolin e nëpunësit në sistemin e-leje, z. E.C, në rolin e kontrolluesit, z. M.T, në rolin e drejtuesit, dhe z. E.I, Kryetari i Bashkisë Kolonjë, miratues.

2. Deklaratë paraprake miratuar me vendimin nr.36, datë 12/07/2021 për subjektin "O" Sh.P.K, projektuar punimet nga subjekti juridik "M" Sh.P.K me licencë nr.6974, përfaqësuar nga administrator, drejtues teknik, i subjektit të mësipërm zj. K.T, me licencë profesionale nr. A.2006/3. Dokumentacioni i dorëzuar:

Aplikimi për deklaratë paraprake; Foto të objektit në gjëndjen ekzistuese; Dokumenti i pronësisë; Projekti teknik; Licenca e projektuesit dhe subjektit; Deklarata e projektuesit; Mandat pagesa e tarifës administrative të aplikimit; Relacioni teknik etj.

Konstatohet se:

- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, konkretisht objektit të punimeve për të cilin është bërë aplikimi, foto të objektit në gjëndjen ekzistuese, grafikut dhe preventivit të punimeve, kemi të bëjmë me punime rikonstruksioni, të cilat ndryshojnë formën e objektit dhe vëllimin e ndërtimit. Sipas projektit teknik, do të bëhen punime të prishjes së ndërtimeve ekzistuese dhe krijimi i ndërtimeve të reja, themele konstruksioni dhe hapje e gropave për instalimin e depozitave për depozitim të lëndës/lëndëve djegëse (naftë dhe nënprodukte të saj) si dhe të vendosjes së shtyllave të ndriçimit.

Këto punime kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe jo deklaratë paraprake për kryerje punimesh. Sa më sipër subjekti ndodhet në kushtet, ku duhet të pajiset me leje ndërtimi dhe jo deklaratë paraprake për kryerje punimesh.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën "b" të nenit 29, nenin 41 në Ligjin nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; Nenin 11 dhe shkronjën "rr" në pikën 1 në nenin 19 të VKM nr.408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar.

²⁸ Për shkak të mungesës së informacionit, preventivi i punimeve dhe sipërfaqe ndërtimi, nuk mund të bëjmë përllogaritje të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. G.E në rolin e nëpunësit në sistemin e-leje, z. E.C, në rolin e kontrolluesit, z. M.T, në rolin e drejtuesit, dhe z. E.I, Kryetari i Bashkisë Kolonjë, miratues.

3. Deklaratë paraprake miratuar me vendimin nr.50, datë 13/09/2021 për subjektin “S.DH”, projektuar punimet nga subjekti juridik “S” Sh.P.K me licencë nr. 6943, përfaqësuar nga administrator, drejtues ligjor i subjektit të mësipërm z. J.H. Dokumentacioni i dorëzuar:

Aplikimi për deklaratë paraprake; Dokumenti i pronësisë; Projekt për leje zhvillimore; Licenca e projektuesit; Deklarata e projektuesit; Mandat pagesa e tarifës administrative të aplikimit; Relacioni arkitektonik etj.

Konstatohet se:

-Dokumentacioni i pronësisë nuk është i plotë, pasi nuk ka planimetrinë e objektit;

-Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se projekti është dorëzuar për leje zhvillimore të ndërtimit të objektit 2-kate dhe jo për kryerje punime restaurimi, i cili për më tepër pasqyron planimetrinë e kateve të objektit, plan-mobilimin dhe në asnjë rast punimet që do të kryhen, ndërhyrjet e restaurimit etj, të dhëna që duhet të pasqyrohen në projektin teknik të zbatimit të punimeve. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të pronësisë, rezulton se objekti është 2 katësh funksioni “banim”, ndërkohë që në projektin teknik pasqyrohet edhe ndërtimi i katit të tretë (kuota +9.2 m).

-Veç sa më sipër nga shqyrtimi i relacionit arkitektonik, rezulton se kati i parë i objektit, do të ndryshojë funksionin e përdorimit, pra nga “banim” që rezulton sipas dokumentit të pronësisë, do të kthehet në “shërbim”, si dhe për më tepër pasqyrohet se në parcelën me nr., pasurie 4/66 ZK 1594, nuk ka objekt ekzistues dhe do të ndërtohet një objekt 2 katësh, pra në kundërshtim të plotë me informacionin që pasqyrohet në formularin e aplikimit, sipas të cilit rezulton se në parcelën e mësipërme ka objekt ekzistues.

-Sa më sipër subjekti ndodhet në kushtet, ku duhet të pajiset me leje ndërtimi dhe jo deklaratë paraprake për kryerje punimesh, të cilat sjellin edhe mungesën e aplikimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë²⁹.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “b” të nenit 29, nenin 41 në Ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; Nenin 11 të VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. G.E në rolin e nëpunësit në sistemin e-leje, z. E.C, në rolin e kontrolluesit, z. M.T, në rolin e drejtuesit, dhe z. E.I, Kryetari i Bashkisë Kolonjë, miratues.

4. Leje ndërtimi Nr. 137, datë 05.01.2022 dhe leje zhvillimi Nr. 120, datë 11.08.2021 për objektin “Magazinë 1 kat për bletët”, sipërfaqe ndërtimi 69.96 m², në adresën Boshanj, Kolonjë, me zhvillues F.I, projektuar nga L.V me licencë nr. K.1106/2.

- Leja e ndërtimit është dhënë në njësinë strukturore me kod “KNJ_B_B2_178/3”, ku sipas rregullores së zhvillimit të territorit për Bashkinë Kolonjë, parashikohet shfrytëzimi i territorit për kultura sezonale dhe jo ndërtim, për të cilin sipas natyrës së aktivitetit është njësia strukturore kategoria “bujqësi” dhe nënkategoria me kod EB1/EB2, ekonomi bujqësore me struktura në funksion të bujqësisë (EB1), ose me struktura në funksion të blegtorisë (EB2).

-Sipas tipologjisë së ndërtimit, përcaktuar në lejen e zhvillimit, rezulton se është strukturë ku ushtrohet veprimtaria e për prodhimin ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Pra aktiviteti që do të ushtrohet në objektin që do të ndërtohet duhet të jetë në fushën e bujqësisë në përputhje me pasaportën strukturore të njësisë me kod “KNJ_B_B2_178/3”, ndërkohë jepet për aktivitet në edhe fushën e blegtorisë.

²⁹ Për shkak të mungesës së informacionit, preventivi i punimeve dhe sipërfaqe ndërtimi, nuk mund të bëjmë përlllogaritje të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-Sipas përcaktimit të bërë në Ligjin nr.9426, datë 06.10.2005 “Për blegtorinë”, i ndryshuar, neni 16, pika 1:

“1. Para ndërtimit ose rindërtimit të një objekti agrolegtoral, personat fizikë ose juridikë duhet ta miratojnë projektin teknologjik në drejtorinë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, si dhe të zbatojnë dispozitat e ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. Në vijim në pikën 2 të këtij neni drejtoria rajonale e bujqësisë lëshon lejen përkatëse.

-Si dhe përcaktimit të bërë në pikën 3 të nenit 14 dhe shkronjën “ë” të pikës 1 në nenin 15 në VKM nr.408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar, subjektit para se t’i miratohej leja e ndërtimit duhej të pajisej me lejen e mësipërme, por nuk është respektuar ky detyrim ligjor.

-Sipas certifikatës së pronësisë, objekti do të ndërtohet në tokë bujqësore. Në këto kushte, në vijim të përcaktimeve të bëra në pikën 4 të nenit 14 të Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar:

“Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral” – nuk është respektuar, struktura është edhe me beton arme;

-Leja e zhvillimit nuk përmban hartën e infrastrukturës inxhinierike, për identifikimin e pikave të lidhjes, përkatësisht për furnizimin me ujë, largimin e ujërave të zeza, rrjetin elektrik, rrjetin e komunikimit elektronik, pikat rrethuese të depozitimit të mbetjeve, infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit;

-Nuk administrohet leja për furnizimin me ujë dhe shkarkimin e ujërave, sipas mendimit të dhënë nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, por edhe sipas VKM nr. 550, datë 15.7.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”.

-Nuk administrohet marrja e mendimit nga struktura e shërbimit të mbrotjes nga zjarri dhe shpëtimin, MZSH Bashkia Kolonjë, për aprovimin e projektit të mbrotjes nga zjarri dhe shpëtimin.

-Nuk është marrë në konsideratë mendimi nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, ku subjekti për tu pajisur me leje ndërtimi duhet të dorëzojë planvendosje të re me imazh satelitor (ortofoto) ose koordinata te parcelës ku propozohet ndërtimi, me qëllim verifikimin e disponimit të infrastrukturës inxhinierike, respektimin e kufijve të objektit nga objektet fqinje;

-Preventivi i punimeve nuk përmban punimet për mbrojtjen kundër zjarrit, si dhe punimet elektrike dhe hidraulike nuk kanë njësitë matëse dhe sasinë, pra nuk janë të plota në informacion. Pra mospasqyrimi i punimeve dhe njërive matëse/sasive të nevojshme, ndikon në uljen e vlerës së preventivit dhe për pasojë edhe në uljen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë që përlllogaritet në bazë të vlerës së preventivit;

-Nuk administrohet projekti dhe raporti i verifikimit për eficiencën energjitike të objektit që do të ndërtohet.

-Projekti dhe relacioni arkitektonik nuk pasqyron të gjitha prerjet e objektit që do të ndërtohet, nuk shoqërohet me foto nga të gjitha fasadat.

-Nuk administrohet garancia financiare në masën 3%/79,533 lekë, të vlerës së projektit, në zbatim të pikës 10 të VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, detyrim që subjekti duhet të plotësojë përpara marrjes së lejes së ndërtimit.

-Sa më sipër, konstatohet se është miratuar leje ndërtimi në kushtet e mungesës së dokumentacionit të plotë në formë dhe përmbajtje, si dhe në kundërshtim me tipologjinë e llojit të ndërtimit që lejohet në njësinë strukturore të mësipërme. Në këto kushte, në

mbështetje të përcaktimit të bërë në pikën 4 të nenit 39 në Ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, gjykojmë dhe vlerësojmë se leja e ndërtimit është absolutisht e pavlefshme.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën “a” të nenit 29, pikën 1 të nenit 44 në Ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; Pikën 3 dhe 3/1 në nenin 3, shkronjën “g” në pikën 1 në nenin 9, pikën 3 në nenin 14, nenin 15, pikat 2 dhe 4 në VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar; Pikën 6 në Vendimin nr.12, datë 27.02.2019 të KKT; Pikën 1 në nenin 16 në Ligjin nr.9426, datë 06.10.2005 “Për blegtorinë”, i ndryshuar; Pikën 4 të nenit 14 të Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; VKM nr. 550, datë 15.7.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. G.E në rolin e nëpunësit në sistemin e-leje, z. E.C, në rolin e kontrolluesit, z. M.T, në rolin e drejtuesit, dhe z. E.I, Kryetari i Bashkisë Kolonjë, miratues.

III.2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit, grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi 01.07.2021 – 31.12.2021, kërkoi vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme siç janë, struktura e IMTV dhe formimi profesional i stafit të kësaj strukture, dosjet e procedurave të mbajtura nga IMTV, në të cilat duhet të përfshihen procesverbalet e konstatimit të mbajtura nga inspektorët, vendimet e gjobave, vendimet e pezullimit, vendimet e prishjeve dhe procesverbalet e ekzekutimit të këtyre prishjeve, kallëzimet penale, kërkesat drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, informacioni periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT, planet vjetore dhe planet mujore të punës të miratuara nga kryeinspektori.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, u konstatua si më poshtë vijon:

Titulli i Gjetjes: Mangësi në strukturën e IMTV, moszbatim i kuadrit rregullator nga IMTV në procedurën e inspektimit, marrjes së masave administrative, ekzekutimin e vendimeve për prishjen e objekteve të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme etj.

Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi strukturën e IMTV Bashkia Kolonjë, u konstatua se:

-Në Bashkinë Kolonjë funksioni i kontrollit për respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, kryhet nga zyra e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në varësi të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Pra nuk është krijuar Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, në varësi direkte nga organi ekzekutiv i bashkisë (pra Kryetarit të Bashkisë Kolonjë). Kjo mënyrë e funksionimit të strukturës mund të cenojë pavarësinë në vendimmarrje, por edhe realizimin e të gjitha detyrimeve ligjore të fushës, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi për realizimin, Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Në kuadrin rregullator, konkretisht në:

➤ Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 3, shkronja “a”, neni 4, neni 5, përcaktohet se:

-“Kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga: a) inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore përkatëse” - Pra jo nga zyra e kontrollit të territorit.

-“Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.

-Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse” – **Ndërkohë** sipas mënyrës së organizimit të strukturës respektive në Bashkinë Kolonjë, në dukje drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Për më tepër që sipas rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës, miratuar me vendimin nr.28, datë 29.04.2020 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, në nenin 85 përcaktohet se: *Në zbatim të detyrave që rrjedhin nga programet vjetore dhe periodike të miratuara në shkallë aparati, **parashikon planet mujore të punës**, detyrat që i dalin zyrës sipas fushave përkatëse (një prej të cilave është “kontrolli/inspektimi), ndjek sistematikisht plotësimin e tyre dhe çdo muaj **bën analizën në nivel njësie apo zyre, si dhe përpilon informacionin periodik të realizimit të detyrave për Kryetarin e Bashkisë/Sekretarin e Përgjithshëm – Ndërkohë** që disa prej këtyre detyrimeve duhet të përmbushen nga Kryeinspektori dhe në marrëdhënie direkte me Kryetarin e bashkisë.*

-Gjatë ushtrimit të përgjegjësiave të parashikuara në nenin 4, të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme: a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit – Pra zyra e kontrollit të territorit, do të ushtroj kontroll ndaj drejtorit të vet, për më tepër do të vendosi dhe gjobë ndaj tij/ose e kundërta drejtori i drejtorisë do të bëjë planin e punës për zyrën e kontrollit të territorit, ku krijohet mundësia që për një/dispa leje ndërtimi të miratuara të mospërfshihen në planin e punës së zyrës së kontrollit të territorit.

➤ Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 14/4 dhe neni 14/6, përcaktohet se:

1. Përbën shkelje disiplinore, sipas këtij ligji, kryerja e veprimeve ose mosveprimeve të mëposhtme:

a) përgatitja e studimeve ose e projekteve në kundërshtim me standardet teknike në fuqi ose paraqitja pranë autoriteteve publike e studimeve ose e projekteve me të meta më shumë se një herë;

1. Propozimin për fillimin e procedurës disiplinore mund ta paraqesë zhvilluesi, inspektorati vendor ose kombëtar, kryetari i bashkisë, në rastet kur ndërtimi është kryer në territorin e bashkisë, çdo autoritet publik që mbikëqyr veprimtarinë e ndërtimit ose çdo person fizik ose juridik – Pra në rastin kur drejtorja e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, përgatit një studim ose projektim në kundërshtim me standardet teknike në fuqi, studim i cili miratohet nga drejtori i drejtorisë dhe kjo mangësi konstatohet nga zyra e kontrollit të territorit, atëherë sipas kuadrit rregullator, kjo zyrë ka detyrimin që të propozojë fillimin e procedurës disiplinore për drejtorin e drejtorisë prej të cilit ka varësi administrative, i cili veç të tjerave, do të bëjë vlerësimin e punës për punonjësit e zyrës së kontrollit. Pra në këto kushte, zyra e kontrollit nuk mund të jetë e pavarur gjatë detyrave që duhet të kryejë, kur veprimet dhe mosveprimet e eprorit direkt, janë objekt kontrolli dhe marrje masash.

➤ Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 5, neni 19, neni 20:

-“Inspektori apo grupi i inspektimit, brenda kompetencave të dhëna me ligj apo akt nënligjor, është plotësisht i pavarur në kryerjen e procedimit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për një rast konkret”.

-“Organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore mbështet funksionimin efektiv të inspektoratit vendor. **Kjo përgjegjësi nuk përfshin drejtimin operacional të veprimtarisë së inspektimit**”.

-“Kryeinspektori i inspektoratit përkatës është "eprori i drejtpërdrejtë" i inspektorëve, në kuptimin e këtyre dispozitave”.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi z. E.I, Kryetar i Bashkisë Kolonjë.

2.Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi numrin dhe formimin profesional të stafit në strukturën e mësipërme, u konstatua se:

-Pranë zyrës së kontrollit të territorit janë 2 punonjës, një Kryeinspektor, konkretisht z.P.C, me formimin profesional inxhinier pyjesh, i cili është komanduar në këtë pozicion me Urdhrin nr.170, datë 16.04.2020 të Kryetarit të Bashkisë, pasi në krye të herës është emëruar në pozicionin specialist për kontrollin e territorit, si dhe një Inspektor, konkretisht z.E.C, me formimin profesional inxhinier agromjedisi, i cili ka ushtruar funksionin e inspektorit, caktuar me Urdhrin nr.317, datë 12.11.2018 të Kryetarit të Bashkisë, pasi në krye të herës është emëruar në pozicionin specialist për mbrojtjen e mjedisit.

-Pra sa më sipër numri i stafit në këtë strukturë, nuk siguron zbatimin e përcaktimit ligjor të bërë në pikën 1 të nenit 12 në Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar:

*“Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore **kravejnë inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë**, ose me një grup inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të IKMT-së dhe një inspektor të njësisë vendore.*

-Gjithashtu konstatohet se arsimimi i punonjësve të strukturës së mësipërme nuk është plotësisht në përputhje me nenin 11 të Ligjit Nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, pasi në përbërje të stafit nuk ka inxhinier ndërtimi, jurist, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë etj. Duke qenë se kjo strukturë ka rëndësi të madhe në fushën e kontrollit të territorit, dhe disiplinimit të punimeve në fushën e ndërtimit, inspektimi me inxhinier pyjesh/mjedisi e bën jo cilësore ushtrimin e kontrollit, dhe njëkohësisht pothuajse të pamundur mbajtjen e akteve të kontrollit në subjektet e pajisura me leje ndërtimi, pasi të dy punonjësit e mësipërm, janë më tepër në ushtrimin e kontrollit për mbrojtjen e mjedisit, se për kontrollin e zhvillimit të territorit.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi z. E.I, Kryetar i Bashkisë Kolonjë.

-Gjithashtu nga verifikimi i faqes zyrtare të Bashkisë Kolonjë, si dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit³⁰, konstatohet se për vitin 2021 nuk është bërë shpallje për 1 pozicion të lirë pune, inspektor, në zyrën e kontrollit të territorit, sipas strukturës së miratuar (1) Kryeinspektor dhe (2) Inspektor, ç’ka do të thotë se nuk janë marrë masa për plotësimin e kësaj strukture dhe ushtrimin e funksionit të inspektimit në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës.

-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. E.I, Kryetar i Bashkisë Kolonjë dhe zj V.B, ish Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

3.Mbi veprimtarinë e zyrës së kontrollit për periudhën 01.07.2021-31.12.2021.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se Kryeinspektori i zyrës së kontrollit, nuk ka miratuar asnjë akt-kontrolli sipas fazave të punimeve, për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me shkronjën “a” në nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

Për sa më sipër mban përgjegjësi z. P.C, Kryeinspektor i Zyrës së Kontrollit pranë Bashkisë Kolonjë.

³⁰ <https://www.puna.gov.al/kerko>

-Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se Kryeinspektori i zyrës së kontrollit nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Për sa më sipër mban përgjegjësi z. P.C, Kryeinspektor i Zyrës së Kontrollit pranë Bashkisë Kolonjë.

-Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi, nga zyra e kontrollit u vendos në dispozicion plani i vitit 2021 dhe planet mujore të aktivitetit, për periudhën 01.07.2021-31.12.2021. Konstatohet se programi vjetor i punës për zyrën e kontrollit nuk është miratuar nga organi ekzekutiv i bashkisë (Kryetari i Bashkisë), në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 24 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”. Konkretisht, zyra e kontrollit me shkresën nr.50, datë 05.01.2021, i ka vendosur në dispozicion Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, programin vjetor të punës, por më pas nuk dokumentohet nëse programi vjetor i është përcjellë kabinetit/sekretarisë së Kryetarit të Bashkisë, me qëllim miratimin.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi zj.V.B, ish Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

-Nga zyra e kontrollit nuk dokumentohet kryerja e inspektimeve pranë subjekteve të cilët përgjatë vitit 2021 kanë kryer punime ndërtimi, me qëllim verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga zotëruesit e mbetjeve inerte, gjatë prodhimit, përpunimit dhe dorëzimit të tyre pranë subjekteve të cilat janë të pajisura me leje mjedisore, detyrë në zbatim të pikës 23 në VKM nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

Për sa më sipër mban përgjegjësi z. P.C, Kryeinspektor i Zyrës së Kontrollit pranë Bashkisë Kolonjë.

-Programet mujore të punës nuk kanë numër protokolli, ç’ka nuk vërteton hartimin e tyre, si dhe z.Paqësor Cane, ka nënshkruar si inspektor, ndërkohë që duhet të nënshkruante si Kryeinspektor, me qëllim miratimin e programeve mujore, ç’ka nuk vërteton miratimin e tyre, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” dhe nenin 13 në normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër mban përgjegjësi z. P.C, Kryeinspektor i Zyrës së Kontrollit pranë Bashkisë Kolonjë.

-Gjithashtu nuk janë përcaktuar objektivat vjetorë dhe afatmesëm strategjike, treguesit specifikë të efektivitetit e të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 në nenin 19 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi z. E.I, Kryetar i Bashkisë Kolonjë.

-Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, ndërmjet zyrës së kontrollit dhe drejtorisë së urbanistikës, ka munguar bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit në Bashkinë Kolonjë, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 51 në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

Për sa më sipër mban përgjegjësi z.M.T, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe z. P.C, Kryeinspektor i Zyrës së Kontrollit pranë Bashkisë Kolonjë.

-Nga zyra e kontrollit, për tejkalim të afatit të punimeve, sipas lejes së ndërtimit, janë vendosur 3 gjoba në vlerën 100,000 lekë secila, ndaj subjekteve si vijon:

Procesverbal për dënim me gjobë nr.1, datë 24.08.2021 ndaj subjektit – B.M;

Procesverbal për dënim me gjobë nr.2, datë 24.09.2021 ndaj subjektit - A 91 Sh.P.K;

Procesverbal për dënim me gjobë nr.3, datë 28.09.2021 ndaj subjektit – K.V.F. Subjektet e mësipërme kanë kryer likuidimin e gjobave përkatëse.

-Konstatohet se vendimet e mësipërme nuk janë bërë publike dhe të jenë botuar në regjistër sipas mjeteve përkatëse të informimit.

-Inspektimet nga zyra e kontrollit janë kryer vetëm për trajtimin e ankesave të ardhura pranë Bashkisë Kolonjë, të cilat janë protokolluar, përcjellë zv.Kryetarit të Bashkisë zj.E.M/Kabinetit të Kryetarit dhe sipas rastit i janë deleguar për trajtim drejtorisë së urbanistikës, zyrës së kontrollit, por edhe në raste të caktuara zyrës së kontrollit dhe policisë bashkiake. Nga ankesat e administruara nga zyra e kontrollit, u përzgjedhën në mënyrë rastësore disa prej tyre, pasqyruar informacioni sipas akt-kontrollit të mbajtur, si më poshtë vijon:

1.Ankesa nga M.I dhe A.M, me shkresën nr.5026 prot., datë 18.10.2021, ndërtim i murit mbajtës duke sjell ngushtim të rrugës në fshatin Kabash.

1.1.Akt Kontrolli datë 25.10.2021, mbajtur nga zyra e kontrollit përfaqësuar nga z.P.C, Përgjegjësi i Drejtorisë së Bujqësisë, Administratori i NJA së mësipërme, Kryeplaku i fshatit, si dhe palët ankuese. Nga verifikimi në terren, u konstatua se është ndërtuar pa leje një mur i cili ka hyrë 40 cm në trupin e rrugës, si dhe një shkallë. Këto dy objekte janë ndërtuar pa leje nga shtetasit T.M dhe A.M. Dy shtetasve të mësipërm i'u la afat 5 ditë për të hequr murin dhe shkallën, në të kundërt do të ndërhyet me mjetet përkatëse, si dhe do të merren masa administrative. (Bashkëlidhur praktikës dokumentare, foto e bërë datë 21.01.2022, ku pasqyrohet një mur)

2.Ankesa nga S.V, me shkresën nr.3791 prot., datë 03.08.2021, ndërtim pa leje nga shtetasi Kolë Thoma përpara objektit “servis” në pronësi të ankuesit.

2.1.Proces verbal konstatimi datë 02.09.2021, mbajtur nga zyra e kontrollit përfaqësuar nga z.P.C në prani të Policisë Bashkiake Kolonjë, Administratori i NJA Leskovik, Specialisti i zyrës së shërbimeve në NJA Leskovik, shtetasit K.T, ndaj të cilit është bërë ankesa dhe palës ankuese. Nga verifikimi në terren, u konstatua se është ndërtuar pa leje një gardh, i cili u hoq në moment. Gjithashtu për tendën e rrushit të vendosur nga K.T, u la detyrë që deri më datë 06.09.2021 të hiqet, në të kundërt do veprohet sipas ligjit. (Bashkëlidhur praktikës dokumentare, foto)

3.Ankesa nga K.P, me shkresën nr.3644 prot., datë 28.07.2021, ndërtim pa leje pranë shtëpisë së vet në fshatin Rehovë.

3.1.Akt Kontrolli datë 29.07.2021, mbajtur nga zyra e kontrollit përfaqësuar nga z.P.C në prani të Policisë Bashkiake Kolonjë dhe Administratori i NJA Qendër. Nga verifikimi në terren, u konstatua se familja N.D kishte ngritur një kat dhe mbi këtë kat kishte ngritur kolona për shtesë kati. Ky ndërtim është bërë para 10 vitesh siç na u tha në terren. Aktualisht nuk punohej dhe nuk kishte të pranishëm në banesën e personit për të cilin bëhej ankesa. Nuk do ndërhyej për ndërtim pa u paraqitur me dokumentat ligjorë, pasi fshati Rehovë ka status të veçantë. U la detyrë që për çdo ndërhyrje që do të bëhej pa pasur dokumentet e duhura, do të konsiderohet ndërtim i paligjshëm dhe do të ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi.

4.Ankesa nga V.K, drejtuar NJA Leskovik me shkresën nr.111 prot., datë 28.09.2021, administruar në Bashkinë Kolonjë me shkresën nr.4700 prot., datë 28.09.2021, në ndërtimin që po kryhen shtetasi V.V, ka lënë dritaren me pamjen nga banesa e ankuesit. (Sipas mbishkrimit në ankesë, rezulton se zyra e kontrollit nuk ka pasur mjet transporti për të shkuar në NJA Leskovik, për verifikimin e ankesës).

5.Ankesa nga V.A, Helmës, me shkresën nr.3639 prot., datë 27.07.2021, për 3 ndërtimet pa leje të shtetasve M.N, B.M dhe I.L, të cilat janë bërë shkak për shkarkimin e ujërave të bardha dhe të zeza drejt shtëpisë së ankuesit. Gjithashtu ndërtimi pa leje i shtetasit B.L, ka krijuar problem në ujitjen e kopshtit të shtëpisë, si dhe ndërtim pa leje “garazh” të këtij shtetasit në tokën “truall”, pronë e familjes së ankuesit.

6.Ankesa nga A.J, Selenicë e Pishës, me shkresën nr.3818 prot., datë 04.08.2021, ndërtim pa leje nga B.X, në tokën “truall” pronë e ankuesit.

6.1. Proces verbal konstatimi datë 05.08.2021, nr.3836 prot., datë 05.08.2021, mbajtur nga zyra e kontrollit përfaqësuar nga z.P.C në prani të Policisë Bashkiake Kolonjë, Inspektori i Policisë së Rendit, ankuesit dhe personit ndaj të cilit është bërë ankesa. Nga verifikimi në

terren, u konstatuan punime ndërtimi të cilat u pezulluan dhe u fotografuan nga ana jonë. Palëve ju la detyrë që të dorëzojnë dokumentacioni përkatës. Z. J.XH ju la detyrë që të mos vazhdojë punimet, në të kundërt do të merren masa sipas ligjeve në fuqi.

Sa më sipër konstatohet se:

-Për praktikën me nr., rendor 4 dhe 5 nga zyra e kontrollit nuk është kryer inspektim për verifikimin e situatës sipas ankesës së dorëzuar pranë Bashkisë Kolonjë, deleguar për trajtim nga zyra e kontrollit, pra kemi të bëjmë me mosveprim nga zyra e kontrollit, përfaqësuar nga z. P.C, me detyrë Kryeinspektor.

-Për praktikën me nr., rendor 1, 2, 3 dhe 6 në kryerjen e veprimeve inspektuese nuk janë përdorur formatet standarde të inspektimit, si procesverbal konstatimi, pezullimi, prishje ndërtimi, por veprimet inspektuese janë pasqyruar në letër formati A4 dhe me shkrim dore.

-Për praktikën me nr., rendor 1, 2, 3 dhe 6, edhe pse sipas informacionit në dokumentet e mbajtura, janë pasqyruar raste të ndërtimeve pa leje, nuk është vendosur gjobë.

-Për praktikën me nr., rendor 3, nga zyra e kontrollit nuk dokumentohet afishimi i dokumentit të mbajtur gjatë inspektimit në kantierin e punimeve, si dhe në ambjentet e brendshme të Bashkisë Kolonjë, me qëllim respektimin e afateve procedurale për të vazhduar në vendosjen e gjobës dhe prishjen e punimeve.

-Për praktikën me nr., rendor 1, 2 dhe 6, konstatohet se nuk dokumentohet procedura e prishjes së punimeve pa leje, si dhe për praktikën nr.1 nga zyra e kontrollit nuk janë përlllogaritur shpenzimet e prishjes së punimeve dhe rikthimin e territorit në gjëndjen e mëparshme, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me punime në hapësirë publike, ndërtimi i murit i cili ka prekur trupin e rrugës.

-Për praktikën me nr., rendor 1, 2, 3 dhe 6, konstatohet se ndaj kundërvajtësve nuk është bërë kallëzim penal në organet e rendit.

-Për praktikën me nr., rendor 1, 2, 3 dhe 6, edhe pse është lënë detyrë për prishjen e punimeve pa leje dhe/ose të dorëzimit të dokumentacionit (rasti nr.6), konstatohet se nuk administrohet dokumentacioni i dorëzuar nga palët, të cilat janë ngarkuar me detyrimin për të dorëzuar dokumentacionin përkatës, për efekt justifikimi ligjor të punimeve të ndërtimit, si dhe nga zyra e kontrollit nuk është kryer inspektim për verifikimin e plotësimit të detyrave të lëna, pra të prishjes së punimeve të ndërtimeve pa leje.

-Për praktikën me nr., rendor 1, 2, 3 dhe 6 konstatohet se nuk ka marrë pjesë inspektori E.C, pra nga kryeinspektori i zyrës së kontrollit, nuk janë marrë për organizimin dhe funksionimin e plotë të zyrës së kontrollit.

-Për praktikën me nr., rendor 1, 2, 3 dhe 6, konstatohet se nuk administrohet kthim përgjigje ndaj palëve që kanë bërë ankesat përkatëse.

7.Veç sa më sipër në dokumentacionin e vendosur në dispozicion, ndër të tjera, administrohen edhe dy shkresa nga IKMT Drejtoria Rajonale Korçë, konkretisht:

7.1.Shkresa nr.5179 prot., datë 28.10.2021 drejtuar IMTV Bashkia Kolonjë, ku i kërkohet trajtimi i denoncimit të mbërritur pranë zyrave të IKMT Drejtoria Rajonale Korçë, për ndërtim pa leje nga A.T, në fshatin Vrepcke.

7.2. Shkresa nr.4871 prot., datë 07.10.2021 drejtuar IMTV Bashkia Kolonjë, ku i kërkohet trajtimi i ankesës nga shoqëria E Sh.P.K, të mbërritur pranë zyrave të IKMT Drejtoria Rajonale Korçë, për ndërprerjen e menjëhershme të punimeve për ndërtimin e Ujësjiellit Ersekë dhe të disa fshatrave, faza II, nga burimet e Kozelit, si ndërhyrje të parregullta në aktivitetin e koncesionarit E Sh.P.K.

-Nga shqyrtimi i praktikave të mësipërme, konstatohet se nuk administrohet dokumentacion mbi veprimet e ndërmarra nga zyra e kontrollit Bashkia Kolonjë, si procesverbali i kryerjes së inspektimit dhe konstatimit të situatës në dy rastet e mësipërme; Kthim përgjigje ndaj kërkesës së bërë nga IKMT Drejtoria Rajonale Korçë.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z.P.C, Kryeinspektor i Zyrës së Kontrollit pranë Bashkisë Kolonjë. Gjithashtu, bazuar në përcaktimet ligjore të bëra në nenin 11 të Ligjit nr.10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ngarkohet me përgjegjësi edhe z.M.T, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, i cili nuk ka

marrë masa për eliminimin e paligjshmërisë e krijuar nga zyra e kontrollit, strukturë në varësi të DPZHT.

Kriteri: Shkronja “a” në nenin 3, nenin 4, nenin 5, nenin 11, pikat 5, 6, 7, 8 në nenin 12, nenin 13, në Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Nenin 1, në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Pikat 1, 2, dhe 4 në nenin 51 në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Nenin 5, pikën 1 në nenin 9, pikën 3 të nenit 24, shkronjat “a” dhe “c” në pikën 1, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 31, pikat 4 dhe 5 në nenin 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 11 të Ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pikën 1 germa b/ii, pikën 2, shkronjën “b”, pikat 4 dhe 6 në VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

Ndikimi: Mungon institucioni përgjegjës për kontrollin e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, si dhe për verifikimin e zbatimit të lejeve të ndërtimit. Cenimi i qëllimeve të kuadrit rregullator për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, inspektime jo cilësore.

Shkaku: Shmangie e detyrimit ligjor në hartimin dhe miratimin e organikës nga titullari i institucionit. Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për:

-Krijimin dhe funksionimin e strukturës së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në nivel Inspektorati dhe jo si zyrë kontrolli, për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

-Rekrutimin në stafin e IMTV të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

Rekomandimi: Zyra e kontrollit Bashkia Kolonjë, të marrë masat për kryerjen e inspektimit, për verifikimin e situatës së krijuar, bazuar në 2 ankesat e administruara në Bashkinë Kolonjë, konkretisht nga shtetasi V.K me shkresën nr.4700 prot., datë 28.09.2021 dhe shtetase V.A me shkresën nr.3639 prot., datë 27.07.2021, si dhe të ankesave të përcjella nëpërmjet shkresave nr.5179 prot., datë 28.10.2021 dhe nr.4871 prot., datë 07.10.2021 të administruar nga IKMT Drejtoria Rajonale Korçë.

Rekomandimi: Zyra e kontrollit Bashkia Kolonjë, për praktikën e inspektimeve të kryera bazuar në ankesat e administruara nga shtetasit M.I, A.M, S.V, K.P, A.J, të marrë masat e nevojshme, për kryerjen e inspektimit pranë subjekteve përkatëse, me qëllim verifikimin e respektimit të detyrimit të lënë për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme, si dhe dokumentimin e plotë të procedurës së ndjekur, deri në kthim-përgjigjen ndaj palëve të interesuara. Gjithashtu për rastin ku janë kryer punime ndërtimi të paligjshme në hapësirë publike, zyra e kontrollit të bëjë përlllogaritjen e shpenzimeve të rikthimit të territorit në gjëndjen e mëparshme, duke njoftuar subjektin për likuidimin e dëmit, në natyrë/vlerë monetare.

Rekomandimi: Zyra e kontrollit Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, për kryerjen e inspektimeve duke përdorur dokumentet standard të procedurës së inspektimit. Gjithashtu të hartojë dhe përcjellë për miratim pranë Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, planin vjetor të aktivitetit.

Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Zyra e Kontrollit Bashkia Kolonjë të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, ku për çdo leje ndërtimi të miratuar/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, të informohet edhe Zyra e Kontrollit, me qëllim miratimin e akt-kontrolleve për lejet e ndërtimit, si dhe rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Kolonjë.

III.2.7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Titulli i gjetjes: Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

1. Me shkresën nr.2578/1 prot., datë 17.06.2022 “Kthim përgjigje për raportin përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet e lëna”, Bashkia Kolonjë ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit nr.3065 prot., datë 17.06.2022, për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor është zbatuar në afat.

2. Bashkia Kolonjë nuk ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, në përputhje me pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar.

Për sa më lart në Bashkinë Fushë Kolonjë, nga grupi i auditimit u mbajt akt-verifikimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Bashkinë Kolonjë:

Nga KLSH janë lënë gjithsej **39** rekomandime, të grupuara në:

25 masa organizative;

9 masa shpërblim dëmi;

3 masa për eliminimin e efekteve negative lidhur me eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike;

1 masë për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim-taksat vendore;

1 masë disiplinore.

-Për zbatimin e rekomandimeve nga Kryetari i Bashkisë Kolonjë janë nxjerrë urdhrat si nr. 321-330, datë 17.06.2022, për:

Ngritjen e komisionit për arkëtimin e detyrimit të vlerës së qirave të përdorimit të fondit pyjor dhe kullor;

Ngritjen e komisionit për arkëtimin e vlerës së zërave të punimeve të pakryera;

Ngritjen e komisionit për vendosjen e masës së gjobës si pasojë e keqlllogaritjes së TNI si dhe për njoftim fillim punimesh jashtë afateve;

Ngritjen e komisionit për arkëtimin e detyrimit si pasojë e keqlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë;

Ngritjen e komisionit për verifikimin, analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për procedurat e prokurimit;

Ngritjen e komisionit për verifikimin, analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për procedurën e prokurimit “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës”;

Përcaktimin e personit përgjegjës z.A.J, për analizimin e 10 rekomandimeve të rubrikës C në shkresën përcjellëse të raportit përfundimtar të auditimit;

Ngritjen e komisionit për ngritjen e komisionit për eliminimin e efekteve negative lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara;

Ngritjen e komisionit për ngritjen e komisionit për eliminimin e borxhit tatimor;

Ngritjen e komisionit të disiplinës për vlerësimin e përgjegjësive dhe marrjen e masës disiplinore ndaj punonjësve të përmendur në raportin përfundimtar të auditimit;

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë³¹:

-Nga 39 rekomandime të lëna gjithësej, janë zbatuar 4 prej tyre, ose 10%, 5 zbatuar pjesërisht, ose 13%, 9 janë në proces zbatimi, ose 26%, si dhe 20 rekomandime nuk janë zbatuar, ose 51%.

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **25** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 3 janë zbatuar, 4 zbatuar pjesërisht, 6 janë në proces zbatimi dhe 12 nuk janë zbatuar. Pra janë zbatuar 12% e masave organizative dhe 48% nuk janë zbatuar.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 9 rekomandime për 23 subjekte në vlerën 23,275,791 lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat nuk janë zbatuar 5 rekomandime për 8 subjekte në vlerën 21,360,219 lekë, ose 91%, si dhe 4 rekomandime janë në proces zbatimi për 10 subjekte në vlerën 1,915,572 lekë, ose 8%.

-Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 3 rekomandime në vlerën 716,692,744 lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat 2 nuk janë zbatuar për vlerën 714,692,744 lekë, ose 99% dhe 1 masë është zbatuar për vlerën 2,000,000 lekë.

-Për eliminimin e borxhit tatimor është lënë 1 rekomandim në vlerën 49,966,840 lekë, i cili është pranuar dhe nuk është zbatuar.

-Është dhënë 1 masë disiplinore, e cila është zbatuar pjesërisht.

Më hollësisht rekomandimet e pazbatuara dhe zbatuar pjesërisht, për të cilat nga KLSH rikërkohet zbatimi i tyre, paraqiten si më poshtë vijon (numrat rendor janë sipas renditjes në shkresën përcjellëse dërguar subjektit):

A.MASA ORGANIZATIVE

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit.

-Në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë Kolonjë të krijojë si strukturë me vetë Inspektorati Vendorë i Mbrojtjes së Territorit e pavarur nga Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, strukturë e cila të miratohet dhe në Këshillin Bashkiak.

-Të plotësohet struktura e Auditit të Brendshëm me 3 punonjës, sipas strukturës së miratuar të Bashkisë Kolonjë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1 Rekomandimi: Sektori i Njësisë së Auditit të Brendshëm (NJAB), të marrë masa që:

- Të kryhet monitorimi i zbatimit rekomandimeve i cili kërkon që në zbatim rekomandimeve, drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit sipas Manualit AB.

- Të marrë masa për plotësimin e dosjeve sipas Manualit të AB, duke plotësuar dokumentet si “planifikim angazhimi për auditim”, “takimi i hapur prezantues”, “letrat e punës” si dhe “vlerësimin e brendshëm të cilësisë”.

- Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë të Bashkisë Shkodër.

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NjAB në përputhje me organikën e miratuar, e cila ndikon në rritjen e kapaciteteve audituese.

Në vijimësi

7.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që deklarojnë mbyllje aktivitet nëse deklarimi është i saktë si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të peregjistruar në QKB. Bashkia Kolonjë duhet

³¹ Pasqyruar më hollësisht auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.6” të raportit të auditimit.

të marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar numrin e subjekteve fizik/juridik si dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara të bëhet aplikimi i taksave dhe tarifave vendore.

Menjëherë dhe vijimësi

8.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë duhet të marrë masa që në të ardhmen të kryejë një proces planifikimi sa më real si dhe më kryesorja të ketë rritje të nivelit të të ardhurave dhe arkëtimit të tyre duke kryer periodikisht analiza për ecurinë duke nxjerrë objektivat përkatëse, në mënyrë të tillë që në fund të periudhave ushtrimore të ulet gjendja e faturave të palikuiduara dhe borxhi.

Menjëherë dhe vijimësi

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kolonjë të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimorë, sipas llojit të taksës të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë si dhe të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë. Të krijohet baza e të dhënave për subjektet, tarifave dhe taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera dhe rakordimet të bëhen çdo fund muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë dhe vijimësi

10.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie

Menjëherë dhe vijimësi

12.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë, Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve, si dhe të sistemohet dhe vet llogaria 202 studime e kërkime për vlerën 17,822,316 lekë.

Me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm

13.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të SHA Ujësjetllës Kanalizime me vlerë kontabël 183,473,532 lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm

14.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë, të analizojë situatën e të nxjerrë përgjegjësitë për përcaktimet e gabuara të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe të marrë masa që përcaktimi e kriterëve për kualifikim të jetë në lidhje të ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit.

Në vijimësi

16.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1337/44 prot., datë 01.07.2019, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për **rizbatimin** e plotë të tyre, *respektivisht:*

a-Për **6** masa organizative në proces zbatimi dhe nisjen e procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës **1,583,700 lekë**, konkretisht për pikën **3.7.1;**

b-Për **7 persona** masa administrative për arkëtimin e vlerës **290,000 lekë.**

17.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur dokumentacioni të jetë qartazi i plotë dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e agroturizmit.

Menjëherë dhe në vijimësi

18.1 Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendore të shqyrtojë mangësitë në dosjet e lejeve të ndërtimit duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masa për krijimin e dosjeve për secilin subjekt ndërtues të pajisur me leje ndërtimi për periudhën 2018-2021 dhe për periudhën në vazhdim, në zbatim të kërkesave të nenit 9, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.2014 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar. Të programohen planet e punës javore, mujore dhe vjetore dhe të miratohen nga Kryetari i Bashkisë Kolonjë. Për ndërtimet e kundërligjshme me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor në proces verbalet e konstatimit të vendoset edhe sipërfaqja në (m²) dhe vlerën e preventivit të punimeve, duke e shumëzuar me koston e Entit Kombëtar të Banesave për qytetin e Ersekës, siç përcaktohet në ligjin nr. 107/2014, datë 01.10.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 09.07.2015, nr. 8/2017, datë 23.03.2017 neni 52 “Kundërvajtjet administrative”, pika 2.

Menjëherë

19.1 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë, Njësia e Prokurimit në lidhje me vendosjen e kriterëve për kategoritë e nevojshme të punimeve për zbatimin e kontratës në DST, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të parashikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Në vijimësi

21.1 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë, të marrin masat e duhura që:
- Për prokurimet publike llogaritja e fondit limit dhe nevojave të bëhet bazuar në të dhëna të dokumentuara dhe analiza, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.
- Në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.
- Në ngritjen e komisioneve për kryerjen e procedurave të prokurimit, të ketë persona me njohuri në fushën e objektit të prokurimit, me qëllim vendimmarrje, menaxhim dhe vlerësim objektiv të procedurave të prokurimit.

Në vijimësi

22.1 Rekomandimi: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë procedurës së vlerësimit duhet të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme, duke shpallur fituese ofertën me çmimin më të ulët, kur ky i fundit është kriteri përcaktues.

Menjëherë

23.1 Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë të merren masa të menjëhershme për të mos dhënë autorizime për kryerje punimesh në objekte të cilat nuk kanë leje ndërtimi dhe nuk kanë certifikatë pronësie. Gjithashtu, nga ana e Kryetarit të Bashkisë të komunikohet menjëherë me Inspektoratin Kombëtar Mbrojtjes së Territorit Dega Korçë si dhe të vihet për dijeni Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për asistencë dhe marrje masash në lidhje me 3 objektet e sipërcituara.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **23,275,791 lekë** si më poshtë:

1.1.Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit të vlerës së qirave të përdorimit të fondit pyjor dhe kullosor prej **19,457,332** lekë, për Hec-et që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Bashkisë Kolonjë, respektivisht për subjektet si më poshtë:

- Subjekti “Ç” shpk, për vlerën prej 10,096,720 lekë.
- Subjekti “Q & K” shpk, për vlerën prej 936,780 lekë.
- Subjekti “BGE” shpk, për vlerën prej 132,000 lekë.
- Subjekti “E” shpk, për vlerën prej 8,291,832 lekë.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **732,989** lekë pa tvsh nga BOE “A” Shpk & “E.K” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2626 Prot, datë 07.08.2019, me objekt “*Rikonstruksion i shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”*”, Ersekë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **218,243** lekë pa tvshnga BOE “Z” Shpk & “K” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5318 Prot, datë 05.11.2020, me objekt “*Rikonstruksion i pjeshëm i godinës së Bashkisë Ersekë*”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4.1 Rekomandimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kolonjë të marren masa të menjëhershme për vendosjen e masës së gjobës si dhe nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të merren masa të menjëhershme duke nxjerrë aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total **523,391** lekësh.

Menjëherë

5.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të merren masa të menjëhershme për ndjekjen e procedurave për vjeljen e detyrimit që ka lindur nga keq llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **428,264** lekësh ndaj subjektit me NIPT K....K “Agjencia Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve”.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

(1-10) Rekomandimi:

- Kryetari i Bashkisë Kolonjë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve Standarde të Tenderit, me pasojë përdorimin pa efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike për vlerën **713,328,744** lekë pa TVSh.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë procedurës së vlerësimit duhet të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme, duke shpallur fituese ofertën me çmimin më të ulët, kur ky i fundit është kriteri përcaktues.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

C/I. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE LIDHUR ME LLOGARITJEN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE ME EFEKTE NË TË ARDHURAT E MUNGUARA NË BASHKINË KOLONJË.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Kolonjë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore në shumën prej **1,364,000 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kolonjë.

Menjëherë

C/II. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRIUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.

1.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kolonjë të marrë masat për të ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 130 subjekte për vlerën **9,229,703** lekë dhe abonentë familjarë për vlerën gjithsej **40,737,137** lekë, bazuar në neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor” ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- T`u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime në llogarit bankare;
- T`i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe “Sektori Juridik”, të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe me kontratë pune.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; geramat (b, c, ç) e nenin 58 - “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e

vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9- “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kolonjë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor**, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi z.E.I, Kryetar i Bashkisë Kolonjë, zj. S.R, ish Drejtor i Financës, z. A.J, Drejtor i Pyjeve, z. M.T, Drejtor i Urbanistikës, z. F.F, Drejtor i Burimeve Njerëzore, z. SH.L, Drejtor i të Ardhurave, z. A.T, personi përgjegjës për prokurimet.

Kriteri: Ligji nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronja “j”. Shkresa nr.683/26 prot, datë 23.05.2022 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

Shkaku: Mosmarrje e masave për vënien në zbatim të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Ndikimi/Efekt: Risk i shtuar në aktivitetin e Bashkisë Kolonjë, ku mangësi të konstatuara në auditimin e mëparshëm vazhdojnë të përsëriten.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

II.2.8.Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

-Gjatë auditimit nuk ka pasur çështje të tjera, veç çështjeve të programit të trajtuara më sipër.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.
- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Në Bashkinë Kolonjë nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.
- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Në Bashkinë Kolonjë, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Drejtorja e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin

e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 9-11, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

1.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit, administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

1.3.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

-Kryejën e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hartimin e dokumentit “Harta e proceseve të punës”.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Kolonjë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Kolonjë përgjatë vitit 2021, u konstatua se:

Numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë kanë qenë 2 punonjës të punësuar.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njesisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

-Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Për periudhën 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kolonjë, të cilat janë me risk të lartë, si Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve, Sektori Juridik dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

-Për vitin 2021 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për tu kryer 6 auditime dhe janë kryer 5 gjithësej.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 17-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

-Plotësimin e strukturës së NJAB Kolonjë;

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2023

2.2.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet

publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucionale.

Përgjatë vitit 2023 dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Kolonjë për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak për vlerën 20,423,001 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën:

-19,457,332 lekë detyrime të subjekteve për marrjen me qira të sipërfaqeve në fond pyjor/kullosor.

-965,669 lekë kamatë-vonesa për kategorinë biznes. Gjithashtu konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ë”, pika 3, neni 12 në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c” dhe pika 10 në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më shumë për vlerën 9,33,364 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit në këtë llogari të disa makinerive, si 1 ekskavator, 1 fadromë, 1 rul, 2 rimorkiator dhe 1 makineri, të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë nr.214. Për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%) dhe jo (20%). Gjithashtu konstatohet se në llogarinë nr.215 nuk është bërë shtesë vlera prej 425,000 lekë, për riparimin e makinës teknologjike modeli “Renault”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, paisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 214 dhe Shkronjën “b”, pikën 2, Klasën 2 “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtim kontabël) në udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 183,672,132 lekë, vlera e aksioneve në shoqërinë aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Kolonjë Sh.A” me NIPT K...O, si dhe vlera e aksioneve në shoqërinë “K” Sh.A. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”; Kreun 3.1, pika 31, shkronja “b” në udhëzimin nr.5

datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 1,625,303 lekë, për garanci të cilave i ka kaluar afati dhe duhet t’u kthehen subjekteve përkatëse³². Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4” në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorin e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 231 “Investime në proces”, e cila përfaqëson shpenzime për investime në proces, u konstatua se kjo llogari, është mbivlerësuar për vlerën 70,993,843 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit të gabuar të:

-10,266,313 lekë (investime në ndërtesa), vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë nr.212 dhe 19,950,000 lekë (investime në ujësjellës), vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë nr.213, vlerë e cila përfaqëson shpenzime për investime të përfunduara, për të cilat është bërë kolaudimi/marrja në dorëzim (pra janë të shfrytëzueshme dhe në përdorim) por të pakapitalizuara në llogaritë e klasës 2 AAGJ.

-40,777,530 lekë (garanci punimesh), vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë nr.520, pasi janë disponibilitete në thesar. Gjithashtu konstatohet se llogaria nr.231 është nënvlerësuar për shumën 252,499,750 lekë, vlera e mbetur e investimit për ndërtimin e ujësjellësit të qytetit të Ersekës dhe të disa fshatrave nga burimet e Kozelit. Në fund të vitit 2021, subjekti që ka kryer punimet e ndërtimit ka situacionuar të gjithë vlerën e punimeve, pra duke përfunduar punimet në terren, ndërkohë që nga vlera e plotë e investimit, deri në 31.12.2021, është likuiduar vlera prej 244,599,988 lekë. Pra në kushtet e mësipërme, vlera e mbetur debitohet në llogarinë nr.231, duke kredituar llogarinë nr.404 dhe debituar llogarinë nr.4342, pasi këto fonde priten të alokohen nga buxheti i shtetit dhe jo i Bashkisë Kolonjë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun 2, klasa 2 në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr.

³² Llogaria 466 për garancitë që i ka kaluar afati, pasqyrohet në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.4” të raportit përfundimtar të auditimit.

213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitetit afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore”, u konstatua se janë kontabilizuar si AQT, objektet “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” për vlerën 99,965,404 lekë dhe “Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave nga burimet e Kozelit”, për vlerën 94,619,989 lekë, të cilat në datë 31.12.2021 janë në statusin “investime në proces”, pasi akoma nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Kolonjë. Gjithashtu konstatohet se në llogarinë nr.213, nuk është kapitalizuar edhe vlera e mbetur e investimit me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit”, për shumën 19,950,000 lekë, e cila qëndron e kontabilizuar në llogarinë nr.231, si investim në proces, ndërkohë që ky objekt është marrë në dorëzim për vlerën e plotë të tij më datë 13.10.2021, si dhe nuk është bërë shtesë vlera prej 925,000 lekë, investim për riparimin e sifonit në kanalim ujitës të fshatit Borovë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “b”, pikën 2, Klasën 2 “Aktivet afatgjata”³³ (përbërja dhe trajtim kontabël) në udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.213, duke kryer veprimet e nevojshme në debi/kredi të llogarisë nr.231 dhe llogarisë 101 “Fondet bazë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, u konstatua se nuk është bërë shtesë vlera prej 660,000 lekë, investim për riparimin e taracave në shkollat 9-vjeçare Barmash dhe Qinam. Gjithashtu konstatohet se në llogarinë nr.212, nuk është kapitalizuar edhe vlera e mbetur e investimit me objekt “Rikonstruksion banese sociale në Leskovik”, për shumën 7,827,049 lekë, e cila qëndron e kontabilizuar në llogarinë nr.231, si investim në proces, ndërkohë që ky objekt është marrë në dorëzim për vlerën e plotë të tij më datë 14.04.2021, si dhe vlera prej 2,439,264 lekë, për blerjen e materialeve të ndërtimit për rikonstruksionin e qendrës multifunksionale të qytetit Ersekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “b”, pikën 2, Klasën 2 “Aktivet afatgjata”³⁴ (përbërja dhe trajtim kontabël) në udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.212, duke kryer veprimet e nevojshme në debi/kredi të llogarisë nr.231 dhe llogarisë 101 “Fondet bazë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit, kontabilizimit dhe regjistrimit në kadastër të aseteve në pronësi të Bashkisë Kolonjë, të tokave, trojeve, terreneve, pyjeve, kullotave, ndërtesave dhe konstruksioneve, në mënyrë të përmbledhur u

³³ Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivët afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

³⁴ Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivët afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

konstatua se nuk është kryer inventarizimi i tyre; Objektet e kontabilizuara nuk pasqyrohen me emërtimet e tyre, por vetëm me mbishkrimin “Toka, troje dhe terrene”, pra nuk identifikohet përbërja e kësaj llogarie dhe saktësia e veprimeve kontabël; Rregjistri që mbahet nga Drejtoria e Financës për këtë llogari, nuk është i plotë me informacion, pasi mungon informacioni për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës etj; Nuk është kryer kontabilizimi i trojeve të lira dhe ato të zëna me ndërtesat, që sipas rastit i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Kolonjë, nëpërmjet akteve ligjore/nënligjore, si dhe për më tepër ato troje të cilat janë pajisur edhe me certifikatë pronësie; Nga 3527 pasuri në pronësi të Bashkisë Kolonjë, rreth 28 prona ose 1% prej tyre janë regjistruar në kadastrë dhe janë pajisur me certifikatë pronësie.

-Veç sa më sipër konstatohet se Bashkia Kolonjë nuk ka një punonjës/strukturë të posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 35, nenin 37, nenin 41 dhe nenin 44 në Ligjin nr. 20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 6 në Ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; Nenin 62 në Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Nenin 9 dhe nenin 12 në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM Nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Kapitulli III, pika 30 dhe paragrafi 104 në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorin e Financës të planifikojë në buxhet një fond të detajuar për kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve nga ekspertë vlerësues të licencuar.

Në ndryshimet për buxhetin e vitit 2023

10.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të nxjerrë urdhër të brendshëm, për përcaktimin e afatit konkret si dhe ngritjen e një strukture të posaçme, me objekt vetëm inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

10.3.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, për:
- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene”, nr.211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”.

- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-31.12.2021, për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 3 raste, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht

vendosja e kriterëve për kualifikim (si kërkesa për certifikatat e standardizimit, numrin e punonjësve, të makinerive, kategorive të licencave të zbatimit të punimeve etj). Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”; Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, Shkronjën “b” të pikës 3 në nenin 15, pikën 4 në nenin 39, pikën 1 të nenit 40, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Në procedurat e prokurimit për vitin 2023 dhe në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-31.12.2021, u konstatua se në 1 rast, OE është shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; Pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorit ekonomik, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-31.12.2021, u konstatua se në:

- Në 14 raste nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit;
- Në 14 raste urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokollin, si dhe në 11 raste nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;
- Në 14 raste ftesa për ofertë nuk ka nr., protokollin dhe datë;
- Në 14 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;
- Në 14 raste dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- Në 12 raste nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përllogaritur fondin limit;
- Në 7 raste afati i lëvrimin të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, si dhe nga Komisioni i blerjeve të vogla nuk është përllogaritur penalitet;
- Në 1 rast nuk dokumentohet procesverbali për tërheqjen e OE shpallur fitues dhe për kalimin tek OE i radhës;
- Në 1 rast nuk administrohet procesverbali i marrjes në dorëzim të projekt zbatimit për hartimin e planit të mbarë-shtrimin të fondit pyjor kullësor për vitin 2021. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat “dh”, “e” dhe “ë” të pikës 2 në nenin 26, pikën 1 të nenit 27, pikën 3 të nenit 40, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pikën 3 në nenin 74, nenin 76, nenin 77 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar; Pikën 7, 8 dhe 17 në udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e

procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”; Pika 5 dhe pika 6 në Udhëzimin nr. 8 datë 01.09.2021 “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

Në vijimësi

13.2. Rekomandimi: Gjithashtu për 7 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përlllogaritet penaliteti përkatës dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme përgjatë periudhës 01.07.2021-31.12.2021, u konstatua se:

-Në Bashkinë Kolonjë funksioni i kontrollit të territorit, kryhet nga zyra e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në varësi të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Pra nuk është krijuar Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, në varësi direkte nga organi ekzekutiv i bashkisë (pra Kryetari të Bashkisë Kolonjë);

-Numri i punonjësve në zyrën e kontrollit, nuk është në përputhje me përcaktimet e kuadrit rregullator, pasi nga 3 punonjës minimalisht që duhet të ketë kjo strukturë, në fakt janë vetëm 2 punonjës, si dhe nga niveli drejtues i Bashkisë Kolonjë, nuk janë marrë masa për plotësimin e kësaj strukture dhe ushtrimin e funksionit të inspektimit në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës;

-Në strukturën e zyrës së kontrollit nuk ka punonjës me formimin profesional të fushës, si inxhinier ndërtimi, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë dhe hidrogeologjisë;

- Kryeinspektori i zyrës së kontrollit nuk ka miratuar asnjë akt-kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, sipas fazave të punimeve (Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues deri në përfundimin e sistemit të jashtëm);

-Kryeinspektori i zyrës së kontrollit nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, gjatë ushtrimit të detyrave;

-Programi vjetor i punës për zyrën e kontrollit nuk është miratuar nga organi ekzekutiv i bashkisë (Kryetari i Bashkisë);

-Nuk dokumentohet kryerja e inspektimeve pranë subjekteve të cilët përgjatë vitit 2021 kanë kryer punime ndërtimi, me qëllim verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga zotëruesit e mbetjeve inerte, gjatë prodhimit, përpunimit dhe dorëzimit të tyre pranë subjekteve të cilat janë të pajisura me leje mjedisore;

-Ndërmjet zyrës së kontrollit dhe drejtorisë së urbanistikës, ka munguar bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit;

-Për 2 raste, bazuar në ankesat e administruara pranë Bashkisë Kolonjë, për ndërtime të paligjshme, nga zyra e kontrollit nuk është kryer inspektim për verifikimin e situatës sipas ankesës së dorëzuar pranë Bashkisë Kolonjë;

-Në 4 raste, në kryerjen e veprimeve inspektuese, për verifikimin e ankesave të administruara pranë Bashkisë Kolonjë, nuk janë përdorur formatet standarde të inspektimit, si procesverbal konstatimi, pezullimi, prishje ndërtimi, por veprimet inspektuese janë pasqyruar në letër formati A4 dhe me shkrim dore;

-Në 3 raste, konstatohet se nuk dokumentohet procedura e prishjes së punimeve pa leje, si dhe 1 prej këtyre rasteve, nga zyra e kontrollit nuk janë përlllogaritur shpenzimet e prishjes së punimeve dhe rikthimin e territorit në gjëndjen e mëparshme, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me punime në hapësirë publike, ndërtimi i murit i cili ka prekur trupin e rrugës;

-Në 4 raste, edhe pse është lënë detyrë për prishjen e punimeve pa leje dhe/ose të dorëzimit të

dokumentacionit, konstatohet se nuk administrohet dokumentacioni i dorëzuar nga palët, të cilat janë ngarkuar me detyrimin për të dorëzuar dokumentacionin përkatës, për efekt justifikimi ligjor të punimeve të ndërtimit, si dhe nga zyra e kontrollit nuk është kryer inspektim për verifikimin e plotësimit të detyrave të lëna, pra të prishjes së punimeve të ndërtimeve pa leje. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 3, nenin 4, nenin 5, nenin 11, pikat 5, 6, 7, 8 në nenin 12, nenin 13, në Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Nenin 1, në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Pikat 1, 2, dhe 4 në nenin 51 në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Nenin 5, pikën 1 në nenin 9, pikën 3 të nenit 24, shkronjat “a” dhe “c” në pikën 1, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 31, pikat 4 dhe 5 në nenin 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 11 të Ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pikën 1 germa b/ii, pikën 2, shkronjën “b”, pikat 4 dhe 6 në VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 98-105, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për:

- Krijimin dhe funksionimin e strukturës së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në nivel Inspektorati dhe jo si zyrë kontrolli, për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.
- Rekrutimin në stafin e IMTV të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023

14.2.Rekomandimi: Zyra e kontrollit Bashkia Kolonjë, të marrë masat për kryerjen e inspektimit, për verifikimin e situatës së krijuar, bazuar në 2 ankesat e administruara në Bashkinë Kolonjë, konkretisht nga shtetasi V.K me shkresën nr.4700 prot., datë 28.09.2021 dhe shtetase V.A me shkresën nr.3639 prot., datë 27.07.2021, si dhe të denoncimeve të përcjella nëpërmjet shkresave nr.5179 prot., datë 28.10.2021 dhe nr.4871 prot., datë 07.10.2021 të administruar nga IKMT Drejtoria Rajonale Korçë.

Menjëherë

14.3.Rekomandimi: Zyra e kontrollit Bashkia Kolonjë, për praktikën e inspektimeve të kryera bazuar në ankesat e administruara nga shtetasit M.I, A.M, S.V, K.P, A.J, të marrë masat e nevojshme, për kryerjen e inspektimit pranë subjekteve përkatëse, me qëllim verifikimin e respektimit të detyrimit të lënë për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme, si dhe dokumentimin e plotë të procedurës së ndjekur, deri në kthim-përgjigjen ndaj palëve të interesuara. Gjithashtu për rastin ku janë kryer punime ndërtimi të paligjshme në hapësirë publike, zyra e kontrollit të bëjë përllogaritjen e shpenzimeve të rikthimit të territorit në gjëndjen e mëparshme, duke njoftuar subjektin për likuidimin e dëmit, në natyrë/vlerë monetare.

Menjëherë

14.4.Rekomandimi: Zyra e kontrollit Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, për kryerjen e inspektimeve duke përdorur dokumentet standard të procedurës së inspektimit. Gjithashtu të hartojë dhe përcjellë për miratim pranë Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, planin vjetor të aktivitetit.

Në vijimësi

14.5.Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Zyra e Kontrollit Bashkia Kolonjë të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, ku për çdo leje ndërtimi të miratuar/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, të informohet edhe Zyra e Kontrollit, me qëllim

miratimin e akt-kontrolleve për lejet e ndërtimit, si dhe rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Kolonjë.

Për lejet e miratuara përgjatë vitit 2022 dhe në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2021-2023, u konstatua se:

- Procedura e përgatitjes së PBA 2021-2023 nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kolonjë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2021-2023, janë miratuar jashtë afateve;

- Në buxhetin vjetor të vitit 2021 nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë dhe Drejtoria e Financës, gjatë hartimit dhe miratimit të PBA-së, të marrin masat për:

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

-Planifikimin e fondeve për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kolonjë.

Në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2021 paraqitet masën 93%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kolonjë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021, u konstatua se janë të pa likuiduara gjithsej 7 fatura për vlerën totale 5,281 mijë lekë, nga të cilat 5 fatura të palikujduara janë krijuar në vitin 2021 në vlerën totale 2,448 mijë lekë. Në fund të vitit 2021 të ardhurat e trashëguara për vitin 2022 janë në vlerën 23,331 mijë lekë,

ose detyrimet e prapambetura zënë 10% të tyre, ç'ka do të thotë se Bashkia Kolonjë mund të likujdojë detyrimet e prapambetura.

-Gjithashtu sa i përket respektimit të radhës së likujdimit të detyrimeve të prapambetura (pra fatura e parë likujdohet më parë), u konstatua se nuk është respektuar ky kriter ligjor në 3 raste. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “gj” në nenin 12 të Ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, pikat 8, 106 dhe 107 të udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likujdimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe likujdimin e tyre gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve në dispozicion.

Përgjatë vitit buxhetor 2023

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekuara nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kolonjë, për miratimin e lejeve të ndërtimit/deklarata paraprake për kryerjen e punimeve, u konstatua se në:

-3 raste subjektet janë pajisur me deklaratë paraprake për kryerje punimesh, ndërkohë që kanë qenë në kushtet e kryerjes së punimeve që kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe jo deklaratë paraprake për kryerje punimesh.

-1 rast është miratuar leja e ndërtimit në kushtet e mungesës së dokumentacionit të plotë në formë dhe përmbajtje, si dhe në kundërshtim me tipologjinë e ndërtimit që lejohet në njësinë strukturore përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 93-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

18.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të munguar në lejen e ndërtimit të miratuar përgjatë vitit 2021, si dhe bashkërendimin e punës, vlerësimin dhe marrjen në konsideratë të mendimeve të autoriteteve publike kompetente gjatë aplikimit deri në miratimin e lejes së ndërtimit/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratave për punë publike, respektivisht:

-“Rikonstrukcion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut”,

- “Rikonstrukcioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë”, rezultoi se, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kolonjë, nuk është miratuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore, për projektin e zbatimit, veprim ky në kundërshtim me Nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

19.1.Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa që të pajisin me leje ndërtimi infrastrukturore për çdo projekt zbatimi sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën “b” në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “b” në pikën 1.1 dhe shkronjën “c” në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën “gj” në nenin 64, në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i

procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Kolonjë në vlerën **8,211,344 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut”, me vlerë 274,456,182.47 lekë me TVSH, fituar nga BOE “A “& “4” Sh.P.K, rezultuan diferenca në volume dhe punime ndërtimi të pakryera, në vlerën **5,333,249 lekë pa TVSH, përkatësisht:**

- Vlera **942,303 lekë**, përfaqëson dëm ekonomik për punime ndërtimi të pakryera në vepër, për zërat “(2.373) Vetrato xhami i temperuar brenda godinës” dhe “(3.An/56) F. Montim shtyllë konike 9 ml, LED me dy krahë çdo 30 ml përfshirë të gjithë aksesoret e nevojshëm”.

- Vlera **4,390,946 lekë**, përfaqëson dëm ekonomik për diferenca në volume punime ndërtimi, për pajisje hidraulike dhe mosfunksionim të Scadës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 2104 Prot., datë 08.06.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kolonjë dhe BOE “A “& “4” Sh.P.K. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **942,303 lekë pa TVSH** nga shoqëria BOE “A “& “4” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 2104 Prot., datë 08.06.2020 me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” Bashkia Kolonjë.

1.2. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe grupin e kolauditimit të punimeve si dhe Ndërmarrjen e Ujësjetllës Kanalizime Sh.A Kolonjë në cilësinë e administrimit të investimit, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pa vendosura në objekt.

-Gjithashtu të marrë masa për vendosjen e pajisjeve dhe funksionimin e scadës, në të kundërt arkëtimin e vlerës **4,390,946 lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë”, me vlerë 75,131,311 lekë me TVSH, fituar nga BOE “K“ & “A” Sh.P.K, rezultuan diferenca në volume dhe punime ndërtimi, në vlerën **1,264,272 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7207/13 prot., datë 13.09.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kolonjë dhe BOE “K “& “A” Sh.P.K. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, ku rezultuan punime të pakryera, me qëllim arkëtimin e vlerës **1,264,272 lekë**.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës”, me vlerë 391,298,650 lekë me TVSH, fituar nga OE “A” SHPK, rezultuan diferenca në volume dhe punime ndërtimi të pakryera, në vlerën **1,323,023 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 1022 Prot., datë 25.02.202, lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor (Bashkisë Kolonjë) dhe sipërmarrësit të punimeve, shoqërisë “A” Sh.P.K. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **1,323,023 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE “A” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 1022

Prot., datë 25.02.2021 me objekt “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës” Bashkia Kolonjë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit” Bashkia Kolonjë, me vlerë 497,280,095 lekë me TVSH, fituar nga OE “A” Sh.P.K, rezultuan diferenca në volume dhe punime ndërtimi, në vlerën **290,800 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5151 prot., datë 29.10.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kolonjë dhe OE “A.N.K” Sh.P.K. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **290,800 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE “A” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 5151 Prot., datë 29.10.2020 me objekt “Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit” Bashkia Kolonjë.

Menjëherë

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Kolonjë për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 1,239,977 lekë, për 4 raste, *të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet*, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për praktika likuidimi të vendimeve gjyqësore të përzgjedhura në mënyrë rastësore, u konstatua se janë kryer likuidime pjesore, megjithëse Bashkia Kolonjë ka pasur disponibilitete në thesar. Gjithashtu në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna, moslikuidimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbarimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Kolonjë. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2023 dhe në vijimësi

1.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

C.1 MASA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2021, u konstatua se në fillim të vitit 2021 kanë qenë debitor 28 subjekte të biznesit të madh në vlerën 4,622,879 lekë, 67 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 3,436,058 lekë dhe 1 institucion në vlerën 661,339 lekë. Në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive rezultojnë debitor, 31 subjekte të biznesit të madh në vlerën 5,935,411 lekë, 85 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 4,369,959 lekë, 1 institucion në vlerën 754,139 lekë dhe 1 subjekt (NIPT sekondar) për tarifat vendore sipas kohëzgjatjes së kantierit në vlerën 130,794 lekë, pra gjithësej **11,190,303 lekë** për **118 subjekte**, pra **gjatë vitit 2021 janë krijuar 38 subjekte debitorë** për vlerën **2,246,433 lekë**, nga të cilët **21 subjekte** rezultojnë debitor për herë të parë, ndërkohë që **17 subjekte** të tjerë janë debitor edhe në vitet e mëparshme, veç debisë së krijuar në vitin 2021. Për debitorët të krijuar brenda vitit 2021 nuk është përlloritur rast pas rasti kamatvonesë për subjektet debitore. Gjithashtu për subjektet nuk janë marrë masa shtrënguese, bllokim të llogarisë bankare, kufizim të pasurisë së paluajtshme, aktivitetit etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76, nenin 114 dhe nenin 117 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, neni 26, neni 34 në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Nenin 64 në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Paketën fiskale të vitit 2020 të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës **11,190,303 lekë** për **118 subjekte** (principal dhe kamatë vonesë).

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga DATT Bashkia Kolonjë, regjistrin të taksave dhe tarifave vendore për subjektet që kanë ushtruar aktivitetet në vitin 2021 në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, si dhe kryqëzimi i informacionit me databasën e DRT Korçë për subjektet me statusin “aktiv” për vitin 2021, u konstatuan mangësi në informacionin e administruar nga DATT Bashkia Kolonjë. Konkretisht mangësitë u konstatuan mosadministrimin e informacionit për **11** subjekte që kanë ushtruar aktivitetet në Bashkinë Kolonjë, si dhe për disa subjekte të cilat janë biznes i madh, në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore administrohen si biznes i vogël³⁵.

-Sa më sipër konstatohet se për vitin 2021, në 11 raste subjekte të kategorisë “biznes i madh” dhe “biznes i vogël” në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, nuk janë taksuar saktë/aspak, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 329,666 lekë.

-Veç sa më sipër regjistri i taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “biznes” sa i përket taksës së ndërtesës, duke patur në konsideratë përcaktimet e bëra në VKM nr. 132, datë 7.3.2018³⁶, e ndryshuar, ka mangësi në gjeneralitetet si, sipërfaqen dhe katet e objektit, nëse ka raste ku objekti është mbi një kat dhe njëri prej kateve shfrytëzohet për banim ndërkohë kati tjetër për veprimtari ekonomike etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenet 20-25 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” dhe Kreu II.1 dhe II.2 në

³⁵ Pasqyruar lista e subjekteve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

³⁶ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

Paketën Fiskale të Bashkisë Kolonjë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave të marrë masat e nevojshme, për saktësimin e informacionit për subjektet e mësipërme, në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore, me qëllim taksimin e drejtë dhe të plotë të tyre, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 329,666 lekë ndaj 11 subjekteve.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2021, u konstatua se në fund të vitit 2020 në mënyrë progresive janë 4396 familje debitorë për vlerën 26,424,512 lekë dhe në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive janë **3653** familje debitorë për vlerën **33,065,205 lekë**, nga të cilat, në vitin 2021 është krijuar **6,640,693 lekë debi**. Pra në krahasim me vitin 2020, në fund të vitit 2021 kemi rritje të vlerës debitorë për taksat dhe tarifave për kategorinë “familje”, ç’ka tregon për performancë të dobët të Bashkisë Kolonjë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme. Sa i përket familjeve debitorë, rezultojnë se nuk janë marrë masa (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitorë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4, nenet 20-24 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 33,065,205 lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tatim-Taksave për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” rezultoi se në Bashkinë Kolonjë dhe NJA për vitin 2021 janë taksuar 5922 familje. Me qëllim vlerësimin nëse është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga struktura e mësipërme me informacionin e gjendjes civile. Nga përlllogaritjet e kryera, rezultoi se për vitin 2021 janë taksuar 585 familje më pak.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Kolonjë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e pastrimit, ndriçimit, dhe turizmit (duke aplikuar tarifave më të ulëta në vlerë dhe mesatarizuar tarifën), për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 900 lekë * 585 familje mesatarisht taksuar më pak = 526,500 lekë planifikuar më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se DATT Bashkia Kolonjë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM nr. 132, datë 7.3.2018³⁷, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezultojnë se për arkëtimin e taksave të familjeve Bashkia Kolonjë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A Ersekë, i cili vepron si agjent tatimor për llogari të Bashkisë Kolonjë. Grupi i auditimit bëri kërkesë për numrin e

³⁷ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

familjeve, të cilat janë të pajisura me matës (pra kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë) ku rezultoi se 1861 familje nuk kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë, ç'ka do të thotë se taksat dhe tarifat vendore për këtë numër familjesh arkëtohen vetëm kur familjet marrin shërbime të ndryshme, si vërtetime etj, të paguajnë taksat dhe tarifat familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenin 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Kreu II.1 dhe II.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kolonjë dhe nenin 62 dhe 63 në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Bashkisë Kolonjë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të marrë masat e nevojshme, për arkëtimin e taksave për 1861 familje, të cilat nuk kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe për rrjedhojë nga agjenti tatimor Ujësjiellës-Kanalizime Sh.A Ersekë, nuk mundësohet arkëtimi i tyre.

4.2.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave Bashkia Kolonjë në bashkëpunim me Administratorët e Njësisë Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2021, rezultojnë 526,500 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tatim-Taksave për planifikimin e taksës për tokën bujqësore, rezultoi se taksa e tokës bujqësore është planifikuar 4,659,000 lekë për vitin 2021. Nga përllogaritjet e kryera, bazuar në kategorinë e bonitetit, sipërfaqen e tokës bujqësore, u konstatua se planifikimi i taksës së tokës bujqësore për vitin 2021 është bërë për 466,794 lekë më pak. Pra për 7215 Ha tokë bujqësore e ndarë me AMTP, planifikimi i taksës së tokës bujqësore duhet të ishte 5,050,500 lekë.

-Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave Bashkia Kolonjë në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mbrotjes së Konsumatorit, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 466,794 lekë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Kolonjë (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Kolonjë) u konstatua se nga DATT, Bashkia Kolonjë, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e bashkisë. Nga përllogaritjet e kryera rezultoi se për vitin 2021 në 6 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit në

vlerën 265,527 lekë gjithësej, si dhe 130,794 lekë 1 subjekt që nuk ka kryer likuidimin e tarifës së kantierit, gjithësej 396,321 lekë vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kolonjë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun II.1 dhe II.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kolonjë të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 15-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave Bashkia Kolonjë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore 396,321 lekë, ndaj 6 subjekteve.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kolonjë me palët e treta, konkretisht të respektimit të detyrimit kontraktor për pagesën e qirasë (për vitin 2021), përlllogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se në vitin 2021, janë krijuar 14 subjekte debitorë për vlerën 3,297,780 lekë, si dhe progresivisht në fund të vitit 2021 janë 23 subjekte për vlerën 32,522,494 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e këtyre subjekteve, konstatohet se nuk janë njoftuar subjektet për zgjidhje të njëanshme të kontratës së qirasë, si dhe nuk është hapur proces gjyqësor, me qëllim mbledhjen e detyrimeve me forcë nëpërmjet shërbimit të përmbarimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 296 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikën 4 të nenit 13 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Nenin 63 në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e Bashkisë Kolonjë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave Bashkia Kolonjë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore 32,522,494 lekë (principal dhe kamatë vonesë).

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2021 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 182,500 lekë, nga të cilat në vitin 2021 janë 24 gjoba në vlerën 126,500 lekë. Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse³⁸. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar; Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me sektorin e policisë bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 182,500 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

³⁸ Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, “Për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmuajor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative"; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

V.ANEKSE

Aneksi nr.1 – Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin trajtuar nga faqja nr.15 deri në faqen nr.17 të raportit përfundimtar të auditimit.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1: *“Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.*

- Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

- Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

- Për vitin 2021 ka qenë në fuqi Rregullore e Brendshme miratuar me Vendimin nr. 28, datë 29.04.2020 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me ndryshimet në rregullore. Nuk është miratuar Kodi i Etikës, por rregullat mbi etikën përshkruhen në rregulloren e brendshme, neni 30, Kreu III.

- Nga institucioni nuk ka program trajnimi të dedikuar për integritetin dhe sjelljen etike.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk është përcaktuar procedura e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, si dhe janë përcaktuar detyrat për njësinë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.

-Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Kolonjë për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrdhënieve me Publikun), duke i'u adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën.

- Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Për vitin 2021 janë kryer vlerësimet e punonjësve.

Në lidhje me parimin 2: *“Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”.*

- Për vitin 2021, me nr. 267 prot., datë 14.01.2021 është miratuar plan-veprimi për MFK, i cili ka të përfshirë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

- Për vitin 2021, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 - muaj, si dhe ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga struktura në varësi të saj, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi të fondeve të alokuara.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3: *“Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.*

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar struktura e Bashkisë Kolonjë, ç’ka ndikon negativisht në linja të qarta raportimi, komunikimi dhe llogaridhënie.

- Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë, konkretisht sektori i menaxhimit të kontratave me sektorin e taksave dhe tarifave vendore, me qëllim shkëmbimin e informacionit sa kontrata për punë publike janë lidhur, subjektet, si dhe nëse këta të fundit janë me seli kryesore në Bashkinë Kolonjë apo duhet të pajisen me NIPT sekondar, duke vijuar me tarifimin e tyre nga sektori i taksave dhe tarifave. Kjo mangësi evidentohet edhe në mungesën e komunikimit ndërmjet sektorit të urbanistikës dhe sektorit të taksave dhe tarifave vendore, me qëllim shkëmbimin e informacionit për subjektet të cilat janë pajisur me leje për kryerjen e punimeve ndërtimore dhe që duhet të pajisen me NIPT sekondar, për të ushtruar aktivitet në Bashkinë Kolonjë.

- Lidhur me strukturën organizative të Bashkisë Kolonjë, ndërmarrjes dhe institucioneve në varësi, përgjatë vitit 2021 nuk ka pasur ndryshime.

Për vitin 2021, numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 172 datë 23.12.2020. Miratuar në total numri 285 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara konfirmuar nga prefekti i qarkut Korçë, me shkresën nr. 1104/1 prot., datë 08.01.2021, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist.

- Mungon raporti i vlerësimit nga njëësia e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike.

Në lidhje me parimin 4: *“Njëësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave”.*

- Në Bashkinë Kolonjë nuk është hartuar *“Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”*, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme, por vetëm nga trajnimet e zhvilluara nga ASPA.

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si përgjegjës i sektorit të financës.

Në lidhje me parimin 5: *“Njëësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.*

- Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar *“Delegimi i kompetencave”* në zbatim të ligjit 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative”* si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin e institucionit rezulton se, nga NA për periudhën objekt auditimi nuk ka patur raste të delegimit të detyrave.

- Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor”*, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 *“Për financat e vetëqeverisjes vendore”*, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 *“Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 *“Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”*.

Për vitin 2021, me Urdhër të kryetarit të Bashkisë nr. 01 datë 05.01.2021 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaximit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”.

Në lidhje me parimin 6: *“Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre”.*

- Nga Bashkia Kolonjë përcaktohen objektiva sasior (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxhetet vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 *“Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.*

Në lidhje me parimin 7: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.*

- Janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

- Është hartuar regjistri i riskut, ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut, por nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut. Mbetet problematikë menaxhimi i riskut, pasi nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e proceseve të punës të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

- Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillen institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar ku citohet se: *“Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.*

- Në Bashkinë Kolonjë, Sektori i Financës dhe Buxhetit për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin Excel, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Në lidhje me parimin 8: *“Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.*

-Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.*

Bashkia Kolonjë nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: *“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.*

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për cdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhërshpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit, hartimi dhe rregjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.
- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimve/shërbimeve.
- Për çdo vit buxhetor hartohet rregjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.
- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.
- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur rregjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.
- Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjesimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, procesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe procesverbalet për asgjesimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.
- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Kolonjë, si dhe veprimeve me arkën, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave (taksat e ndara) arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.
- Bashkia Kolonjë në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia. Në lidhje me parimin 11: *“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”*.
- Bashkia Kolonjë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.
- Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Komunitetin.
- Në Bashkinë Kolonjë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.
- Në strukturën e Bashkisë Kolonjë është vetëm 1 specialist IT, duke sjellë që i njëjti person të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI-së.

Në lidhje me parimin 12: *“Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.*

- Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, kjo evidentuar nga lista e projekteve në PBA 2021-2023, të cilët nuk i nënshtrohen një analize kosto-përfitim.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditareve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga përgjegjësi i sektorit. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e sektorit të financës.

- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”, i ndryshuar). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: *“Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.*

Bashkia Kolonjë disponon faqen e saj zyrtare në web www.kolonja.gov.al ku pasqyrohet aktiviteti i saj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

Për vitin 2021 nga Bashkia Kolonjë (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajshme me qira, buxhetin etj.), nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.

Në lidhje me parimin 14: *“Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor”.* Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e komunikimit brenda institucionit.

Në lidhje me parimin 15: *“Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm”.*

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email. Grupi auditues konstaton se, nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email-it zyrtar të institucionit duke qënë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Në lidhje me parimin 16: *“Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.*

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë

dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

-Bashkia Kolonjë lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë për vitin 2021 ka raportuar në MFE me nr. 983 prot., datë 28.04.2021.

-Ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit e hartuar me nr. 267 prot., datë 14.01.2021.

Në lidhje me parimin 17: *“Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.*

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

“Mjedisi i kontrollit”

-Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

- Nuk janë përcaktuar objektivat konkret dhe të matshëm për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

- Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen etike.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.

- Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- Në Bashkinë Kolonjë nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

“Menaxhimi i Riskut”

- Në Bashkinë Kolonjë është krijuar regjistri i riskut, por nuk është përditësuar minimalisht dy herë në vit. Gjithashtu nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut. Mbetet problematikë menaxhimi i riskut, pasi nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e proceseve të punës të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

- Në Bashkinë Kolonjë, Drejtoria Financës nuk përdor program të licencuar për mbajtjen e kontabilitetit por operon me programin “EXCEL” ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengojn marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Kolonjë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

-Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

- Në Bashkinë Kolonjë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT

për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish, si dhe nuk ka sisteme kompjuterike të liçencuara.

- Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

- Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit. Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Në Bashkinë Kolonjë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

-Në Bashkinë Kolonjë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Aneksi nr.2 – Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit trajtuar nga faqja nr.20 deri në faqen nr.32 të raportit përfundimtar të auditimit.

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2021 për mallrat dhe shërbimet (Nga të ardhurat e veta + transfertën e pakushtëzuar)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Numri i faturës	Data e Faturës	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2020	Shtesat gjate vitit 2021	Shlyerjet gjatë vitit 2021	Gjendja 31.12.2021
1	Shërbime Operative	260	17.06.2020		1,581,322		1,581,322
2	Mirmbajtje Automjetesh	520,521	10.09.2018,14.09.2018	120,915			120,915
3	Blerje Pelet per ngrohje	82	19.11.2018	45,105			45,105
	Totali i detyrimit						1,747,342

Lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për dëmshpërblim page, për punonjësit e larguar nga puna.

Vendim Gjykatë nr. datë	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas Vendimit te Gjykatës	Gjendja e palikujduara 31/12/2020	Vendime të ardhura gjatë vitit 2021		Likujduar gjate vitit 2021	Mbetja date 31.12.2021
				Nr dhe data e vendimit	Vlera e vendimit		
2	3	4	5	6	7	8	9=5+7-8
Nr. 270 04.03.2021	Demshperblim page punonjesit e larguar nga puna			Nr. 270 04.03.2021	137,110		137,110
28 30.10.2020	Demshperblim page punonjesit e larguar nga puna	573,200	573,200			250,000	323,200
							460,310

Lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për mbi pagesat e vendimet gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme

Vendim Gjykatë datë	nr.	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas Vendimit të Gjykatës	Gjendja palikujduara 31/12/2020	Vendime të ardhura gjatë vitit 2021		Likujduar gjatë vitit 2021	Mbetja date 31.12.2021
					Nr dhe data e vendimit	Vlera e vendimit		
2		3	4	5	6	7	8	9=5+7-8
89(91) Datë 09.03.2016		Vendime gjyqesore ceshtje te tjera	16,568,517	6,868,517			3,794,715	2,351,227
Nr. 7086 Datë 07.09.2018		Vendime gjyqesore ceshtje te tjera	722,575	722,575			722,575	722,575
								3,073,802

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Aneksi nr.3 – Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave trajtuar nga faqja nr.32 deri në faqen nr.43 të raportit përfundimtar të auditimit.

Plani dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2021

	Emërtimi	Plani	Fakti	
1	Taksë pasurie	4,901	3,056	Në %
2	Takse mbi Truallin	58	-	
3	T. vendore, biznesi vogel	275	22	
4	Tak. Regjistrim Automjete	2,775	4,253	
5	Takse Nd. Ne infra. (Nd te reja)	3,300	3,010	
6	Te ardh nga hotele	110	-	
7	Takse per Tabele dhe Reklame	359	601	
8	Takse Kontrolli Veterinar	4	6	
9	Tap	900	3,196	
10	Renta Minerare	50	7	
11	Taksa mbi token bujqesore	4,659	3,523	
12	Tarife Pastrimi	9,193	10,385	
13	Tar. Nd. Urban e mirembajtje	4,943	5,341	
14	Tar.Zenie Hap Publike	397	342	
15	Tregu	798	550	
16	Tarife Parkim automjete	220	189	
17	Tarife regjstrim biznesi	35	55	
18	Tarife per leje a certificate	160	208	
19	Tarife Sherb. Administ Gj.civil	514	1,714	
20	Tarife kullote + pyjore	3,667	1,891	
21	Tarife dru zjarri	23,816	9,924	
22	Ujitje dhe Kullim	230	300	
23	Tarifë peshkimi	100	-	
24	Hece	4,000	3,679	
25	Qera Antene	7,000	5,980	
26	Toka me Qera	805	3,754	
27	Fond pyjor me qera	450	-	
28	Prodhime te dyta pyjore	200	-	
29	Tarife sherbim per Qytetaret mjete	20	-	
30	Tarife E perkohshme Turizmi	2,067	1,692	
31	Tarife per Linja Nentokesore Ajrore	100	-	
32	Takse Prone Private Pyll.kullote	812	52	
33	Gjoha	200	465	
34	Te ardhura nga dhenia me qera e aseteteve te bashkise	72	127	
35	Te Ardhura nga Shitja e mallrave dhe sherbimeve, aseteteve te bashkise	-	225	
36	Detyrime te pa mbledhura ne vite	3,080	499	
37	Biblotekë muze	70	50	
38	Te Ardhura Kultura	130	33	
	Total	80,470	65,129	81%

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Subjektet për të cilat nuk administrohet plotësisht dhe/ose saktësisht informacion

Nr	NJA	Statusi sipas Bashkisë	Statusi sipas QKB dhe DRT Korçë	Lloji sipas Bashkis	Lloji sipas DRT Korçë	Pastrim	Ndricim	Turizmi	Total
1	Erseke	Nuk administrohet	Aktiv		BM	25,000	10,000	3,000	38,000
2	Leskovik	Administrohet	Aktiv	BV	BM		17,000	3,000	20,000
3	Erseke	Nuk administrohet	Aktiv		BM	4,000	6,666	3,000	13,666
4	Leskovik	Nuk administrohet	Aktiv		BM	60,000	20,000	3,000	83,000
5	Erseke	Administrohet	Aktiv	BV	BM	45,000	17,000	1,500	63,500
6	Erseke	Nuk	Aktiv		BV ME				

		administrohet			TVSH	12,000	2,000	1,500	15,500
7	Erseke	Nuk administrohet	Aktiv		BV PA TVSH	15,000	2,000	1,500	18,500
8	Erseke	Nuk administrohet	Aktiv		BV PA TVSH	15,000	2,000	1,500	18,500
9	Erseke	Administrohet	Aktiv	Ushqimore	BV PA TVSH (prodhim buke)	2,000			2,000
10	Erseke	Nuk administrohet	Aktiv		BV PA TVSH	35,000	2,000	1,500	38,500
11	Barmash	Nuk administrohet	Aktiv		BV PA TVSH	15,000	2,000	1,500	18,500
									329,666

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, DRT Korçë dhe QKB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Subjekte që kanë marrë pasuri të ndryshme me qira debitor viti 2021

Nr	Subjekti perdoresh	Principal 2021	Penalitet Vlerë	Gjithësej
1	K	28,000	2,800	30,800
2	N	30,100	3,010	33,110
3	G	89,220	419,240	508,460
4	F	140,110	30,263	170,373
5	G	26,737	2,674	29,411
6	D	120,000	12,000	132,000
7	K	25,000	2,500	27,500
8	D	14,400	1,440	15,840
	Total	473,567	473,927	947,494

Subjekte me aktivitet HEC, debitor viti 2021

Nr	HEC	Debia progresive 31.12.2020	Nga të cilat		Krijuar në vitin 2021	Nga të cilat		Debia progresive 31.12.2021
			Principal	Penalitet		Principal	Penalitet	
1	E	5,789,471	5,256,100	533,371	1,445,428	1,314,025	131,403	7,234,899
2	S	1,098,518	1,098,518	-				1,098,518
3	E				165,705	150,641	15,064	165,705
4	C SHPK				158,675	144,250	14,425	158,675
5	C SHPK				139,489	126,808	12,681	139,489
6	C SHPK				38,720	35,200	3,520	38,720
	TOTALI	6,887,989	6,354,618	533,371	1,948,016	1,770,924	177,092	8,836,005

Debia për subjektet që kanë marrë tokë me qira për antena

Nr	Antena	Debia	Kamata	Debia 2020	Debia 2011-2020	Pagesa 2021	Debia 2011-2020 e mbetur	Debia 2021	Penalitet	Debia 2011-2021
1	A	1,583,700	400,000		1,983,700		1,983,700			1,983,700
2	P		535,375		535,375		535,375			535,375
3	L			75,000	75,000	75,000	-			-
4	P			75,000	75,000	75,000	-			-
5	Q			75,000	75,000	75,000	-			-
6	V							330,000	72,270	402,270
	totali	1,583,700	935,375	225,000	2,744,075	225,000	2,519,075	330,000	72,270	2,921,345

Bizneset e mëdha debitore viti 2021

Nr	Veprimtari	Nipt	Principal 2021	Penalitet Vlerë	Gjithësej
1	HEC	L....O	148,829		148,829
2	Agjensi Sigurim	J....O	2,880	441	3,321
3	Dyqan telefon	K....V	270,000	41,310	311,310
4	Prodhim Lende	K....J	34,633	5,299	39,932
5	Hec	L....D	96,250	14,726	110,976
6	Karburnat	K....J	86,650	13,257	99,907
7	Shoqeri Transporti	M....N	52,100	7,971	60,071
8	Sherbim net,tv	M....O	123,120	18,837	141,957
9	Firme Nderim	L....H	94,290	14,426	108,716
10	Prodhim ,agroturizem	M....Q	93,120	14,247	107,367
11	Prodhim,agroturizem	L....O	83,120	12,717	95,837
12	Shoqeri Siguracione	L....L	73,120	11,187	84,307
			1,158,112	154,420	1,312,532

Aneksi nr.4 – Mbi hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare trajtuar nga faqja nr.44 deri në faqen nr.54 të raportit përfundimtar të auditimit.

Aktivi i bilancit kontabël 2021

Llogaria	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
A	A K T I V E T	2,533,849,527	1,929,199,965
	I.Aktivet Afat shkurtra	155,859,381	172,913,933
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	23,535,098	38,803,976
520	Disponibilitete ne Thesar	23,005,598	38,803,976
50	Letra me vlere	529,500	
	2.Gjendje Inventari qarkullues	52,185,074	51,859,564
31	Materiale	7,425,572	9,782,272
32	Inventar I imet	44,759,502	42,077,292
	3.Llogari te Arketushme	74,857,755	69,966,116
411	Kliente e llogari te ngjashme	1,872	1,872
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	577,118	516,123
468	Debitore te ndryshem	58,542,301	50,000,812
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	15,736,464	19,447,309
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	5,281,454	12,284,277
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	5,281,454	12,284,277
	II.Aktivet Afat gjata	2,377,990,146	1,756,286,032
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	17,822,315	17,822,315
202	Studime dhe kerkime	17,822,315	17,822,315
21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,726,285,368	1,716,766,638
210	Toka, T,roje, Terene	3,330,850	3,330,850
211	Pyje, Plantacione	25,909,872	25,909,872
212	Ndertesa e Konstruksione	567,893,713	582,906,541
213	Rruge, rrjete, vepra ujqore	1,052,133,276	1,015,619,160
214	Instalime teknike, makineri e paisje	36,944,902	38,520,439
215	Mjete Transporti	23,632,377	29,025,616
218	Inventar ekonomik	16,440,378	21,454,160
25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
	4.Investime	633,882,463	21,697,079
231	Per Aktive Afatgjata materiale	633,882,463	21,697,079

-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike. Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrollë të llogarive dhe dokumenteve.

Aktivi i Bilancit Kontabël 2021

Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivitet neto janë të barabarta me Aktivitet - Pasivitet = 2,412,403,288 lekë.

- Aktivitet 2,533,849,527 lekë
- Pasivitet 121,446,239 lekë
- Aktivitet neto 2,412,403,288 lekë

Aktivitet afatshkurtra

Aktivitet afatshkurtra më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën **155,859,381 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 23,535,098 lekë, e cila përbëhet nga disponibilitet në thesar dhe letrat me vlerë (pullet e gjëndjes civile);
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 52,185,074 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” dhe “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 80,139,209 lekë.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 23,005,598 lekë, përbëhet nga gjëndja e fondeve në thesar me 31.12.2021.

-Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2021 është në vlerën prej 23,005,598 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën prej 38,803,976 lekë, kuadruar me vlerat në rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likujditeve në fund të vitit ushtrimor” lekë. (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”)

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca
Gjendje inventari qarkullues	20,152,533	18,252,713	
Materiale	7,425,572	9,782,272	2,356,700
Inventar i imet	44,759,502	42,077,292	-2,682,210
Total			-325,510

-Llogaria nr.312 “Materiale”, në fillim të vitit 2021 ka vlerën 9,782,272 lekë dhe në fund pasqyrohet me vlerën 7,425,572 lekë, si rrjedhojë e pakësimit të gjëndjes në magazinë.

-Llogaria 327 “Objekte inventari”, ka vlerën 44,759,502 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -325,510 lekë, e cila kuadron me llogarinë nr.63 “Ndryshimi gjëndjes së inventarit” (pasqyra F2 – performanca financiare) në shumën -325,510 lekë.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjëndjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Titullari i Bashkisë Kolonjë ka nxjerrë urdhrat e inventarizimit, si vijon:

Urdhër nr.478, dt.25.10.2021 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të në Gjimnazin “Petro Nini Luarasi”.

Urdhër nr.561, dt.13.12.2021 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të zyrat e bashkisë, njësitë administrative të bashkisë dhe institucioneve të varësisë.”

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjëndjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjëndjeve të inventarit”.

Llogaritë e arkëtueshme janë në vlerën 74,857,755 lekë të përbëra nga:

-Llogaria 411–Kliente e llogari të ngjashme në vlerën prej 1,872 lekë;

-Llogaria 423-429–Personeli, deficite, gjoba, paradhënie në vlerën prej 577,118 lekë, që përbëhet nga 306,895 lekë detyrime të evidentuara nga auditime të mëparshme të KLSH-së, si dhe pjesa tjetër gjoba nga policia bashkiake, detyrime nga pallati i kulturës;

-Llogaria 468–Debitor të ndryshem në vlerën prej 58,542,301 lekë, për taksa dhe tarifa vendore, si dhe detyrime nga kontratat e qirave.

-Llogaria 4342-Operacione me shtetin të drejta (fonde që priten të alokohen në vitin në vijim nga buxheti i shtetit), debituar në vlerën prej 15,736,464 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës së 4 të pasivit (si furnitorët, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatim në burim) të pasqyrës financiare të pozicionit financiar.

4342	Operacione me shtetin të drejtat	Debi	Kredi
			furnitorët
		15,736,464	detyrime ndaj personelit
			detyrime ndaj shtetit për tatim taksa
			sigurimet shoqërore
			sigurimet shëndetësore

Të tjera aktive afatshkurtra janë në vlerën 5,281,454 lekë të përbëra nga:

-Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme (detyrimet e prapambetura)” që janë në vlerën prej 5,281,454 lekë, lëvizja e të cilës pasqyrohet si më poshtë:

Nr	Emerimi	Celja 01.01.2021	Shtesa	Pakësim	31.12.2021
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	12,284,277	1,101,750	8,104,573	5,281,545

Përbërja e llogarisë 486 pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Detyrime për vendime gjyqësore	3,534,112
Detyrime për shërbime	1,581,322
Detyrime për mirembajtje	120,915
Detyrime për investime	
Detyrime për mallra	-
Detyrime të tjera	45,105
Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta	5,281,454

-Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve, si shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore, për detyrime të prapambetura për shërbime, për detyrime të prapambetura për mirëmbajtje, për investime, për detyrime të prapambetura të tjera. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit në vitin 2021.

Aktivet afatgjata janë në vlerën neto prej 2,377,990,146 lekë, nga të cilat:

Aktivet afatgjata jomateriale llogaria 202 - Studime dhe kërkime në vlerën prej 17,822,315 lekë;

Aktivet afatgjata materiale në vlerën prej 1,726,285,368 lekë të ndara përkatësisht:

-Llogaria 210-Toka troje dhe terrene në vlerën prej 3,330,850 lekë;

-Llogaria 211-Pyje dhe plantacione në vlerën prej 25,909,872 lekë;

-Llogaria 212-Ndërtesa dhe konstruksione në vlerën prej 567,893,713 lekë;

-Llogaria 213-Rrugë rrjete dhe vepra ujore në vlerën prej 1,052,133,276 lekë;

-Llogaria 214-Instalime teknike makineri dhe paisje në vlerën prej 36,944,902 lekë;

-Llogaria 215-Mjete transporti në vlerën prej 23,632,377 lekë;

-Llogaria 218-Inventar ekonomik në vlerën prej 16,440,378 lekë;

-Llogaria 209 dhe 219-Amortizimi i akumuluar për aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale në vlerën 808,958,198 lekë.

Lëvizjet brenda vitit 2021 të llogarive të mësipërme pasqyrohen si më poshtë vijon:

Nr.	Përshkrimi	Celje 2021	Shtesa 2021	Pakësime 2021	Viti 2021	Viti 2021
202	Studime dhe kerkime	25,422,074	2,557,486		27,979,560	
209	Amortizimi i AAGJM (-)	Çelje 2021			Gjendje në fund	Në bilanc
2020100	Studime dhe kerkime	7,599,759	2,557,486		10,157,245	17,822,315

Llogaria	Emërtimi	Çelje 2021	Shtesa 2021	Pakësime 2021	Gjendje në fund	
210	Toka ,troje, Terrene	3,330,850	-	-	3,330,850	
211	Pyje, Kullota Plantacione	25,909,872	-	-	25,909,872	
212	Ndërtesa e Konstruksione	724,470,417	13,355,986	2,391,263	735,435,140	
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,375,257,604	72,436,302		1,447,693,906	
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	116,622,888	9,115,829	3,014,320	122,724,397	
215	Mjete transporti	130,237,049	904,028	660,530	130,480,547	
216	Rezerva shtetërore					
217	Kafshe pune e prodhimi					
218	Inventar ekonomik	59,425,225	1,681,942	1,595,558	59,511,609	
219	Amortizimi i AAGJM (-)	Çelje 2021			Gjendje në fund	Në bilanc
	Toka ,troje, Terrene	-	-	-	-	3,330,850
	Ndërtesa e Konstruksione	141,563,877	25,977,550	-	167,541,427	567,893,713
	Rruge, rrjete, vepra ujore	359,638,444	35,922,186		395,560,630	1,052,133,276
	Inventar ekonomik	37,971,065	5,100,166		43,071,231	16,440,378
	Pyje, Kullota Plantacione	-	-	-	-	25,909,872
	Mjete transporti	101,211,433	5,636,737		106,848,170	23,632,377
	Instalime teknike, makineri, paisje,	78,102,449	7,677,046		85,779,495	36,944,902

Pasivet (Detyrimet)

Llogaria	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
B	PASIVET(DETYRIMET)	121,446,239	103,945,600
	1. Llogari te Pagushme	121,446,239	103,945,600
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	2,484,130	5,689,608
42	Detyrime ndaj personelit	9,476,487	9,867,768
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	552,354	544,234

433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore, taksa e pullave	529,500	
435	Sigurime Shoqerore	2,835,816	2,942,719
436	Sigurime Shendetsose	387,677	402,980
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	40,777,530	21,697,079
467	Kreditore te ndryshem	5,281,454	12,284,277
4341	Operacione me shtetin (detyrime ndaj shtetit)	59,121,291	50,516,935

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Kolonjë më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave të investimeve.

-Sa më sipër lëvizjet e llogarive në pasivet afatshkurtra paraqiten si më poshtë:

Llogaria	Përshkrimi	Celja 01.01.2021	Shtesa (K)	Pakesime (D)	31.12.2021
401	Furnitore e llogari te lidhura me to	5,689,608	66,418,492	69,531,570	2,484,130
42	Detyrime ndaj personelit	9,867,768	118,821,126	119,212,407	9,476,487
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	544,234	6,514,792	6,506,672	552,354
435	Sigurime Shoqerore	2,942,719	35,062,336	35,169,239	2,835,816
436	Sigurime Shendetsose	402,980	4,793,454	4,808,757	387,677
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	21,697,079	22,689,789	3,609,338	40,777,530
467	Kreditore te ndryshem	12,284,277	1,101,750	8,104,573	5,281,545

Fondi i Konsoliduar.

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën **2,097,235,289 lekë**. Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet.

Llogaria	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
Llogaria	Emërtimi	2,412,403,288	1,825,254,365
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,376,237,758	1,786,450,389
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	23,331,106	17,106,897
115	Nga Fondet e veta te investimeve	12,834,424	21,697,079

-Llogaria 101-Teprica (Fondi Akumuluar), është në vlerën prej 2,376,237,758 lekë, e përbërë nga aktivet materiale dhe jomateriale, si dhe gjendja e aktiveve qarkulluese (materialet dhe objekte inventari).

-Llogaria 85-Rezultati veprimtarisë ushtrimore, është në vlerën prej 23,331,106 lekë, e përbërë nga fondet buxhetore të papërdorura, që trashëgohen në vitin pasardhës buxhetor.

-Llogaria 115-Caktim fondi për investime, është në vlerën prej 12,834,424 lekë, e cila përfaqëson që të ardhurat e realizuara gjatë vitit ushtrimor i përdorin konform ligjit për seksionin e investimeve, pra për investime. Nga pikëpamja e funksionimit kontabël, ky burim krijohet nëpërmjet një transferimi nga seksioni i funksionimit në seksionin e investimeve për të mos dhënë efekte në rezultat.

Pasqyra e Performancës Financiare

Llogaria	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
A	TE ARDHURAT	400,344,685	362,198,876
70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	31,155,328	26,397,539
700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	20,000	109,476
702	2.Tatimi mbi Pasurine	7,496,095	12,100,567
703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	23,594,415	14,159,040
708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare	44,818	28,456
71	II.TE ARDHURA JO TATIMORE	25,294,471	22,612,530
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	11,763,596	10,370,227
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	13,530,875	12,242,303
72	V.GRANTE KORENTE	305,090,910	313,149,159
720	1.Grant korent I Brendshem	305,090,910	313,149,159
7200	Nga Buxheti per NJQP (Qendrore)	276,082,379	274,800,329
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	202,690	6,050,744
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	7,452,923	
7206	Financim I pritshem nga buxheti	21,017,918	31,731,586
7207	Sponsorizime te brendshme (nga te trete)	335,000	566,500
	VI.TE ARDHURA TE TJERA	38,803,976	-
787	Terheqje nga seksioni I investimeve	38,803,976	-
73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE	-	39,648
B	SHPENZIMET	377,013,579	345,091,979

600	LPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	142,560,639	141,850,458
6001	Paga, personel i perhershëm	142,218,174	141,190,758
6002	Paga personel i Perkohshëm	-	270,403
6003	Shperblime	342,465	389,297
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	23,544,392	23,675,909
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	21,139,824	21,265,874
6011	Kontributi i Sigurimeve Shendetesore	2,404,568	2,410,035
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	95,286,008	67,123,694
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	5,173,394	7,998,258
6021	Materiale dhe sherbime speciale	2,695,831	5,776,431
6022	Sherbime nga te trete	26,004,695	9,697,274
6023	Shpenzime transporti	25,130,839	20,495,122
6024	Shpenzime udhetimi	3,643,000	3,081,507
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	12,377,909	8,791,940
6026	Shpenzime per qeramarrje	114,120	97,303
6029	Shpenzime te tjera operative	20,146,220	11,185,859
	V.TRANSFERIME KORENTE	115,948,050	118,836,976
604	1.Transferime korente te brendshme	1,296,394	1,781,704
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme	1,296,394	1,781,704
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	114,651,656	117,055,272
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	113,481,200	116,715,362
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,170,456	339,910
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	(325,510)	(6,395,058)
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUHES	23,331,106	17,106,897

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

Të ardhurat tatimore

-Llogaria 70 në vlerën prej 31,155,328 lekë, nga të cilat:

-Llogaria 700-Tatimi mbi të ardhurat, në vlerën prej 20,000 lekë.

-Llogaria 702-Të ardhura nga pasuria e paluajtshme, në vlerën prej 7,496,095 lekë ku përfshihen të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore, ndertesës, truallit.

-Llogaria 703-Tatim mbi mallra dhe shërbime brenda vendit, në vlerën prej 23,594,415 lekë.

-Llogaria 708-Taksa kombëtare (taksa e pullës), në vlerën prej 44,818 lekë.

Të ardhurat jo tatimore

-Llogaria 71 në vlerën prej 25,294,471 lekë e përbërë nga:

-Llogaria 710-Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia (qirat), në vlerën prej 11,763,596 lekë.

-Llogaria 711-Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare (tarifa administrative për lëshim dokumentesh, gjoba, shërbimi i zjarrëfikses), në vlerën prej 13,530,875 lekë.

Grante

-Llogaria 72-Grant Korent i brendshëm, në vlerën prej 305,090,910 lekë në të cilin përfshihen grante nga qeveria për shpenzime, financim i pritshëm, taksat e ndara, si dhe sponsorizime nga të tretë.

-Llogaria 783-Tërheqje nga seksioni i investimeve, në vlerën prej 38,803,976 lekë, kreditimi i rezultatit të vitit 2020.

Shpenzimet

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket shpenzimeve:

Emërtimi	Sipas Situacionit
600	142,560,639
601	23,544,392
602	95,286,008
604 + 606	115,948,050
63	-325,510
Totali	377,013,579

Aneksi nr.5 – Mbi procedurat e prokurimit publik, trajtuar nga faqja nr.54 deri në faqen nr.93 të raportit përfundimtar të auditimit.

Në zbatim të pikës 4.4/4 me objekt: “Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik” të Programit të Auditimit, në Bashkinë Kolonjë, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë dhe u audituan kontratat për punë publike, pasqyruar në

tabelën nr. 1, me vlerë **1,031,805,198 lekë pa TVSH ose 1,238,166,238 lekë me TVSH**, mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në investimet publike, përputhshmërinë me projektet e zbatimit, kushteve teknike të zbatimit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, kolaudimi, zbatimi i afateve të kontratave si dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera.

Tabela nr. 1. Kontrata zbatimi të audituara

Nr	Objekti	Vlera e kontratës me TVSH
1	2	4
Viti 2021 (01.07.2021 – 31.12.2021)		
1	Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” Bashkia Kolonjë	274,456,182.47
2	Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë” Bashkia Kolonjë	75,131,311
3	Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës	391,298,650
4	Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatërave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit	497,280,095

Burimi: Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi e auditimit.

Aneksi nr.6 – Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm trajtuar nga faqja nr.105 deri në faqen nr.112 të raportit përfundimtar të auditimit.

Pasqyra e realizimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Nr	Emërtimi	Rekomandimet në numër :				Nga rekomandimet gjithsej:								
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:				Rekomanduar Gjithsej		Zbatuar arkëtuar		(Në proces)		Pa zbatuar	
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Proces zbatimi	Pa zbatuar	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek
1	Masa organizative	25	3	4	6	12								
2	Shpërblim demi	9	-	-	4	5	23	23,275	-	-	9	1,915		21,360
3	Masa efekt adm. e fondeve publike	3				3	11	716,692	1	2,000			10	714,692
4	Masa disiplinore	1		1										
5	Për eliminimin e borxhit tatimor	1				1		49,966	-	-	-	-		-
	Totali	39	3	5	10	21	34	739,967	1	2,000	9	1,915	10	736,052

Nga rekomandimet gjithsej: Sa për eliminimin e borxhit tatimor			
Rekomanduar Gjithsej	Zbatuar	(Në proces)	Pa zbatuar
Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek
49,966			49,966

Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT